



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 13 TETOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 13.
OKTOBRA 2009. GODINE

TETOR – OKTOMBAR
2009

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës së re plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ju njoftoj se para seancës ne kemi marrë një material që i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës për formimin e Komisionit ad-hoc për Radiotelevizionin, por kjo çështje nuk është e ngutshme dhe e lëmë që në procedurë të rregullt të hyjë në rend dite.

Për fjalë është paraqitur Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Të respektuar kolegë deputetë,
Dola këtu para jush për të ngritur një shqetësim jo vetëm timin, besoj edhe të tuajin edhe të shumë qytetarëve të vendit lidhur me gjendjen në sistemin e drejtësisë, i cili sistem nuk është konsoliduar sa dhe si duhet dhe jo rrallë po shfrytëzohet gjykata jo si instrument i drejtësisë, por si instrument i politikës, duke ndërhyrë qarqe parapolitike dhe individë dhe grupe joformale.

Përmes proceseve gjyqësore, sidomos javën e fundit, po përpiqet që të devalorizohet vlera më e madhe e krijuar në shoqërinë tonë- Ushtria Çlirimtare e Kosovës, siç është rasti i procesit kundër Latif Gashit me shokë, ku ka pasur edhe deklarime publike, qoftë nga akterët, qoftë nga pjesëtarët e kolegjit gjyqësor se ka qenë një vendim jo i bazuar, një vendim i paargumentuar dhe thjesht një vendim politik.

Ne si institucione asnjëherë nuk kemi synuar dhe nuk synojmë që të interferojmë në punën e shtyllës së tretë të pushtetit të gjyqësisë, por në këtë rast do të duhet të ngremë zërin dhe do të duhet ta shqyrtojmë shumë seriozisht gjendjen dhe ta konsolidojmë përfundimisht një herë e mirë sistemin e drejtësisë duke mos u lënë hapësirë individëve të cilët kanë ndikuar ndoshta në krijimin e këtij sistemi që sot t'i shfrytëzojnë ato përmes ndikimeve joformale.

Për më konkretisht, ne e dimë se zoti Shtiven Shuk ka qenë zëvendës i Përfaqësuesit Special të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ne e dimë se ndaj tij ka pasur edhe investigim ndërkombëtar dhe kemi indikacione, domethënë se ato qarqe, ato mbetje të UNMIK-ut, të cilët përpiqen ta luajnë rolin edhe sikur e kanë pasur kur kanë pasur mandatin, janë duke interferuar.

Prandaj, ne kërkojmë nga EULEX-i që t'i hetojë çka bën Shtiven Shuk në Kosovë, me cilat fonde mbahet ai këtu, pse lëviz dhe kah lëviz si lakuriq i natës gjithandej Kosovës, veçanërisht në Dukagjin?

(Reagime nga salla)

Dhe, ne kërkojmë, do të thotë, nga EULEX-i si përgjegjës për rendin dhe sigurinë, ta përfundoj unë pastaj flisni ju, duhet të tregoni një kulturë më parlamentare këtu.

(Reagime nga salla)

Edhe një herë po e përsëris që, ju lutem shumë, tregoni pak kulturë parlamentare, zotërinj deputetë. Ne do të insistojmë dhe insistojmë që EULEX-i si përgjegjës për rendin dhe sigurinë t'i hetojë lëvizjet e tij dhe të shohë se çka ai realisht bën me grupet joformale, me grupe të ndryshme edhe me grupe të inkriminuara.

Prandaj, përfundimisht, zoti Kryetar, ky Parlament do të duhet që të vendosë rregull edhe në sistemin e drejtësisë dhe do të duhet t'i ndërpres interferimet nga individë dhe nga qarqe të ndryshme para politikave joformale. Faleminderit!

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Unë shkoj sipas rendit të ditës që janë lajmëruar edhe pse reagimet janë të panevojshme, secili mund ta thotë atë që e do.

(Reagime nga salla)

Ju po luftoni shumë për rend dhe ligj, mendoj që pajtoheni për sundimin e rendit dhe të ligjit. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, fjalën Ardian Gjinit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, edhe një herë!

Mendoj se nuk është hera e parë që jemi mësuar t'i shohim deputetët e dirigjuar me telekomandë, që jashtë çdo rendi të ditës, jashtë çdo sensi njerëzor, jashtë çdo logjike të Parlamentit, dalin edhe flasin pa lidhje, pa asnjë fakt, pa asnjë normë njerëzore, krejt çdo gjë që i bie kuzhinës mbrapshtë të cilës i takojnë Ramadan Avdiu, je bërë pjesë e një kuzhine të mbrapshtë, po të kallëzoj, sikur të tjerët para teje këtu që kanë dalë edhe kanë vjellë çka kanë mundur. Duhet një herë dikujt të nisë t'i vijë marre për krejt këto forma të punës që i përdorni në Kuvend të Kosovës e në foltore të Kuvendit të Kosovës për shkak se është kah ju duket juve që dikush është kah ua ha dheun nën këmbë politikisht. Keni për të humbur bre njerëz, keni për të humbur keq se jeni duke e fëlliqur foltoren e Kuvendit, jeni duke e fëlliqur shtetin, jeni duke e fëlliqur Parlamentin, jeni duke fëlliqur Qeverinë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem shumë, asnjë fjalë, unë jam duke e udhëhequr seancën. I nderuar deputet, vërtet është mirë ta korrigjosh fjalorin, me gjithë respektin, ju lutem. Fjalën e ka kërkuar Agim Veliu. Unë ju thashë, jemi në fillim të seancës vetëm nga një anëtar për grup parlamentar do të flasë dhe asnjë tjetër s'do të flasë.

AGIM VELIU: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e fundit ka marrë një vendim për themelimin e Universitetit të Prizrenit, bile edhe pa e pasur në rend dite, nën pikën – Të ndryshme.

Dola këtu që t'ju them se Lidhja Demokratike e Kosovës është për themelimin e këtij universiteti, por edhe t'ju informoj se një vendim i tillë është marrë para dy vjetësh.

Ministria e Arsimit, ministri i Arsimit, gjegjësisht në një prononcim për media ka thënë se ky vendim nuk ekziston në Ministrinë e Arsimit. Ky vendim është shpërndarë në disa adresa, prandaj po e shfrytëzoj rastin që Qeverisë t'ia dorëzoj një kopje të vendimit që është marrë para dy vjetësh.

KRYETARI: Konsideroj që edhe ju jeni pjesë e Qeverisë. Vazhdojmë nga Grupi Parlamentar i LDD-së, sipas radhës, Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra prezentë,

Ne e kishim në rend të ditës të diskutojmë shqyrtimin e shpenzimit të buxhetit të Kosovës për gjysmën e vitit që e lamë prapa dhe këtu me qëllim vonohet seanca e re që mos të shihet transmetimi i drejtpërdrejtë dhe qytetarët e Kosovës mos ta shohin shpenzimin e gabueshëm të paplanifikuar dhe të çuditshëm që e ka bërë kjo Qeveri. Pastaj, fillojnë filma horror të teorisë së konspiracionit, çfarë mesazhi po iu dërgoni qytetarëve të Kosovës dhe bëhet fushatë elektorale mes dy partnerëve të koalicionit kush e ka themeluar një universitet, pse e ka themeluar dhe del në pah që merren vendime absolutisht kundër kushtetuese dhe joligjore.

Zoti Kryetar,

Duhet të filloni të procedoni me rendin e ditës, e kemi në diskutim buxhetin dhe humbja e seriozitetit dhe e rëndësisë së organit më të lartë legjislativ të vendit, çka presin qytetarët prej nesh? Ku është Kryeministri, ku është Qeveria, ku janë njerëzit përgjegjës të planifikimit dhe të shpenzimit të atyre mjeteve? Ka komuna që i kanë investuar për 6 muaj përqindjen në shpenzime kapitale 4%, në Dragash apo 5% në Istog, komuna që udhëhiqet nga koalicioni qeverisës, ku jeni duke e dërguar këtë vend? A po merreni me vetveten? Fushatën e bëjmë me programe dhe oferta elektorale në bazë, në Parlament duhet ta kryejmë punën për atë që na kanë sjellë qytetarët e Kosovës edhe na paguajnë me paga bukur të majme. Insistoj që të procedojmë me rendin e ditës dhe të shkojmë tutje, sepse puna e këtij Parlamenti në vazhdimësi e ka humbur kuptimin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, unë po të dëgjoj.

Fillojmë me rendin e ditës.

- Shqyrtimi i Raporti gjashtëmuor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ia ka paraqitur Kuvendit Raportin gjashtëmuor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Raportin gjashtëmujor të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe ia ka rekomanduar Kuvendit, për miratim.

Raporti gjashtëmujor i buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe rekomandimi i Komisionit u janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë që ta arsyetojë Raportin gjashtëmujor të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Ministri Ahmet Shala e ka fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar Kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësi nr. 03/L-48, kam kënaqësinë dhe obligim që para deputetëve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës të paraqes Raportin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Në muajin dhjetor të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin nr. 03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, i cili ligj është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës më 30 dhjetor të vitit 2008.

Plani buxhetor i të hyrave vjetore për vitin 2009 është 956.500.000 euro. Plani buxhetor për shpenzimet vjetore është një 1.176.688.804 euro, duke i përfshirë të hyrat vetjake të bartura nga viti 2008, të cilat nuk janë planifikuar me Rregulloren e buxhetit.

Më lejoni që t'i shpreh para jush disa veçori kualitative të këtij raporti dhe, natyrisht, do të japë pasqyra statistikore për secilën kategori.

Një ndër karakteristikat substanciale të këtij raporti është ngritja e të hyrave krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Siç e dini, pa marrë parasysh se ne kemi vendosur këtu në këtë Kuvend uljen e taksave diku për 50% në mesatare, institucionet e Republikës së Kosovës, qytetarët e Kosovës kanë arritur që pa marrë parasysh uljen e taksave, ne të kemi një ngritje substanciale të hyrave në të gjitha nivelet dhe pa marrë parasysh edhe krizën globale e cila ka rrethuar rrethinën e saj dhe Kosovën.

Po ashtu, një karakteristikë tjetër e veçantë është ngritja kualitative e kategorive të investimeve kapitale. Pra, do t'i jap shifrat për secilin element.

Në vazhdim, më lejoni të paraqes një përmbledhje të raportit gjashtëmujor, për të pasqyruar të dhënat në formë analitike dhe të krahasuar ato me periudhën paraprake të vitit 2008.

Të hyrat e grumbulluara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, si dhe fondet në mirëbesim janë 420.085.485 euro dhe paraqesin 43,9% të hyrave të përgjithshme vjetore të planifikuara, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rritje prej 3%.

Të hyrat e mbledhura në kufi arrijnë 64,5% të hyrave të përgjithshme dhe kapin shumën prej 270.907.463 euro, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje prej 3,3% për këtë kategori.

Të hyrat e brendshme, të mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës arrijnë 23,1% të hyrave të përgjithshme dhe shprehur në masë monetare janë 96.981.762 euro, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një ngritje prej rreth 2%.

Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë me 4,8% në shumën prej 20.146.953 euro, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një ngritje prej 17,2%.

Dhe, më lejoni që në emër tuaj dhe timin t'ju falënderoj edhe për angazhimin e të gjithë qytetarëve dhe posaçërisht të autoriteteve lokale për një ngritje substanciale të të hyrave komunale, që besoj se është një vetëdijesim dhe një ngritje e efikasitetit të nivelit, po ashtu, lokal.

Të hyrat vetjake të nivelit qendror në totalin e përgjithshëm në të hyra marrin pjesë me 4% dhe janë në shumë prej 16.885.441 euro, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje prej 8,7%.

Këto ishin kategoritë në të cilat unë dëshiroja të fokusohesha dhe besoj që përmbledhin po thuaj të gjitha kategoritë e të hyrave dhe, siç e shihni, të gjitha kategoritë kanë rritje. Dhe, singërisht, pa modesti dua t'ju them se në çdo shoqëri në këtë krizë ekonomike, në situatën kur kemi ulje të taksave për 50%, ngritja në mesatare diku mbi 5 – 6 %, e cila shkon deri në 17,2% është vërtet për një konstatim pozitiv të situatës së grumbullimit të hyrave.

Të hyrat jo tatimore qeveritare paraqesin 5,9% të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumën prej 24.947.868 euro, në kuadër të kësaj kategorie bëjnë pjesë edhe të hyrat nga gjrobat të cilat mbledhen nga komunat dhe evidentohen si të hyra jo tatimore. Edhe këto të hyra kanë pasur një ngritje në mesatare prej 2,9%.

Më lejoni që tani të kaloj te të dalat. Natyrisht, shpenzimet gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2009, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, si dhe fondet në mirëbesim, kanë qenë po ashtu më të mëdha falë edhe ekzekutimit ose rritjes së ekzekutimit të shpenzimeve, përkatësisht investimeve kapitale dhe shuma totale e fondeve të ekzekutuara deri në fund të qershorit të vitit 2009 ka qenë 397 milionë e 130 mijë euro dhe paraqet pjesëmarrjen e shpenzimeve prej 33,7% të planit të përgjithshëm vjetor.

Krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje kualitative vjetore të shpenzimeve prej 21,6%. Në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet, sidomos ekzekutimi i projekteve ishte për diku 30% më i ulët se sa këtë vit. Ndërsa, nëse krahasohet viti 2007, vërtet kemi tejkaluar kohën tani që të bëjmë krahasime me atë vit, besoj që në secilin vit jemi duke tejkaluar çdo parashikim pozitiv, sidomos në ekzekutimin e investimeve kapitale në të gjitha ministrinë, përkatësisht në të gjitha institucionet e Kosovës.

Shpenzimet në kategoritë e pagave janë 126.970.000 euro ose 32% të shpenzimeve të përgjithshme, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2008 shpenzimet në këtë kategori janë 17% më të larta.

Konsideroj se kjo rritje shkon kryesisht falë nëse mund të them rritjes së rrogave të arsimtarëve dhe rritjes së rrogave apo zgjerimit edhe të institucioneve të Kosovës dhe qytetarët e Kosovës besoj që janë duke e ndjerë këtë rritjen e kualitetit të jetesës së tyre.

Shpenzimet në mallra dhe shërbime janë 55.181.000 euro ose 14% e shpenzimeve të përgjithshme dhe karshi me vitin paraprak përfshijnë rreth 11% shpenzime më shumë se sa në këtë vit dhe me këtë natyrisht në bazë të gjitha parashikimeve të mëhershme është konform nëse mund të them edhe planit dhe parashikimeve, sepse ka ngritje të madhe të investimeve kapitale dhe patjetër edhe shpenzimet në mallra dhe shërbime të duhej të shoqëroheshin me një rritje të tillë.

Shpenzimet nga kategoria e shërbimeve komunale kapin shumën prej 8.940.000 euro ose 2% e shpenzimeve të përgjithshme, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shpenzimet në këtë kategorinë kanë qenë 5% më të larta se në vitin 2009. Arsyeshmëria është kryesisht komnatat e reja si dhe funksionet e reja nëpër komuna.

Subvencionet dhe transferet të cilat kryesisht shkojnë në rritjen e ofrimit të shërbimeve të qytetarëve, sidomos të barërat esenciale dhe transferet e ndryshme në subvencione kapin shumën prej 126.680.000 euro ose 32% shpenzimeve të përgjithshme dhe krahasuar me të njëjtin vit paraprak është për 25% rritje.

Investimet kapitale ose shpenzimet kapitale që shpeshherë përzihen me shpenzime negative në fakt konsideroj që çdo rritje e efikasitetit dhe e këtij shpenzimi do të ishte një shenjë pozitive për shoqërinë kudo që të ndodhë ajo, andaj, konsideroj që këtu me mburrje mund të raportoj se 35% të ekzekutimit të investimeve kapitale këtë vit

KRYETARI: Regjia, ia zgjatni kohën deri në përfundim ministrit.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, e kam para përfundimit.

Që të mos i mbetem borxh audiencës që na përcjell, pra investimet kapitale në shumë prej 79.360.000 euro ose 20% e shpenzimeve të përgjithshme karshi me vitin e njëjtë paraprak të njëjtës periudhë është për 35% më shumë. Uroj dhe sinjerisht i përgëzoj të gjitha institucionet e Kosovës për rritjen e kapaciteteve të tyre ekzekutive të projekteve kapitale të cilat ka qenë brengë edhe e donatorëve edhe e shoqërisë kosovare, besoj që edhe monitorimi i kualiteteve është në të njëjtin nivel.

Në fund, më lejoni të them se raporti gjashtëmujor është edhe një tregues i mirë i suksesit të institucioneve të Kosovës në këtë periudhë dhe shihet sidomos një përmbushjen e planit mbi grumbullimin e të hyrave dhe tejkalim karshi me vitin e kaluar diku në mesatare mbi 5 – 6%, varësisht në cilin institucion merret periudha krahasuese për gjashtëmujorin e parë.

Të gjitha raportet, të gjitha shifrat që janë paraqitur në raport përmbushin standardet e raportimit financiar të përcaktuara me standardet që i ka një shtet i organizuar mirë dhe raporti i plotëson të gjitha kushtet e tjera sa i përket kualitetit të raportimit konform standardeve evropiane.

Jam në dispozicionin tuaj për të diskutuar për secilën kategori dhe mirëpres çdo koment pozitiv. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotit Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fillim e kërkoja fjalën, por ju nuk ma dhatë dhe unë e kisha një çështje ta shtroj. Duke pasur parasysh rendin e ditës, i kemi dy pika – Raporti i shqyrtimit gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe i njëjti raport që ka të bëjë me shpenzimet buxhetore për Kuvendin, si i veçuar si njësi buxhetore, po ashtu për gjashtëmujorin e vitit 2009. Ne deri më tani nuk kemi pasur një praktikë të zhvilluar edhe pse nuk kemi pasur ndalesa as procedurale që t'i shqyrtojmë veç e veç raportet e institucioneve buxhetore ose të agjencive buxhetore dhe duke pasur parasysh se i gjithë raporti që e ka shtruar Qeveria këtu përfshin edhe shpenzimet buxhetore të Kuvendit, unë mendoj se këto dy pika kanë mund të njëjtësohen në një dhe të diskutohet pastaj në kuadër të kësaj pike që tash ne po e shqyrtojmë. Prandaj, unë si kryetar i Komisionit, edhe pse ne kemi pasur një rekomandim, një përfundim, një vendim të Kryesisë së Kuvendit që Komisioni ta shqyrtojë raportin e Kuvendit, ne e kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë rekomandimet tona dhe ato rekomandime kanë mund të përfshihen në rekomandimet e përgjithshme ose vendime të përgjithshme që mund t'i marrë Kuvendi sot lidhur me shpenzimet buxhetore për gjashtëmujorin.

Prandaj, kërkoj që vërtet për këto dy pika të bëhen një dhe të diskutojmë pastaj. Unë mendoj që është një propozim edhe po e marr guximin të them edhe në emër të Komisionit, por edhe si kryetar i Komisionit në këtë rast, që t'i diskutojmë dhe pastaj rekomandimet janë për të dy çështjet, dy pikat që i kemi këtu dhe mbi bazë të tyre pastaj të krijojmë një qëndrim të përbashkët dhe një përfundim të përbashkët për këto dy raporte.

KRYETARI: Është një kërkesë e kryetarit të Komisionit. A e bëjmë një votim formal për bashkimin e pikës së parë dhe të dytës? Kush është “për”? Shumica absolute. Kush është “kundër”? 9 “kundër”. Me shumicën e votave, do të thotë, miratohet mocioni ose propozimi i kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotit Gani Koci.

Gani, mund të vazhdosh, nëse dëshiron.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar tash po them dy raportet dhe për dy raportet ka rekomandimet e veta. Dhe, në raportin e përgjithshëm që përfshin edhe raportin e dytë ka konsideruar se i përmbush të gjitha standardet e raportimeve financiare, standardet ndërkombëtare, por edhe rregullat për raportimin financiar që përcaktohen me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe si të tillë i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport, natyrisht duke pasur parasysh se Komisioni ka vendosur me shumicën e votave, sepse u kërkuar ndoshta ose gjithë anëtarët e Komisionit kanë qenë që ky raport të vijë deri në Kuvend dhe të shqyrtohet, por shumica ka vendosur se ai duhet të miratohet si i tillë dhe prandaj i mbetet Kuvendit që ta miratojë edhe në kuadër të kësaj edhe raportin për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kur është çështja të raporti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni ka dy qëndrime decidoje që mendoj që është mirë që Kuvendi rreth këtyre dy çështjeve, por edhe Kryesia të marrin vendime të caktuara.

Në një, duke pasur parasysh shpenzimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës në linjën investimet kapitale, aty kemi një përqindje zero të realizimit të shpenzimeve dhe pikërisht

për faktin se tash e tri vjet në këtë linjë na figuron projekti “Vila Gërmia” dhe deri më tani nuk është bërë asnjë hap, as praktik dhe as politik që në farë mënyre të fillohet rreth kësaj ose të hiqet dorë prej këtij projekti. Prandaj, qëndrimi i Komisionit është që Kryesia e Kuvendit dhe Kuvendi të marrin një vendim të caktuar rreth vazhdimit ose mosvazhdimit të realizimit të projektit “Vila Gërmia”.

Dhe, në një linjë tjetër, në linjën paga dhe mëditje të Kuvendit, Komisioni ka kërkuar që të bëhet një rikonfigurim në përputhje me buxhetin e miratuar për vitin 2009, gjë që megjithatë mbetemi me shpresë se kjo çështje do të duhej të realizohej.

Sa i përket raportit të përgjithshëm ministri e tha edhe unë nuk dua të futem si kryetar i Komisionit në çështje të caktuara, por këtu ka mundësi dhe mundësitë e nxjerrjes edhe anës së keqe edhe anës së mirë të realizimit të këtyre shpenzimeve buxhetore janë të mundshme dhe varësisht nga ajo se me çka i krahason. Po ti krahasojmë me gjashtëmujorin e vitit të kaluar në të gjitha linjat buxhetore ka një përmirësim pozitiv dhe kjo është mirë dhe është që të përshëndetet Qeveria e Republikës së Kosovës, por duke pasur parasysh pozitat nga ajo që është projektuar dhe ajo që është realizuar, megjithatë ka një diferencë dhe i mbetet Qeverisë që deri në përmbyllje të vitit fiskal 2009 që këtë diferencë nga ajo që është projektuar dhe që është realizuar që përafërsisht të mbërrihen parametrat e asaj që ne e kemi projektuar. Prandaj, duke mos dashur t’i përsëris ato që i tha, ku janë realizimet dhe ku ka ngecje, mendoj që raporti në përgjithësi duhet të miratohet dhe me sugjerimin që Qeveria duhet të jetë gjithmonë koncistente dhe konsekuente në realizimin e asaj që e planifikon.

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, shkojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe Kabinetin qeveritar, ata që janë këtu prezentë!

Ne sot kemi në shqyrtim Raportin gjashtëmujor të buxhetit. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin gjashtëmujor dhe ka ardhur në përfundim se ky raport është hartuar në pajtim me dispozitat ligjore, është sjell me kohë, është gjithëpërfshirës dhe është edhe përmbajtjesor.

Ajo çka është më kryesore në këtë raport vërehet një transparencë shumë më e madhe sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve, si atyre operative, ashtu edhe atyre kapitale.

Në raport janë paraqitur në mënyrë të detajizuara burimet e të hyrave, janë paraqitur në mënyrë të detajizuara edhe shpenzimet operative. Në këtë raport fiskal buxhetor ne kemi mundësi të shohim se cilat janë investimet kapitale sipas projekteve dhe organizatave buxhetore, cila është vlera e mjeteve të alokuara për këtë periudhë, sa prej tyre janë shpenzuar dhe sa është vlera e mjeteve të zotuar, që do të thotë sa janë lidh kontratat të përkryera të projekteve të cilat janë planifikuar?

Në vazhdimësi si grup parlamentar kemi shprehur shqetësimin se nuk kemi planifikim të mirë buxhetor dhe kjo reflekton në realizimin e buxhetit. Mirëpo, kohëve të fundit po vërehet ngritja e kapaciteteve, si rezultat i kësaj ka një planifikim dhe realizim më të mirë të buxhetit, megjithatë mbetet shumë për t’u bërë në këtë drejtim.

Po jap dy shembuj , njërin e përmendi njërin edhe kryetari i Komisionit për Buxhet. Edhe në mandatin e kaluar, po thuaj se gjatë tërë mandatit të kaluar kemi bërë një planifikim për Presidencën, ku janë të parapara një milion e 100 mijë euro dhe asnjëherë asnjë euro nuk është shpenzuar për këtë projekt i cili në vazhdimësi është planifikuar. E njëjtë gjë ka ndodhur edhe me Kuvendin e Kosovës, me disa projekte kapitale që i përmendi Kryetari dhe s'dua t'i përmend.

Të nderuar deputetë,

Nga raporti vërehet se të hyrat buxhetore gjatë këtyre muajve të parë të këtij viti edhe përkundër ndryshimit të politikave tatimore kanë treguar performancë të mirë.

Të hyrat e përgjithshme të planifikuara janë realizuar 43.9% dhe nëse krahasohet me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar të hyrat e gjashtëmujorit të parë janë diku 2.9% më të larta se të hyrat në vitin e kaluar.

Të hyrat nga Dogana janë 3% më të larta, ku vërehet një angazhim serioz për vjeljen e të hyrave dhe përkundër problemeve me të cilat është përballur ky sektor.

Të hyrat nga Administrata Tatimore janë rritur për 2% si rezultat i efikasitetit dhe efektivitetit të Administratës Tatimore të Kosovës. Në këto dy vjetët e fundit është rritur efikasiteti i punës së komunave që ka reflektuar në rritjen e të hyrave vetjake. Vetëm gjatë këtij viti të hyrat në komuna janë rritur diku 17% dhe nuk duhet të nënvlerësohet rritjen e të hyrave komunale kur dihet se në të kaluarën kemi pasur në vazhdimësi performancë negative të hyrave në këtë kategori.

Sa i përket shpenzimeve vërehet se progresi ndaj planit është vetëm 33.7%, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi një rritje diku 21.6%.

Ka rritje relative në kategorinë paga dhe mëditje, të cilat kanë ardhur si rezultat i rritjes së pagave të mësimdhënësve dhe shërbyesve civil, që është bërë për 10% dhe po ashtu ka edhe një rritje relative të mallrat dhe shërbimet si shkak i shtimit të institucioneve dhe krijimit të institucioneve të reja, qoftë në nivelin qendror, qoftë në nivelin lokal dhe njëkohësisht për shkak të rritjes së mjeteve të cilat janë bërë për barërat esenciale.

Shpenzimet kapitale kanë pasur një rritje të kënaqshme gjatë këtyre muajve edhe pse ne do të dëshironim që këto shpenzime të ishin të realizuara diku 50% . Vetë natyra e punës të këtyre shpenzimeve nuk krijon mundësinë që në këtë periudhë të realizohen këto shpenzime.

Investimet kapitale janë 35% më të larta, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Të nderuar, deputetë,

Nëse shikojmë me kujdes raportin, vërejmë se Qeveria është e përkushtuar për përdorimin efikas të mjeteve duke i orientuar aty ku qytetarët përfitojnë më së shumti. Nëse i shikojmë me vëmendje projektet kapitale që janë të paraqitura në këtë raport vërehet se Qeveria është duke punuar shumë për një shpërndarje të njëtrajtshme të shpenzimeve kapitale dhe është duke punuar shumë që në të ardhmen shpenzimet kapitale të kenë një strukturë të harmonizuar të shpenzimeve buxhetore në fillim të vitit dhe do të ulët mundësia e shpenzimit në fund të vitit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Raportin gjashtëmujor të buxhetit që na është ofruar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush e do fjalën? E ka fjalën Armend Zemaj,

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Raportin gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, të shpenzimeve. Është mendim i përgjithshëm se raporti i plotëson standardet ligjore të kontabilitetit për raportim. Pasi që e bashkuam, domethënë edhe pjesën tjetër, raportin e Kuvendit, mbetet si shqetësim i përgjithshëm, domethënë, sa i përket dinamikës së shpenzimeve kapitale, duhet pasur kujdes, sidomos për t'i përmbushur objektivat e paraqitura edhe në buxhetin vjetor, duke marrë parasysh se në disa kategori po na barten dhe mund të mbesin suficit për vitin e ardhshëm.

Vërehet se ka lëvizje pozitive në periudhën gjashtëmujore në rritje të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe kjo theksohet në të hyrat nga Administratës Tatimore dhe të nivelit komunal.

Edhe ne i përkrahim rekomandimet si grup parlamentar, që vijnë për Kuvendin e Kosovës, që të marrë vendim të prerë, në këtë rast Kryesia për projektin kapital Qendra Administrative Protokollare Gërmia ose në të kundërtën duhet të hiqet nga kërkesa buxhetore e Kuvendit për vitin 2010, pasi neve ka ardhur kërkesë në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Kjo sigurisht ka shkuar edhe në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa.

Për ndonjë kategori të veçantë të shpenzimeve apo të hyrave do të kontribuojnë edhe deputetë të tjerë të LDK-së veç e veç.

Si grup parlamentar, e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kohën e shkurtër.

Vazhdojmë, në emër të AAK-së, deputeti Haki Shatri, e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar raportin gjashtëmujor të buxhetit 2009 dhe konsideron që raporti i plotëson të gjitha kriteret për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Edhe pse është në kompetencë të auditorit të konstatoj saktësinë e të dhënave në raport dhe në pasqyra, ne duam të besojmë që këto të dhëna janë të vërteta dhe mbi bazën e tyre mund të diskutojmë raportin sot në Kuvend.

Grupi Parlamentar i Aleancës thellësisht është i brengosur për faktet që raporti afron në bazë të cilave dëshmojnë shkeljet e të panumërta në procedurat e shpenzimeve buxhetore të cilat për pasojë dëmtojnë fondet publike në përmasa shqetësuese.

Vërejtjet e grupit tonë për mos përzierje të politikës në dy institucione të rëndësishme të shtetit, në Administratën Tatimore dhe në Doganat e Kosovës nuk u morën seriozisht dhe si rezultat në gjashtëmujorin e parë kemi mosplotësim të planit buxhetor të të hyrave për 7.4% në nivel qendror dhe 6.1% në nivel lokal. Është tregues tjetër relativ krahasimi me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 që është 2 deri 3% më i madh, por nuk është i kënaqshëm, sepse ne po shqyrtojmë realizimin e buxhetit 2009 e jo buxhetin e vitit 2008.

Shfrytëzojmë edhe këtë rast që t'i tërheqim vërejtjen Qeverisë që t'i kursejë Administratën Tatimore dhe Doganat nga ndërhyrjet politike dhe ndërhyrje tjera nga jashtë, këto janë mjaftë evidente dhe janë aktuale, përndryshe do të mbahen përgjegjësi për shkatërrimin e strukturës së tyre dhe të vetë bazë materiale të shtetit.

Shpenzimet: Në raport në faqen 20 të pasqyra e investimeve kapitale, keni futur, zoti ministër, kategori që fare s'kanë të bëjnë me investime kapitale dhe prandaj dalin investimet kapitale të realizuara më tepër se në realitet janë.

Fjalën e kam për një kategori të pagesave që s'kanë lidhje me investimet kapitale, pagesa e vendimeve gjyqësore, 2 milionë e 150 mijë euro. Le të më thotë dikush që janë investime kapitale, unë po e tërheq fjalën.

Furnizimi me rrymë, s'është investim kapital, pastaj automjete dhe siç thuhet në tabelë-makineri në vlerë një milion e gjysmë dhe diçka krejt e pa kuptimtë për mua kapital tjetër, e pa definuar 5 milionë e 700 mijë.

Derisa jemi në këtë çështje edhe një herë duam të theksojmë që edhe pjesa më e madhe e investimeve kapitale nuk janë në përputhje me prioritetet e Qeverisë, por degradojnë në projekte që janë të mirëqenies dhe rregullimit të jetës, por assesit s'janë të natyrës së investimeve kapitale që sigurojnë një zhvillim më dinamik të vendit.

Dhe, po ashtu del nga pasqyrat që realizimin e investimeve nuk është proporcional në të gjitha regionet e vendit.

Përkundër deklaratimit pompoz të Qeverisë për zvogëlimin e shpenzimeve vijuese dhe zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe shkeljes së ligjit, shpenzimet e Qeverisë, e kam fjalën vetëm për shpenzimet e nivelit qendror, në gjashtë muajt e parë të vitit 2009 kapin këto shuma. Për telefona janë shpenzuar një milion e 500 mijë euro, për karburant mbi 3 milionë euro, avance për udhëtim zyrtar të pambyllura po e theksoj të pambyllura 750 mijë e 960 euro, dreka zyrtare 501 mijë e 955 euro dhe qiraja një milion e 981 mijë 397 euro.

Krahasimi i të dhënave në raport me tabelën 4 të buxhetit dëshmon shkelje të panumërta të Ligjit të menaxhimit të financave, me ç' rast janë financuar projekte të cilat fare nuk kanë qenë në buxhet. Kështu për shembull, Ministria e Financave ka 4 projekte që nuk i ka në buxhet këtë vit dhe i ka financuar, Ministria e Tregtisë i ka dy projekte, Ministria e Shëndetësisë, 9 projekte, Ministria e Post- Telekomunikacionit, në pjesën e bashkëfinancimit, ka financuar disa projekte në vlerë prej - përtej pjesës për bashkëfinancim, 9 milionë e 300 mijë euro, mbi kuotën e lejuar. Ministria e Kulturës i ka

5 projekte jashtë buxhetit. Kjo nuk është e tëra, sepse në këtë periudhë janë ndërruar destinimet për shumë projekte kapitale mbi kuotën e lejuar me ligj, pra mbi atë 40% që e limiton Ligji për menaxhimin e financave.

Të nderuar deputetë,

Këto veprime janë shkelje të rënda të Ligjit për menaxhimin e financave publike, por njëkohësisht krijojnë hapësirë për keqpërdorim dhe korrupsion me paranë publike. Për këto çështje kam kërkuar shpejtim paraprak dhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave kur e kemi diskutuar raportin dhe në Komisionin për Buxhet dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Financave kanë marrë për obligim që të na kthejnë përgjigjen, por për fat të keq edhe pas një muaji nuk kam marrë kurrfarë përgjigje si shpjegim ose demantim të dyshimeve të mia. Pra, mbetet që dyshimet tona tash për tash janë reale.

Si përfundim, propozojmë që bashkë me miratimin e raportit Kuvendi të ngarkojë Auditorin Gjeneral që menjëherë të bëjë auditimin në pjesë të veçanta të realizimit të investimeve kapitale të jashtëligjshme. E kam fjalën menaxhim specifik për projektet kapitale që s'kanë qenë në buxhet dhe t'i shohim propozimet që jep auditori për shkeljet eventuale.

Te pjesa e dytë për të cilën votuam kundër, jo pse në përmbajtje kemi diçka kundër propozimit të kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe pajtohemi me rekomandimet e Komisionit për Buxhet lidhur me shpenzimet e Kuvendit të Kosovës në gjashtëmujorin e parë, në tërësi pajtohemi, por nuk u pajtuam me procedurën, sepse po na ndodh që në këto ditë shumë herë po vijmë në një situatë në të cilën po merremi vesh ta shkelim ligjin dhe Kushtetutën. Për fat të keq mu kujtua një shprehje të cilën ju kërkoj falje, më duhet ta them në origjinal, në sistemin komunist e dëgjofshim nga udhëheqësit e atëhershëm “veći je stav nego ustav,” ne po merrem vesh ta shkelim Kushtetutën edhe ligjin dhe vendimin t'i bashkojmë dy pika, sepse i kem numrin e votave. Përndryshe jemi për ta aprovuar edhe raportin e Kuvendit për gjashtëmujorin e parë dhe kemi të vetmen vërejtje, të vetmen vërejtje të shpenzimeve, një pjesë e anëtarëve të Kryesisë tregohet në grafikonet e shpenzimeve si shpenzim enorm i karburanteve. Ju i keni shifrat atje nuk po dua t' i përmend, nuk dua të bëhem cikërrimtar, por vërtet shihet që është enorme. Dhe tjerat rekomandime i përkrahim ato që i tha kryetari i Komisionit për Buxhet. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat që janë prezentë këtu dhe për gjithë deputetët!

Raporti gjashtëmujor i vitit 2009 i Buxhetit të Republikës së Kosovës mund të them se është përgatitur në bazë të ligjeve, mirëpo plani i të hyrave, siç e prezantoj ministri i Ekonomisë dhe Financave, është 956.50 mijë, mirëpo realizimi i këtij plani është 420.09 mijë, që do të thotë se në raportin e publikuar nga Qeveria e Kosovës thuhet se gjatë periudhën janar – qershor 2009 janë mbledhur 420 milionë euro ose 43% të planit.

Në një analizë që ka bërë Grupi Parlamentar i AKR-së të hyrat në këtë raport janë të hyra 7% më të vogla se sa plani i cili është paraparë që të mblidhen. Kjo do të thotë se të hyrat janë 58 milionë euro më të vogla se plani, që do të thotë se kemi 58 milionë rënie në

planifikim të cilin e keni bërë, ju ministër. Pyetja e parë për ministrin e Financave është: Pse kanë rënë të hyrat në 58 milionë euro ose 7% të krahasuar me planin? Shkaqet e rënies së të hyrave për 58 milionë euro në periudhën janar – qershor 2009. Kjo është më shumë se sa që është dashur të jetë kjo rënie dhe dikush duhet të japë përgjegjësi pse kemi këto rënie kur thuhet se në tatimet kufitare doganore, në tatimet vendore, tatimet e Administratës, kthimet nga ATK-ja ka rritje, po në realitet del e kundërta.

Shkojmë te të hyrat e Administratës Tatimore. Sipas Raportit të publikuar nga Qeveria shihet se Administrata Tatimore e Kosovës gjatë periudhës janar – qershor 2009 ka mbledhur 87 milionë euro, kurse në janar – qershor 2009, janë mbledhur 107 milionë euro, sipas këtij raporti të publikuar nga Qeveria shihet se të hyrat e Administratës Tatimore të Kosovës kanë rënë rreth 18%, ku do të thotë se janë minus 20 milionë euro më pak. Nga ky raport shihet se ka rënie definitive në Administratën Tatimore të Kosovës, kryesisht në tatim në fitim që do të thotë se bizneset e mëdha që kanë qarkullim me miliona euro nuk i shlyejnë tatimet nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe këtu ministri duhet të marrë përgjegjësinë nga drejtori i Administratës Tatimore kur dihet se deri më tani tre drejtorë janë ndërrua në Administratën Tatimore dhe njëkohësisht është vërejtje e Fondit Monetar Ndërkombëtar që Administrata Tatimore të punojë në ligjet me të cilat funksionon.

Pyetja e dytë për ministrin- Pse të hyrat nga Administrata Tatimore e Kosovës kanë rënë 33 milionë euro shkaqet? Ku këto rënie e dëmtojnë buxhetin e Kosovës? A ka korrupsion brenda Administratës Tatimore, zotëri ministër, pasi je prezentë këtu?

Në rast se shkojmë te shpenzimet, në raportin janar – shtator të publikuar nga Qeveria shihet se nuk janë rritur vetëm shpenzimet kapitale siç thotë Qeveria, por edhe në luks të Qeverisë ka rritje të shpenzimeve kapitale, shpenzimeve mallra dhe shërbime. Mund të them këtu shihet se ka rritje, sidomos në shpenzimet e udhëtimit, telefonisë, shpenzimet kontraktuese, për dreka dhe darka. Nuk di si do të arsyetohen këto edhe pse janë formuar edhe tri ministri të reja, mirëpo prapëseprapë e dini mjaftë mirë se ka rekomandime edhe prej Fondit Monetar Ndërkombëtar që të ulët numri i shpenzimeve ku këtu ka rritje 11% të shpenzimeve në mallra dhe shërbime, zotëri ministër.

Pastaj, kalojmë te shpenzimet kapitale ku ceket se ka rritje 35%, mirëpo kolegu pak më parë e potencoi se nuk janë realizuar të gjitha shpenzimet kapitale.

Dhe, pikë tjetër me rëndësi tek unë do të ishte - pse jepen edhe 40 milionë euro KEK-ut prapë, kur KEK-u deklarohet se 80% të hyrave është kah i realizon vetë? A janë kah keqpërdoren këto të holla nga buxheti i taksapaguesve të Kosovës? Do të thotë se mbetet përgjegjësi e Qeverisë dhe e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të shihet se si bëhet planifikimi i buxhetit të Kosovës dhe si shpenzohen parat e taksapaguesve të Kosovës? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar ministra, shumë pak jeni prezentë këtu,
Kisha kërkuar nga kamerat që ta fokusojnë prezencën e Kabinetit qeveritar sot kur diskutohet një temë – shpenzimi i parasë të qytetarëve më të varfër të regjionit, njëkohësisht edhe prezencën e koalicionit qeverisës, sa deputetë janë prezentë. Dhe, kjo

thotë ndoshta të tërën se sa është i interesuar ky koalicion qeveritar që vërtet të merret me problemet e shumta të qytetarëve të Kosovës?

Megjithatë, ndoshta kjo kishte mjaftuar, por unë po i them edhe disa fjalë.

Për Lidhjen Demokratike të Dardanisë, ky Raport gjashtëmujor i të hyrave dhe shpenzimeve të Buxhetit të Kosovës për vitin 2009 është edhe një dëshmi se kjo Qeveri, i vetmi funksion që mund ta bëjë për qytetarët e Republikës së Kosovës është ana deklarative e mënyrës së propagandës ose fushatës, e cila u zgjat për tërë mandatin e tyre duke shpenzuar kohën dhe pa u marr seriozisht asnjëherë me asnjë problem.

Çështja e grumbullimit të hyrave dhe mënyra e menaxhimit të buxhetit të këtij populli të ndershëm e të varfëruar skajshmërisht lë shumë për të dëshiruar.

Në bazë të raportit shohim se të hyrat për gjashtëmujorin e parë janë realizuar 43.9%, që krahasuar me vitin paraprak, pra 2008, ka rritje vetëm 2.9%. ose, vërtet në bazë të kësaj rritje dua të pyes- A ju thotë vërtet gjë kjo ngritje, ose a mjafton ky krahasim që ne të kuptojmë se sa ka zhvillim ekonomik në Kosovës, sa janë përmirësuar politikat fiskale për të pasur më shumë të hyra ose sa po arrini ju që ta luftoni: informalitetin, korrupsionin, kontrabandën dhe krimin e organizuar e të tjera?

Ndërsa, kur lexojmë dhe analizojmë raportin e juaj me të cilën paraqitni shpenzimet e gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, prapë i referohemi retorikës së juaj kur çdo ditë thoni: zero tolerancë korrupsionit, ulje të shpenzimeve të Kabinetit qeveritar dhe administratës në përgjithësi në Kosovë, transparencë, mirë menaxhim, ndarje e drejtë e buxhetit, zhvillim ekonomik e punësim, por realisht nuk i shohim në këtë raport këto.

Gjithsej të dalat apo shpenzimet janë realizuar 33.7%, edhe pse kjo përqindje është prapë e vogël është e arritur nga pagesa e subvencioneve dhe transfereve, paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, ndërsa investimet kapitale janë realizuar vetëm 17%, duke u pajtuar me parafolësin tim, kolegun tim i cili i përshkroi të gjitha ato zëra buxhetore që hynë në shpenzime kapitale e që realisht s' kanë të bëjnë asgjë me investime kapitale.

Çka thotë kjo, se vazhdon trendi i shpenzimeve në muajt e fundit pa kontroll vetëm sa për të shpenzuar apo sa për t'i përmbushur shifrat që i keni vënë obligim vetit. Por, realisht duke shkelur ligjin, sepse Ligji i prokurimit nuk lejon që shpenzimet të bëhen në dy muajt e fundit të vitit. Nga kjo rrjedh se ju për katër muaj duhet të shpenzoni 43% të buxhetit në investime kapitale. Kjo është e pamundur, e parealizueshme. Kjo na tregon paaftësinë, keq menaxhimin dhe jo transparencën e kësaj Qeverie.

Shpenzimet të papranueshme për një buxhet çfarë e ka Republika e Kosovës është për shembull: shpenzimi dreka, darka për gjashtë muaj vetëm për Qeverinë e Kosovës mbi një gjysmë milionë euro.

Shpenzim i karburantit, vetëm institucione qendrore mbi tre milionë euro. Telefon, mbi një milionë e 500 mijë euro. Është shqetësuese dhe jo ligjore për gjashtë muaj, 750 mijë euro avance të pambyllura. Jo ligjore është kur raportohet për projekte me miliona euro, të cilat nuk figurojnë fare në buxhet.

Të nderuar deputetë,

Anëtarët e këtij kabineti paguajnë manifestime të ndryshme me qindra e mijëra euro kesh, me para në dorë. Kjo tregon se keqpërdoret paraja e qytetarit të Kosovës. Ky raport jep një performancë tejet negative të kësaj Qeverie.

Lidhja Demokratike e Dardanisë është e shqetësuar për keq menaxhimin, shkeljet ligjore, jo transparencën dhe korrupsionin që po e përformon në të gjitha raportet që bëhet brenda dhe jashtë Kosovës për Kosovën.

Një shembull i keq menaxhimit, keqpërdorimeve është edhe raporti i auditimit për vitin 2008. Shumë zhgënjyes për Kosovën është raporti i Komisionit Evropian për Kosovën. Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj nuk mund të jenë peng i keqqeverisjes tuaj. Lidhja Demokratike e Dardanisë kërkon afate kohore për këtë Qeveri dhe kërkon nga auditori i jashtëm që të bëhen urgjent të gjitha këto pika që i keni fokusuar dhe dyshimet të bëhet auditimi dhe brenda këtij viti të paraqitet auditori, përndryshe Qeveria duhet së paku të japë dorëheqje morale.

Ne sot në këtë pikë të rendit të ditës i bashkuam të dy raportet edhe të Kuvendit të Kosovës dhe unë krejt edhe 2 – 3 fjalë për Kuvendin, natyrisht duke i mbështetur edhe rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni i Buxhetit dhe Financave.

Të nderuar deputetë të Kuvendit,
Natyrisht, shpenzimet kapitale zero dhe me vite të tëra është një gjë e tillë.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës vuajnë për vend, për zyra, ndërsa ndahen çdo vjet mjetet për investime kapitale, për objekte dhe Kuvendi i Kosovës nuk është në gjendje për t'i realizuar këto. Çfarë do më shumë për të thënë se sa shembullin që e kemi sot në këtë sallë që e mbajmë seancën, ne e kemi pasur pushimin veror prej një muaj dhe Kuvendi i Kosovës nuk ka mund të planifikojë që salla të rinovohet dhe deputetët të vijnë t'i realizojnë seancën ashtu si duhet ose jo vetëm sallën e Kuvendit, por në tërë objektin e Kuvendit, me vite të tëra nuk është investuar ndërsa mjetet kapitale kthehen prej vitit në vit- barten dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës bëjnë aktivitetet e tyre nëpër hollët e Kuvendit.

Është natyrisht e patolerueshme në fillim të këtij viti është aprovuar buxheti për menaxhimin e financave për vitin 2009 dhe tek vija buxhetore për paga dhe mëditje ky Kuvend ka votuar. Kryesia e Kuvendit nuk ka të drejtë t'i shkelë vendimet e Kuvendit dhe Ligji për menaxhimin e financave duhet të respektohet dhe të implementohet.

Unë po e përmbyll me kaq, të nderuar deputetë të paktë nga mazhuranca, ju falënderoj për vëmendje.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Në emër të Grupit Parlamentar “7+” Myfera Shinik.

MÜFERA ŞİNİK: Teşekkür ederim, Sayın bakanlar, milletvekilleri

Bugün burada Kosova Cumhuriyetinin 2009 yılının ilk altı aylık bütçesi görüşülüyor. Yasalara uygun bir şekilde gelir ve giderlerin şeffaf bir şekilde işletlendiği gösterilmektedir. Planlaştırılmış projeler uygulamaya uyanlaarı uygunluk sonucunda iyi bir şekilde değerlendirilmiş halde görülmektedir. Hükümet tarafından harcamaların projelere göre uygun bir şekilde ayrılmasının gerçekleştirilmesi gerekmektedir.

7+ Parlamentar Grubu olarak verilen önerilerle birlikte, Raporu kabul etmekteyiz.

Bunun dışında Kosova Cumhuriyeti Meclisinin 2009 yılının ilk altı aylık harcama Raporuyla ilgili bütçe ve finansi Komisyonun sunmuş olduğu önerileri görüşülmektedir. 03L167 ile 03L105 numaralı yasalara göre Kosova Cumhuriyetinin 2009 yılı bütçesinin sınırlarını aşmadan bütçe komisyonunun vermiş olduğu önerilerin kabul edilmesinin gerektiğini görmekteyiz. Bununla birlikte bu Raporu da 7+ Parlamentar Grubu olarak kabul etmekteyiz.

Teşekkür ederim, Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk shoh të paraqitur për diskutim.

Kalojmë në radhën e deputetëve të paraqitur për diskutim. Kisha me ju lutë që të vazhdojmë me marrëveshjen e seancës para kësaj që diskutimet të zgjasin 5 minuta, meqë jemi vonë. Po e di, besoj që s'keni kundër. Vazhdojmë, fjalën e ka deputetja Qamile Morina, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Syla.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, deputetë të nderuar,

Do t'i adresoj disa vërejtje konkrete lidhur me raportin gjashtëmujor të buxhetit për vitin 2009. Në faqen 6 vërehet se të hyrat nga tatimet në Dogana në gjashtëmujorin e parë janë realizuar me vetëm 40% të planit vjetor, duke qenë se këto të hyra janë shumë me rëndësi për buxhetin e shtetit me që sigurojnë rreth 70% të hyrave të gjithëmbarshme, atëherë kjo ngecje mund të jetë me pasoja për buxhetin e vitit 2009.

Në të njëjtën faqe vërehet se Qeveria qendrore ka arritur të shpenzojë vetëm 32.7% të planit vjetor. Kjo tregon se si zakonisht shpenzimet publike janë përqendruar në fundin e vitit që lë hapësirë për dyshime. Në rastin e Kosovës së vitit 2009 kjo mund të interpretohet edhe si tendencë e Qeverisë që shpenzimet publike t'i përqendrojë në kohën para zgjedhjeve lokale të nëntorit.

Në faqen 14 shihet se rënia e të hyra nga tatimi në paga dhe ai në fitim më tepër se është kompensuar nga rritja e TVSH-së, kjo tregon se ndryshimet tatimore nuk kanë qenë neutrale, ato përveç se ndryshimit të disa tatimeve kanë synuar edhe rritje në të hyrat buxhetore. Kjo do të thotë se taksapaguesit nuk janë në pozitë më të volitshme se në periudhën e para ndryshimeve tatimore, porse është e kundërta.

Në të njëjtën faqe vërehet edhe një e hyrë shumë e ulët e buxhetit nga interesi bankar, do të ishte mirë të jepeshin sqarime, zoti ministër, se si është e mundur që përkundër rezervës bankare që ndodhet në konto të Bankës Qendrore, të hyrat nga interesi të jenë aq të ulëta.

Në faqen 16 shihet se të hyrat komunale në disa komuna kanë shënuar rritje të ndjeshme: Klina, Ferizaj, Vitia, Podujeva, Prishtina, Artana, Hani i Elezit, porse kanë stagnuar ose shënuar rënie në disa komuna tjera si: Gjiçani, Peja, Rahoveci, Prizreni apo Malisheva.

Cilat janë mekanizmat që Qeveria po shfrytëzon për ta inkurajuar rritjen e të hyrave vetjake të komunave dhe që në masë këto mekanizma po shënojnë suksesin e dëshiruar?

Projektet kapitale të planifikuara në Ministrinë e Shëndetësisë, siç shihet prej listës disa prej tyre sidomos kur është fjala për renovime objekteve, nuk janë realizuar ende. Duke ditur se shumë shpejt prishet moti dhe renovimet bëhen teknikisht të pamundura, shtrohet pyetja se pse këto renovime nuk kanë filluar me kohë?

Shfrytëzimi i mjeteve për investime kapitale të Ministrisë së Shëndetësisë për këtë gjashtëmujor është më i ulët se në vitin e kaluar në të njëjtën kohë dhe atë vetëm 15%. Përse, zoti ministër, po ndodh kjo kur e dimë se sa e rëndë është gjendja në shëndetësi?

Ky Kuvend, nuk di se për të satën herë është duke dëgjuar për projektin e Kardiokirurgjisë, me vite të tëra janë shpenzuar mjete për këtë projekt dhe besomëni ky projekt është në fazën fillestare. Përse nuk ka filluar fare shfrytëzimi i mjeteve të ndara për këtë projekt në këtë vit, zoti ministër? Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm që Kardiokirurgjia shtetërore është e interesit të lartë kombëtar, duke pasur parasysh se sëmundjet kardiovaskulare janë një ndër shkaqet kryesore të vdekshmërisë si dhe shpenzimi enorm i Ministrisë së Shëndetësisë që bëhet për trajtimin e këtyre pacientëve jashtë vendit- është enorm.

Projekti i Onkologjisë gjithashtu është i interesit të lartë kombëtar. Në çdo shtet serioz do të ishte objekt i hetimeve për mos fillimin e punës edhe pas inaugurimit. Janë investuar me miliona euro, ka aparaturën më moderne në rajon, kurse pacientët tanë po shpenzojmë para enorme për këtë shërbim jashtë vendit.

Zoti ministër,

Shteti i Kosovës nuk guxon të lejojë varfërimin ekstrem të qytetarëve tanë vetëm pse janë të sëmurë. Dua të përmend edhe projektin e sistemit të informimit shëndetësor. E kemi të qartë se fillimi i çfarëdo reforme shëndetësore si dhe themelimi i skemave të sigurimit shëndetësor është i bazuar në të dhënat dhe ekspertizën paraprake që ofron ky sistem, andaj sistemi i informimit shëndetësor do të duhej të ishte me....

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Vazhdojmë me deputeten e radhës, Gjylnaze Syla, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Deputetë të nderuar,

Së pari, dëshiroj të shpreh shqetësimin e thellë për uljen e standardeve të Kuvendit me sjelljen e sotme të Kryetarit, i cili e shkeli Rregulloren e Punës. Taktika që ta zhvendos vëmendjen për një çështje të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, siç është buxheti, është zhvillim i një praktike të keqe dhe ju ftoj të jeni serioz dhe të jeni shembull i respektimit të ligjit dhe rendit.

I nderuari zoti kryesues,

Raporti gjashtëmujor i buxhetit 2009 është raport jo transparent, i mangët dhe i vonshëm. Është jo transparentë, sepse nuk përmban të dhënat se çka është planifikuar dhe çka është realizuar gjatë gjashtëmujorit.

Raportimi bazohet në krahasimin mes gjashtëmujorit 2008 dhe 2009. Është i mangët, sepse Qeveria nuk ka sjellë raportin me planifikimet, të hyrat dhe të dalat për të ditur se si ka punuar për gjashtë muaj. Është i vonshëm, sepse sipas Ligjit për menaxhimin e

financave publike dhe përgjegjësitë, Ministria është dashur t'i raportojë Kuvendit më së voni deri më 30 korrik, gati tre muaj më vonë tani.

I nderuar ministër,

Me qenë se përvoja ime më ka treguar se sa herë kam shtruar çështje të rëndësishme për buxhetin, nuk kam marrë përgjigje nga ju, kështu që ju dorëzoj raportin në mënyrë që të mund të më përgjigjeni në pyetjet që do t'i shtroj.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të filloj me të hyrat e paraqitura në raport.

Prej janarit deri në qershor të këtij viti, të hyrat janë 420 milionë, shuma e grandeve është afër 7 milionë e gjysmë, do të thotë, gjithsej 427,5 milionë euro. Të dalat, kur të shtojmë edhe grandet, janë 404 milionë e gjysmë. Nga viti 2008 është bartur keshi prej 462 milionëve, si dhe grandet në shumën afër 13 milionë, kështu që në fund të vitit 2008 janë grumbulluar 475,5 milionë euro.

Nga këto, Qeveria ka arritur t' i shpenzojë 404 milionë euro, kurse deri në fund të qershorit kanë mbetur pa u shpenzuar 463 milionë euro. Me këtë Qeveria ka treguar se është e paaftë për menaxhimin dhe shfrytëzimin e buxhetit, kështu që sikurse në vitin 2008, kur 35% të buxhetit janë shpenzuar në dhjetor, do të ngjajë ashtu edhe në këtë vit. Kjo e bën buxhetin të paefektshëm dhe është e papranueshme.

Zoti ministër,

Pyetja ime është se prej 462.91 milionë eurove, sa janë, sa investime janë bërë nga muaji janar deri në qershor 2009? Më tej, ju lutem, shikoni faqen 14 të raportit, ku janë paraqitur të hyrat e Administratës Tatimore. Na thoni sa janë të hyrat nga ndëshkimet, sa janë të hyrat nga mos pagesa e tatimit, ku janë të paraqitura këto? Mungesa e këtyre shënimeve ngrit menjëherë dyshimin për keqpërdorime.

Në të njëjtën faqe keni të hyrat jo tatimore të ATK-së, ku është shënuar se në gjashtë muajt e parë të vitit 2008 interesi bankar nga të hyrat tatimore ka qenë mbi 6 milionë e 700 mijë, kurse në gjashtëmujorin e vitit 2009 interesi bankar ka rënë mbi 1 milion e 700 mijë, që është rënie e interesit për 5.5 milionë euro ose 83%. Pse ka ardhur deri te rënia e interesit për 83%? Pse qytetarët e Kosovës kanë humbje prej 5.5 milionë euro? Cila është logjika e rënies së interesit, cila është politika e investimeve? Jo vetëm që nuk i investoni në Kosovë të hollat që gjenden jashtë vendit, por edhe të hollat e Qeverisë i investoni jashtë Kosovës.

Te të hyrat e nivelit qendror, zoti ministër, në faqen 15, nën kategorinë e të dhënave - shitja e pasurisë së shërbimeve, është shuma prej mbi 6 milionë e 700 mijë euro. Për çfarë shitje të pasurisë është fjala?

Të hyrat nga grandet e përcaktuara nga donatorët, ministër, në faqet 9, 10, janë afër 7 milionë e gjysmë. Kam disa vërejtje dhe pyetje.

Nga këto, për rrogat mujore shfrytëzohen 971 mijë. Është rritje diku prej 1239%, sidomos kur merret parasysh se në vitin 2008 shpenzimet e rrogave kanë qenë 72 mijë e 593 euro. Rritja e mëditjeve me orar...

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Faleminderit edhe për deponimin e vërejtjeve me shkrim tek ministri, kështu që vazhdojmë me diskutimet.

(Reagime nga salla)

Pesë minuta jemi marrë vesh që të jenë diskutimet. Unë kërkoja që nëse ka kundër asaj marrëveshje që është vazhduar në seancën e kaluar dhe regjia ia mori... Meqë ishte marrëveshje e mëhershme, ne vazhduam sot edhe pse është seancë e re.

(Vazhdojnë reagimet)

Mirë, meqë nuk e vumë më herët në votim, kush është që diskutimet e deputetëve të jenë 10 minuta? Mirë, regjia le të vazhdohen diskutimet 10 minuta, meqë Rregullorja i jep 10 minuta.

(Ndërpritet incizimi)

T'i vazhdohet fjala deputetes. Nuk kemi shumë diskutues, kursehuni kohën, mos i përsëritni gjërat dhe mbarojmë shpejt. Regjia, t'i vazhdohet fjala deputetes.

GJYLNAZE SYLA: Për çfarë rritjesh të shpenzimeve në rroga dhe mëditje bëhet fjalë? Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 3.8 milionë euro, kurse për shpenzimet kapitale 790 mijë euro. Është shumë e qartë se përfituesit e këtyre shpenzimeve janë qeveritarët e jo qytetarët. Këto mjete nuk po hyjnë në llogari të buxhetit. Kërkoj, zoti ministër, destinimin e saktë për këto mjete ku evidentohen ato, në cilat banka po mbahen?

Të dalat. Derisa është dhënë arsyetimi për rritjen e pagave dhe të mëditjeve në gjashtëmujorin e vitit 2009, nuk ka asnjë arsyetim për rritjen e shpenzimeve prej afër 11% për mallra dhe shërbime. Për shërbimet kontraktuese janë shpenzuar 10 milionë e 642 mijë, krahasuar me vitin 2008, 62% më shumë. Është e paqartë se çfarë janë këto shërbime kontraktuese, na shpjegoni!

Do të ndalem edhe te shpenzimet tjera. Edhe pse pat premtuar dhe marrë vendim Kryeministri për zvogëlimin e shpenzimeve të derivateve dhe lëndëve djegëse, të dhënat tregojnë se janë shpenzuar mbi 8 milionë. Gjithashtu, për avancë janë shpenzuar 2 milionë e 861 mijë. Për çka? Derisa Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka specifikuar se ka shpenzuar një milion e 765 mijë euro, megjithatë nuk ka shpjeguar se ku janë një milion tjera?

Për marketing janë shpenzuar 2 milionë e gjysmë. Çfarë produkti të ri keni zbuluar, zoti ministër, për 2 milionë e gjysmë, apo janë para të popullit që po i merr Qeveria për të bërë fushatë zgjedhore?

Për mirëmbajtje janë shpenzuar mbi 8 milionë, çka po mirëmbani, farë kompanie globale si Gjeneral Motors?

Qeveria ka shpenzuar për telefona mbi një milion e 600 mijë euro, kurse të gjitha komunat së bashku mbi një milion. Te shpenzimet kapitale nuk ka sqarim se çfarë kuptimi ka kapital tjetër, çfarë është ky kapital tjetër, i cili përfshin shumën mbi 5 milionë e 700 mijë euro?

Po ashtu, në shpenzime kapitale janë futur pagesat, vendimet gjyqësore prej 2 milionë e 150, cilat janë ato vendime gjyqësore që i keni futur nën kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Për mbrojtjen nga ndotja shpenzimet janë zero, në anën tjetër sot folëm se janë alarmante gjendjet dhe të dhënat për ambientin.

Zoti ministër,

Ju thatë se po e vërejnë qytetarët se u është përmirësuar jeta. Unë ju them se qytetarët me të vërtetë po e ndjejnë në lëkurën e tyre veprimin dhe punën e Qeverisë, sepse po varfërohen çdo ditë. A ndiheni të përgjegjshëm?

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Vazhdojmë me deputetin e radhës, Naser Rugova, le të përgatitet deputeti Gani Geci.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të ndalem pikërisht në pikën e rendit të ditës, në pjesë të rëndësishme të këtij raporti për shpenzimet gjashtëmujore të buxhetit, te të dalat sipas organizatave buxhetore, faqja 52 dhe 53, ku bëhet fjalë për të dalat e Ministrisë së Shëndetësisë.

Dëgjoni një të dhënë këtu, që është për libër të Ginit. Ministria e Shëndetësisë, kodi 11 mijë e 150, pagesa për sindikatat, 93 mijë e 513 euro. Kjo nënkupton 187 mijë 26 euro në vit. A ka ndonjë shtet në botë që buxheti i shtetit financon sindikatat? Nuk e kemi hartuar ne, zoti ministër, këtë dokument, por e ka hartuar Qeveria, pjesë e së cilës jeni ju dhe na e keni sjellë në Parlament, nëse e keni bërë gabim. Dhe, ne u takuam me kryetarin e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë dhe ai është i shokuar, do të thotë, nga ky dokument dhe nga ky jo seriozitet. Pra, keni obligim moral t'i sqaroni opinionit se çka është duke ndodhur me këto shifra në një dokument të tillë të rëndësishëm si ky? Ky është dokument i shtetit, është dokument qeveritar dhe ka ardhur që të diskutohet në Parlament. Pra, nuk e kemi hartuar ne si opozitë, por e ka hartuar Qeveria dhe keni obligim moral tani t'ia sqaroni opinionit.

Pastaj, 13 mijë e 495 mijë euro – Kodi – Kompensimi për vendime gjyqësore, thotë, 1.572.709 euro. Si arsyetohen këto, çfarë logjike kanë këto shifra, zoti ministër i Ekonomisë dhe Financave, pasi që për Ministrinë e vet ministri i Shëndetësisë s'qenka në rrjedhë. Me këto mjete do të duhej të investohen shpenzimet kapitale, jo në vlerën 15%, por bile ta ndërtoni një emergjencë nacionale, sepse kemi parë, me helmimin e nxënësve të Fushë Kosovës, si kollabon sistemi shëndetësor. S'kemi ku t'i shtrijmë 50 veta, ta shohim rininë të shtrirë nëpër dysheme të Infektives dhe të Emergjencës.

Pastaj, avancë për udhëtime zyrtare 59.741 euro. Kjo tregon që as Ministria e Punëve të Jashtme nuk do të duhej t'i shpenzonte.

Ku keni qenë dhe çka i keni sjellë Kosovës? Nëse është kjo kështu siç po shkruan, 60 mijë euro për gjashtë muaj, 10 mijë euro në muaj i keni shpenzuar, do të thotë, avance për shpenzime jashtë. Do të thotë, kjo nënkupton që diku 120 mijë euro në vit mesatarja. Ky dokument është këtu që po e citoj, do të thotë, nuk e kam të shpikur nga vetja.

Pastaj, kemi investimet kapitale. Te Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pse nuk është ndërtuar laborator veterinar? Do të thotë, kemi 10.8% të realizimit të investimeve kapitale. Një laborator i shkallës së tretë, biosigurisë, për të cilin Kosova ka aq shumë nevojë. Pastaj, pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura, plot gojën e keni 2 milionë fidanë, 5 milionë fidanë, unë frikohem që edhe sipërfaqet e Siberisë po doni t'i pyllëzoni, kurse shikoni këtu të dhënat që vijnë, do të thotë, 0% implementim të këtyre shpenzimeve kapitale. Dhe, prapëseprapë këto janë të dhënat që na i ka sjell Qeveria në Parlament dhe kjo tregon për planifikimin buxhetor dhe për kapacitetet e kësaj Qeverie për shpenzimin e buxhetit të taksapaguesve kosovarë.

Pastaj, zoti ministër, renovimi i Klinikës së Neurologjisë, sistemi i gazrave medicinale, rrjeti i avullit dhe ujit të ngrohtë e të tjera, janë mjaftë margaritarë këto që tregojnë që janë alokuar mjetet, janë zotur 0%, 4.3% implementim. Do të thotë, kjo tregon që Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, por edhe dikasteret të tjera të linjës të Kabinetit qeveritar vërtet as nuk janë në gjendje ta bëjnë një planifikim adekuat institucional, kurse për implementim as që bëhet fjalë, kurse për destinim të mjeteve dhe dështime atje ku duhet këto investime ta përmirësojnë jetën dhe cilësinë e qytetarit, as që bëhet fjalë.

Te Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, zoti ministër, ende vazhdon odisejada me fshatin Hade. Deri kur shteti i Kosovës do ta përmbyllë më këtë çështje, që vërtet është bërë e pa tolerueshme?

Pastaj, pastrimi i shtratit të lumit Istog, 9.330 euro, 0%. Lumi Mirusha, është një pasuri kombëtare - ujëvarat dhe kanjoni. Bile, zoti ministër, në vendet turistike dhe në pasuri kombëtare që kanë rëndësi për vendin dhe zhvillimin e turizmit, nga një 10 mijë euro është e hairit që edhe atje të investohen, sepse po del një përqindje tejte e ulët dhe vetvetiu me letra të juaja po dëshmoni që nuk po keni aftësi dhe kapacitete të nevojshme t' i shpenzoni mjetet e buxhetit të taksapaguesve kosovarë.

Te Ministria e Administrimit dhe e Qeverisjes Lokale, ndërtimet e zyrave të vendit në Kosovë, domethënë, alokohen, zotohen zero për qind zotim, ose te ndërtimi i palestrës sportive në Istog, paramendoni 271.950 euro i zotoni Ministria e Kulturës, Rinisë e Sporteve, që 4 vjet ka mbetur një skelet ndërtesë që e kanë zënë edhe një terren sportiv, rinia nuk kanë ku t'i ushtrojnë aktivitetet sportive, që del një margaritar tjetër i Ministrisë së Pushtetit Lokal, shohim që edhe Ministria e Pushtetit Lokal i ndanë 100 mijë euro, ndërsa implementim i këtij investimi dedikuar për një komunë që i ka 70.000 banorë dhe nuk ka palestër, 0% implementim. Kjo tregon do të thotë për mungesë të kapaciteteve- vizion, planifikim të qëndrueshëm dhe implementim të projekteve në të mirë të qytetarëve të vendit.

Pastaj te komunat, domethënë, ka një realizim të shpenzimeve buxhetore, nëse llogaritet diku as një 25% e do të duhej të ishte 50%, domethënë 50% të planifikimit të zotimit të alokimit dhe të zbatimit në praktikë të këtyre investimeve kapitale, janë dështim.

Nëse e shikojmë, dy komuna më kanë bërë përshtypje: komuna e Dragashit 4% dhe komuna e Istogut 5%. Komuna e Istogut si investim kapital e numëron ndërrimin e dritareve të komunës, pas dhjetë vjetëve që janë në pushtet. Nëse ndalemi dhe analizojmë me të drejtë këtë raport që e keni bërë ju, të nderuar Kabinet qeveritar, zoti ministër, atëherë del se 50% të buxhetit të Kosovës nuk implementohet sipas dinamikës kohore, kur po vjen çështja e shpenzimit të mjeteve, dy muajt e fundit po bëni averzion

pastaj me mjetet buxhetore dhe në thesaret e shtetit dhe tani nuk ka kohë as të implementoni projekte që po e destinoni buxhetin... dhe po orientoni në vende të gabuara, sepse ka filluar koha e vjeshtës dhe po na shkojnë paratë në suficit, kurse qytetarët e Kosovës po vuajnë për projektet që Qeveria nacionale ka obligim thjesht t'i implementojë. Nuk dua t'ju marrë kohë më shumë, por vërtet kjo tregon për mungesë vizioni, plani aksionar, planifikimi buxhetor dhe mungesë efëience të ekzekutivit të vendit që t'ju dalë përballë kërkesave dhe halleve të shumta të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Deputeti i radhës i paraqitur për diskutim, Gani Geci, le të përgatitet Driton Tali.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kur flasim për Buxhetin e Republikës së Kosovës besoj se e kemi që qatë se po flasim për taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës e jo për paratë e babagjyshit. Po e them këtë, sepse duke dëgjuar parafolesit e mi, del një fjalë popullore: "a u kënaqëm u kënaqëm", unë e bali me paratë e bashkallakut, "herë unë, herë bali", herë Fatmiri, herë Hashimi. Më duhet gjithsesi ta them edhe një fjalë që kam dëgjuar nga deputeti Emrush Xhemajli, kryetar i Partisë Socialiste, i cili tha që më kanë lënë vetëm me parullën "Parti, Enver" shokët e mi dhe tash e gjithë parulla është: "Parti, tender, jemi gati kurdo herë".

Të nderuar deputetë,

Ne kur bisedojmë për paranë publike, jemi të detyruar që të jemi përgjegjës edhe për atë që e themi, por edhe atë që e bëm në letër. Nuk është e drejtë që në një fshat, ta zëmë, të ndërtohet një shkollë që ka tri kate dhe mezi mbushet kati i parë dhe një fshat më poshtë apo në qytet nxënësit të punojnë në tri turne. Atëherë, me të drejtë lind pyetja: si është e mundur që Qeveria e Republikës së Kosovës të investojë në një fshat, një shkollë tri katërshe, me 27 klasë dhe mezi mbushen 7 klasë, ndërsa në qytet nxënësit shkojnë në shkollë me tri turne? Atëherë, si po ndahet buxheti i Kosovës? Unë nuk po dua ta përmend cili fshat kësaj radhe për shkak se është një fshat ku janë shumë patriotë atje, por po ma merr mendja që po e dini, por në qytetin tim po flas prapë, në shkollën fillore, aty mësimi mbahet në tri turne, dhe kjo është e padrejtë. Do duhej që në qytetin tonë të ndërtohej një shkollë fillore dhe atje të mos mësohet më në tri turne dhe mos të ndërtohen shkolla trikatëshe nëpër fshatra ku nuk janë mbi 7 klasë, ndërsa janë 27 klasë, kjo është shumë e padrejtë. Prandaj, kur ta ndajmë buxhetin dhe kur të bëjmë harxhimin e buxhetit, ta bëjmë ashtu si duhet dhe mos të vlejnjë ato parullat: "parti – tender", sepse kjo është duke u parë prej balloni që të gjithë ministrat, por edhe zëvendësministrat, por edhe shoferët ministrave edhe të bijtë e shoferëve kanë bërë automjete marramendëse që nuk mund të merrni me mend që kushtojnë nga 70.000 euro. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues! Unë e dëgjova me vëmendje ministrin dhe krejt atë që e tha. Këtu është në faqen 18 – te mallrat dhe shërbimet e përshkruan shumë mirë fjalimi e tij. Pika - shpenzimet në marketing janë rritur 126%. Pra, kjo Qeveri është veç marketing e kurrëgjë tjetër. Është qeveri e televizionit, e billboardave, e

gazetave, Qeveri e cila premtonte rritje të rrogave në arsim, në shëndetësi, auto-udha, e nga ana tjetër nuk janë në gjendje ta bëjnë planifikimin e një buxheti brenda dy-tre muajve, pastaj arsyetohen se edhe Gjermania nuk ka mund të bëjë prognozë me kohë edhe ata kanë gabuar, domethënë, duke tentuar që ta relativizojnë punën e hartimit të buxhetit, e ngatërrojnë një çështje se në Gjermani buxheti bëhet për buxhet e jo për marketing, ashtu siç thanë parafolësit e mi, sepse kemi të bëjmë me paratë publike e jo paratë e partisë në pushtet.

Në faqen e parë të këtij raporti thuhet se ngritja e të hyrave tete a tete, krahasuar me vitin 2008 është 3% dhe nëse i shikojmë muaj për muaj të hyrat që i kemi pasur, do të shohim se një gjë e tillë po reflektohet në mënyrë indirekte. Arsyeja është se deri në muajin prill nuk është paraqitur deflacioni, andaj edhe inflacioni i bartur nga viti 2008 e ka përmbushur dhe intensitetin afarizmit, e ka përmbushur atë buxhet të cilin e kemi. Mirëpo, nga muaji maj deflacioni fillon ta tregojë të veten, po ashtu edhe rënia e remitancave dhe si rezultat kemi ulje të fuqisë blerëse, domethënë edhe ulje në buxhet. Nëse e marrim dhe e shikojmë muajin korrik, e shpjegon shumë mirë këtë trend. Muajin korrik nuk e kemi këtu, ne e kemi deri në qershor, por në qershor fillon ta tregojë deflacioni atë farë efektin e vet, nuk është realizuar. Shikoni, buxheti i planifikuar është realizuar në muajin korrik 50 milionë për shkak se buxheti deri në fund të korrikut është 321 milionë dhe këto janë shënime që janë marrë nga Doganat, që do të thotë për 8 milionë është më i ulët se sa që është planifikuar dhe nëse e krahasojmë me korrikun e vitit të kaluar, po ashtu edhe qershorin, zoti ministër, krahasoj figurat, do ta shohësh se ke më pak se që ke pasur në vitin 2008. Andaj, poenta është kjo, se kjo rritje 3% krahasuar me vitin 2008 nuk është e saktë. Tashti fillon ajo kriza globale t'ju paraqitet në ato kontot tuaja edhe në fund të vitit do ta shihni se sa të dëshpëruar do të jeni.

Unë po flas, në javën e 30-të të vitit është realizuar buxheti i paraparë 42%, nëse nuk gaboj, gjersa për javët e mbetura që janë 22 javë për shkak se viti i ka 52 javë, pra për 58% të kalendarit, kanë mbetur edhe 344 milionë t' i inkasosh, që nuk do të mund të i inkasosh nga fakti se, siç thashë, për 58% ke inkasuar vetëm se 48% që është ulje 10% e asaj që ke paraparë, nëse po them, nëse gjërat vazhdojnë kështu, por do të përkeqësohen. Pse u ndala këtu, u ndala për të treguar se këtë buxhet e ke për marketing, pa u futur edhe një herë në ato detalet, mënyrën se si e shpenzoni buxhetin, se si për shembull për magjistralen M2 dhe M9 paguani ekstra para, edhe pse projektet kanë ecur, që është shkelje drastike e procedurave të prokurimit, ato e dini shumë mirë. Me sa kam unë informata, te M2 apo M9 dallimi është 10 milionë më shumë, edhe pse përsëri po ta përsëris, marrëveshjet apo kontratat janë nënshkruar shumë më herët, pra paraprakisht. Pastaj, kemi edhe disa deklarata tuja që jepni konform apo në kuadër të këtij buxheti, siç është rritja 4.4% sivjet, që është një cirkusllëk i llojit të vet, po ja që kjo Qeveri premtonte kështu, sidomos tash para fushatës. Ka qejf të premtojë rritje të rrogave, rritje ekonomike e tjera, ka qejf po ashtu të deklarohet kundër korrupsionit, për respektimin ligjit e tjera, por po them, ato rritjet 128% në marketing e shpjegojnë punën e juaj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Tali! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryesues,
Ministra të nderuar,
Deputetë të respektuar,

Fillimisht, mbështetje MEF-it edhe ministrit për punën e bërë, për raportin e dhënë, për arsyetimet e prezantuara dhe, në këtë kontekst, disa vërejtje parimore me synim që në gjashtëmujorin pasues të bëhen disa korrektime. Në disa pika po e zëmë, sipas konsideratës sime janë bërë shpenzime që kanë mundur të bëhen me të ulëta, por në disa pika, po e zëmë, nuk janë bërë ato shpenzime që ishte dashur të bëhen. Konkretisht, shpenzimet sipas klasifikimit funksional për mbrojtjen e mjedisit 0%. Ne sot e patëm një temë tepër atraktive edhe përmbajtjesore dhe pothuaj se secili, secila pjesëmarrës, pjesëmarrëse në debat ishte i-e shqetësuar për gjendjen tmerruese të ambientit në vendin tonë, ama për mbrojtjen e mjedisit në këtë semestër janë dhënë 0%, pra një qortim Qeverisë.

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik për subvencione vetëm 5%. Gjykoj se do të duhej të subvencionohej në radhën e parë bujqësia edhe në spektra të shumtë. Ne kemi toka pjellore, kemi bujq, kemi traditë edhe kemi kushte për ta nxitur prodhimtarinë bujqësore e blegtorale, e cila është në nivel krejtësisht të pakënaqshëm. Pra, do të isha angazhuar që të bëhet një korreksion që në semestrin tjetër të bëhen investime më të larta në këtë pozicion. Për mallra e shërbime janë mbipaguar, ta nënvizoj, në këtë 6 mujor apo semestër, krahasuar me vitin 2008, për telekomunikim 25% më tepër. Unë vlerësoj se këto janë shpenzime improduktive e këto duhet të minimizohen e jo për një kvartal të rriten, ose për mobile edhe atë nën 1000 euro vlerë, 65% janë dhënë më tepër në këtë 6- mujor se sa në gjashtëmujorin krahasimtar.

Kjo do ta kishte një farë justifikimi sikundër mos të kishim pasur fare mobile në zyrat publike, mirëpo ato që ishin, po e zëmë, me të vërtet u del sipas konsideratës sime-tepër. Qiraja 11% më tepër, edhe pse e kam pritur me inspiracion premtimin e Qeverisë që do t'i redukojë qiratë apo jo, mirëpo del se janë rritur edhe shumë ministri paguajnë qira për objektet të cilat janë ndërtuar pa leje edhe ato qira janë jashtëzakonisht të larta dhe shkojnë në xhepat e personave të cilët ilegalisht i kanë ngritur objektet, ju lutem. E tash, kur Qeveria i paguan qiratë edhe atë me kuotë më të lartë në këtë 6- mujor, se në atë të mëparshmin, nuk është fare në rregull dhe nuk është as morale.

Në pozicionet e dala nga grandet e donatorëve, ajo që e përmendi kolegu parafolës, financimi i sindikatave. Ne, më së pari kemi Projektligjin për sindikatat dhe statusi juridik i sindikatave, si të them, nuk është rregulluar me ligj edhe sindikatat kudo në botë, kryesisht financohen nga vetë kontributet e anëtarëve të sindikatave, natyrisht edhe me donacione e grande të ndryshme, ama jo nga buxheti. Kjo nuk mund të tolerohet ju lutem, këtu duhet të jepen shpjegimet serioze, natyrisht edhe konsekuenca.

Për mëditje me orar të shkurtër, kjo nuk është kategori ligjore. Ne e kemi njëfarë ligji se po them njëfarë ligji e kurrfarë ligji nuk është, sepse është ligj me defekte të mëdha – quhet, a e di si quhet, Rregullorja për ligjin për punën, e rregullorja është akt nënligjor e ligji është akt ligjor që vjen pas Kushtetutës menjëherë, a rregullorja për ligjin, por në atë nuk ekziston kjo kategori për mëditje për orar të shkurtër. Ky është konstruksion, ne e quajmë konstruksion juridik inekgzistent, pra edhe atë 153%. Këtu mund të komentohet gjer e gjatë, natyrisht këtu është pozicion nebuloz që pa fije të dyshimit ka shkëlqej ligjore se nuk më premtin koha për të vazhduar.

Për telekomunikim 70% më tepër. Për mobile nën 1000 euro - 939% më tepër, për avancat e pambuluara 750.000 euro. Kjo i bie kësi soji, merr paratë nga arka e shtetit, futi në xhepa, mos i arsyeto, domethënë ato janë praktikisht abuzime. Qysh mund të

tolerohet kjo shumë afër 1 milionë euro në xhepat e personave inkompetentë që nuk e kanë përfillur procedurën edhe domethënë ajo është abuzim.

Ekstra profiti në vitin 2009, në këtë 6 mujor është 0%, a ishte dashur të ishte shumëfish më i lartë se sa në 6 mujorin e vitit 2008, e atëherë ishte 6.618.000 euro. Të gjitha shtetet moderne nga ekstra profiti, ekstra profiti, në rastin tonë nga organizatat abiznesore të cilat kanë pozita monopolizuese në treg edhe ato para i disponojnë ato organizata biznesore në mënyrë abuzive, ndërsa ato ishte dashur të orientohen dhe të vendosen në buxhet, a në këtë 6 mujor- 0. Kjo nuk është në rregull.

Shpenzime në zbatim të akteve gjyqësore, 6 mijë, po i bie kësaj se 0 ishte në semestrin krahasimtar paraprak 6.996, do me thënë tepër. Këtu mua më shqetëson kjo, po e zëmë, këtu me siguri supozoj se është fjala për rimbursimet e dëmeve. A thua ata/ato që kanë shkaktuar dëme, i kanë shkaktuar buxhetit apo jo, a janë marrë në përgjegjësi për t'u bërë kompensimi i dëmeve? Nuk shihet. Me shpresë se sugjerimet e dhëna, jo nga unë, por edhe nga kolegët e mëparshëm, do t'i marrë ministri edhe MEF-i me konsideratë, natyrisht disa prej tyre ndoshta nuk janë edhe aq të qëlluara edhe të inkorporoheshin në semestrin pasues. Ju përshëndes!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Smaka! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, le të përgatitet deputetja Vezira Emrush.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Nuk bëhet hiq tepër të them që nuk ka vullnet për të pasur njerëz të Qeverisë kur diskutojmë për buxhetin, definitivisht se ma merr mendja se nuk kanë dëshirë të dëgjojnë se çka flasin deputetët tjerë se çka po ndodhë me buxhetin e Kosovës. Do t'i përmend disa gjëra, do t'i shtroj disa pyetje- janë retorike, por mendoj se jemi në konfuzion tani edhe ne si Kuvend se a janë me të vërtetë retorike a jo? Pyetja e parë retorike është: a e di ministri që buxheti është ligj, që është ligj që nuk janë të holla të xhepit, që atë buxhet duhet respektuar ashtu qysh e voton Kuvendi? Nëse supozoj që ministri e di, atëherë supozoj që ministri me vetëdije po e shkel Ligjin edhe Qeveria. Nëse supozoj që nuk e di, atëherë është totalisht i paaftë të qeverisë edhe duhet të shkojë në shtëpi, por nuk ka mes këtu, ose e di që buxheti është ligj edhe po e thyen me vetëdije, ose nuk e di dhe është i paaftë të qeverisë, se ligji po thyhet, po shkelet në vazhdimësi. A i di ministri që të financoj projekte që nuk janë në buxhet është shkelje e rëndë e ligjit edhe që për këtë duhet të shkojë në gjyq? Duhet ta dijë që nëse ndodh ta shkelë ligjin kësaj, duhet të shkojë në gjyq se po financon projekte të cilat nuk janë në buxhet. Prapë po pyes a e din a nuk e dinë? Tjetra është, përpos që shkelet ligji, ka tendencë edhe për të mashtruar. Çka është mashtrimi? Qe çka është mashtrimi. A e din ministri, çka janë investimet kapitale për shembull? Nëse nuk e dinë që investim kapital nuk është nafta, atëherë prapë nuk din dhe duhet të shkojë në shtëpi, por nëse ministri e din që nafta nuk është investim kapital edhe e shtinë në kolonë të investimeve kapitale, atëherë është mashtrues, është rrenc, a po kuptoni ju a jo? Është mashtrues, po na mashtron neve, po e mashtron opinionin. Prapë këtu nuk ka mes ose nuk din e duhet të shkojë në shtëpi ose e din dhe po donë për të na mashtruar me qëllim. A ka ditur të na tregoj ministri të cilat janë efektet e vendimeve të cilat janë marrë në fund të vitit të kaluar, i ka marrë Kuvendi me shumicë, normal me vota kundër opozitës për disa ndryshime në politikat fiskale, ju kujtohet shumë mirë çka keni thënë atëherë? Është premtuar që me ato ndryshime që i kemi bërë ne, do të ketë sistem fiskal më të mirë, do të ketë të hyra më të mëdha në buxhet. Ne çka po shohim tash, krejt e kundërta është. A ka pasur kohë të na shpjegoj pak se çka ka ndodhur, për çka kanë ndodhur ato

ndryshime dhe cilat janë efektet e ndryshimeve që i ka propozuar dhe i ka aprovuar Qeveria vitin a kaluar.

Çështja tjetër që duhet prapë të pyes prapë në mënyrë retorike është- A e mban në mëndë ministri, a i kujtohet ndonjë send, a i kujtohet që ka dal shafi i tij, zoti Kryeministër Hashim Thaçi këtu dhe ka thënë nuk ka më qira, para jush ka deklaruar. A po ju kujtohet që ka thënë kështu? A po e shihni që ka edhe më tepër qira të paguar? A po ju kujtohet që ka thënë dom ta rinovojmë “ Rilindjen” për të mos paguar qira edhe për t’ i dhënë 15 milionë euro, edhe që të kalojë një vit...

(Ndërhyrje e kryesuesit: Deputet, përmbaju ...)

...edhe mos të rinovohet as sot e kësaj dite edhe të na mbetin diku edhe një dy ose 3 vjet se duhet ta qesim në privatizim, domethënë, t’i japim t’i japim 5 milionë euro në vit për” Rilindje” pa e shfrytëzuar. A po ju kujtohet edhe kjo?

A po ju kujtohet edhe një punë tjetër që një kohë kur keni qenë në këtë anën, keni për të dalë shpejtë, mos u mërzitni, kur keni qenë në këtë anë, keni pasur bërë një javë ditë diku për një 22.000 euro avancë të pambyllur në Ministri të Kulturës? A po ju kujtohet çka keni bërë për 22.000 euro avancë të pambyllur? A po ju del diku te 700.000 euro për një gjysmë viti avancë i pambyllur, a po kuptoni? Apo ju kujtohet çka keni bërë për mobile, a po ju del diku që për mobile nën vlerën 1000 euro janë shpenzuar mbi 60 e sa mijë euro? A dini pse janë shpenzuar nën vlerën 1000 për t’ i kamufluar procedurat, për t’ i kamufluar procedurat të mos shkoni në forma të rregullta të ofertës dhe të kërkesës dhe ju po mendoni që njerëzit nuk e dinë, e dinë krejt e dinë mirë bile. A dini ju qysh mund të ndodhë që këta njerëz që mezi, domethënë dinë t’ i kapin kompjuterët në dorë, të shpenzojnë 1 milion e gjysmë euro në vitin e dytë të qeverisjes për telefona? Sikur të kishte qenë viti i parë, kishin thënë – i kanë lënë telefonat e vjetër qeveria paraprake, po i ndërrojmë, por është viti i dytë, ju për çdo vit nga një milion e gjysmë telefona po bleni....

KRYESUESI: Të nderuar deputet, ju lutem pak qetësi dhe zoti deputet përmbaju raportit.

ARDIAN GJINI: A mund të besoni që këto masakra të buxhetit të Kosovës i bën Qeveria, në të cilën janë disa njerëz si Safete Hadergjonaq që gjithë ditën bëhet argat edhe mbron. A të kanë ble edhe ty kerr Safete? Lyp le ta blejnë edhe ty, se për veti të gjithë kanë blerë. Ju kanë blerë edhe fëmijëve, po lyp edhe ti se u mbyte duke i mbrojtur.

KRYESUESI: Zoti deputet, lidhur me raportin, të lutem

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën për replikë 2 minuta, deputetja Hadergjonaq.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Është vërtet mjerim për ata që nuk e njohin buxhetin, nuk i njohin procedurat e buxhetit, nuk e njohin mënyrën e shfrytëzimit të buxhetit, nuk e njohin Ligjin për menaxhim të financave publike dhe flasin për buxhetin. Ju lutem, nuk janë 5 milionë euro të shpenzuara për qira. E kemi raportin këtu, ja ku është raporti, qiraja është 2.338.248

euro, nuk janë 5 milionë. Plus nuk janë 700.000 euro avancë, prandaj, mos dezinformoni opinionin se është turp për këtë Kuvend të dalësh e të flasësh përmendsh edhe pa i ditur shifrat e buxhetit. Ju lutem, nëse i marrim dhe i shikojmë shpenzimet e telekomunikimit në vitin 2007, janë më të mëdha se sa shpenzimet që janë bërë me shtimin e institucioneve të reja, me shtimin e komunave të reja që janë bërë në vitin 2009. Domethënë, janë diku për 50.000 euro më shumë që janë bërë në vitin 2007, prandaj nuk e di. Merre shikoni raportin e vitit 2007, asnjë të dhënë për shpenzimet kapitale nuk e ka në raportin e gjashtëmujorit të vitit 2007. Ja ku e kam këtu. Merre shikoni shpenzimet të cilat janë bërë në Ministrinë e Ardian Gjinit kur e ka udhëhequr, janë shumë më të mëdha se sa shpenzimet që po bëhen tani. Prandaj, dezinformimi i opinionit nuk është i mirë, sepse i shkakton dëm pikërisht atij që e bën dezinformimin, sepse faktet flasin vetë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ardian, nuk t'u ka përmendur emri drejt. Okej, një minutë e ke kundërplikë.

ARDIAN GJINI: Po të më dëgjojë Safetja mua, e lypë një veturë për t'ia blerë, fillimisht. Edhe e dyta, 15 milionë euro për "Rilindje" për tri vjet shfrytëzim bëjnë nga 5 milionë në vit se e kemi qitur në shitje "Rilindjen", se është ndërmarrje shoqërore. Kjo është çka thashë me 5 milionë euro, por qiraja është rritur për 11%, po e thashë, nxirre transkriptin, të lutem, dhe dëgjo, nëse di pak financa, duhesh të dish edhe të dëgjosh për të folur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Vazhdojmë me diskutuesen Vezira Emrush, le të përgatitet diskutuesi i fundit Ibrahim Makolli.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa za ponovo datua reč! Ponovo pozdravljam sve kolege poslanike i Predsedništvo. Ja sam se javila za reč tako što neću mnogo da zadržavam kolege, ali molim za malo pažnje.

Molim kolege za malo pažnje!

KRYESUESI: Të nderuar kolegë, ju lutem pak mirëkuptim për diskutuesen!

VEZIRA EMRUŠ: Prvo, meni je drago daje ovde gospodin minsitar, pošto je malo pre bio odsutan, ali drago mi je da u njegovom prisustvu kažem da je sve indekse iz izveštaja pročitao na sebi, ovo poznat način u svoju korist. Ako malo bolje pogledamo tabele, kada su u pitanju ukupni prihodi, što znamo šta je budžet, prihodi i rashodi. Ako pogledamo tabelu ukupnog prihoda, videćemo ako počnemo od poreza i carina odubiranja na samoj carini, videćemo da nemamo nikakvo povećanje i mi kao poslanici u Skupštini i građani Kosova moramo da se zabrinemo da je tendencija carine i prihoda u opadanju. U opadanju za 9,3% u odnosu na planirane prihode, što treba sve nas da zabrine zato što sve manje je pritoka robe na carini i normalno je i ta stavka naplaćena manje što znači da smo imali planirano 665 miliona, naplatili smo 270 miliona, što znači 40,7% ostvareno ali sa smanjenjem od 9,3%. Svi ovi podaci čitaju se sa smanjenjem -50 procenta koji je ostvaren.

Druga stavka koja jako treba da nas zabrine jeste i smanjenje u porezima. Porezna stavka gde je ponovno smanjenje od 1,6%, što znači da je krajnje vreme da se Ministarstvo i Vlada pobrinu za fiskalnu ekonomiju, da se iznadje mogućnost da se

postave fiskalne kase. Da se poveća bruto prihod i da se prepoznaju, identifikuju svi operatoari na terenu, što je ovo veliki minus za Kosovo, zato što se ne preduzima nikakva fiskalna politika. Znači, ukupno kada gledamo smanjenje prihoda, za 7,4% smanjeni su prihodi. Mi nismo, ne trpimo posledice globalne krize iz jednog jako normalnog razloga zato što nismo zaduženi u nijednoj banci, nismo imali dugovanja, imali smo donacije, imali smo svoje prihode tako da nismo nigde oštećeni sa kamatama, niti smo imali neke kamate ili kredite.

Drugo, što je jako bitno kada su u pitanju rashodi, moramo da kažemo da su rashodi, na primer, kada su u pitanju rashodi centralnog nivoa, opština i svih, da su povećani za 4,2% i što i tabela sama pokazuje da smo faktički potrošili više 22 miliona, a to je 6,1%. Znači, ovaj bilans treba da se prikaže sa deficitom od 6,1% a ne sa pohvalom, kao što je pohvalio gospodin minstar da smo u svim sverama postigli neki rezultat.

Ovde se jako tačno vidi, ja nisam htela da zamaram puno kolege, samo sam dala jedan pregled rashoda i prihoda. Dalje što bi mogla da se zadržim kada su u pitanju plate i povećanje plata, nije tačno, to je ista masa samo učinjena nivelizacija i sistematizacija radnih mesta. Možemo slobodno da kažemo da 10 punih godina na Kosovu, plate nisu porasle za 1 euro. Kako se to radi. Jednostavno se posmatra index. Ako je jedna zemlja u regiji krenula sa 250 euro bruto ličnog dohotka, a mi imamo 120 eura, za 10 godina je naš bruto lični dohodak i dalje isti, dok su zemlje u regiji otišle na 400, 500, 600, Hrvatska 700 eura.

Još jedno jako važno pitanje, kada su u pitanju subvencije koje smo davali kao što je KEK- distributivna mreža koja je dobila 30 i nešto miliona, ova radna organizacija treba da puni kosovski budžet, a ne da prima subvencije i ostalo, gde treba da se krajnje stavi do znanja Ministarstvu za energetiku i Ministarstvu za trgovinu da se malo više obrati pažnja na javnu nabavku po ovim javnim preduzećima.

Još jedna jako bitna stavka, što me je jako zabrinulo, što neću da zamaram kolege, jeste jedna kontradiktorna izjava. Juče je bilo parlamentarno pitanje oko kirija koja se plaćaju u Mitrovici, pa je minsitar za Lokalnu smoupravu rekao da se tamo porodicima daje po 100 euro, dok je potpredsednik Vlade Kuçi rekao da porodice primaju 300 eura. Mi imamo stavku Koda ovde, Mitrovica 642, gde se kaže da je Vlada dala 360 hiljada eura. Konačno bi trebalo da se da, ne samo opisno 360, koliko je prepoznatih tamo porodica i koliko primaju, da li je to 100 ili 300 eura. Ja sam samo dala do znanja neke stvari. Mi kao poslanici pratimo, a ova Skupština i ova Vlada treba da bude jako srećna što mi ovako sve ovo pratimo i brinemo za našu bolju budućnost. Hvala lepa!

Drejtimin e seancës e merr Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju falemidnerit! Radha është për deputetin Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë do të përqendrohem vetëm në 4 çështje të këtij raporti këtu. E para, shpenzimet telefonike që variojnë diku bashkërisht me telefoninë mobile, me Valën 900, sipas kësaj që po shkruan këtu dhe me shpenzimet e tjera të telefonit, bie diku mesatarisht nga 5000 e deri në 110 mijë një ministri të harxhuara vetëm në telefon dhe, po të përkthehet në impuls, po i bie kurrigjë tjetër gjatë tetë orëve të punës përpos në telefon. Nuk e di, derisa çmimet po bien të impulseve të telefonisë, në Qeverinë tonë po rriten, këtu nuk

di çka është problemi, si duket nuk kanë hyrë edhe më tutje në rrethin, nuk e kanë krijuar rrethin e vet.

E dyta, shpenzimet për derivate. Kisha për të pyetur, çfarë automjete po vozitni? Nuk e di, po ma merr mendja se as tanket më të mëdha nuk harxhojnë kaq shumë derivate sa po harxhohen për veturat e juaja dhe po ashtu po qe se i përkthejmë në kilometra, po i bie që ministrat dhe këshilltarët e ministrave gjatë 8 orëve veç në automjet rrinë, tash nëse e marrim edhe telefonin, si duket veç në telefon dhe në vetura po rrinë gjatë 8 orëve të punës.

E katërta, drekat zyrtare dhe nëse i shihni këtu, mirë që ju keni dhënë arsimit disa mësuesve dhe do të shëndetësisë jeni munduar t' i mashtroni me nga një drekë, mos i mashtroni që ua rritni pagat se nuk mundeni, a! Bile këto mos i mashtroni. Edhe në drekat zyrtare veç po i shihni se sa ka shpenzime që janë tejkaluar. Ministër, po më intereson shumë kjo çështjet te pagat edhe në kllapa ku shkruan janë në listën e pagave, a nënkupton kjo që janë ata partizanët e partive që i keni punësuar e nuk keni guxuar t' i shtini në listë të pagave, domethënë, sepse Ligji nuk e lejon të jepen paga pa qenë në listën e pagave.

E keni edhe te dy agjenci, ku shpenzimet e tyre janë po ashtu të mëdha, ndërkaq ato janë tërësisht jofunksionale. Shikoni te ART-ja shpenzimet dhe në anën tjetër ne të gjithë e dimë që tash e disa kohë ART nuk është funksionale. Thjeshtë, me këtë keni treguar se kjo Qeveri nuk ka aftësi të bëjë menaxhim të saktë të buxhetit dhe çka është më e keqja, këtu tash po përpiqet që një pjesë e pozitës të bëhet edhe avokat i Qeverisë, avokat i këtyre keqpërdorimeve që ka ndodhur me shpenzimet e buxhetit për gjashtëmujorin. Disa prej kolegëve të mi e thanë që këto janë brenda kornizave, por na po flasim vetëm për shpenzimet e gjashtëmujorit, llogaritni kaq ose dy herë kaq do të jenë deri ne fund. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Gani Koci e ka kërkuar fjalën. Për çka e ke kërkuar fjalën?

(Reagime nga salla)

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Do të përpiqem të jem i shkurtër.

Buxheti ose procesi buxhetor edhe i të hyrave dhe i dalave është një proces që ka një fillim dhe ka një mbarim dhe ky fillim e mbarim e ka 1 janarin e vitit kalendarik edhe 31 dhjetorin. Dhe, ju lutem meqë është procese edhe në rastin kur tani ne po flasim, nuk i kemi shifrat e sakta, sepse atje lëvizë, është duke lëvizë ende dhe ky lëvizë deri me 31 dhjetor kur bëhet mbyllja dhe në mbyllje pastaj mund të themi vërtet se sa dhe si është realizuar dhe a ka qenë në përputhje me dinamikën dhe me atë që është planifikuar? Kur e kemi miratuar këtë buxhet i kemi pasur vijat e trasha të buxhetit, linjat buxhetore dhe jo edhe shumë dinamike, dinamika ka qenë më tepër një projektim që nuk do të thotë që na del gjithmonë edhe i saktë atë çka e projektojmë. Por, atë që e thash, nëse e lexon dhe e krahason me një vit paraprak, në të gjitha drejtimet ke rritje pozitive. Nëse e krahason me atë që, çka ti ki planifikuar në këtë 6 muaj ose në një 6 muaj tjetër ose tre muaj, është (për shpenzime po flas, Shkumbin Demaliaj, për shpenzimet po flas, por mua nuk po më harxhohen rrotat se nuk lëviz poshtë e lart kështu dhe i ruaj ato). Nëse flasim për atë që është projektuar, ka shumë vend, sepse nuk është realizuar ajo që ndoshta është menduar të realizohet dhe këtu, ndoshta Qeveria duhet ta ketë parasysh

këtë fakt që në fund të vitit vërtet të dalim ashtu siç është projektuar. Një çështje duhet t'ju them, vërtet është rrenë tepër rrenë e kulluar rrenë se po të krahasohen shpenzimet e telefonit në këtë vit, janë shumë më të vogla se sa në vitet paraprake, ju lutem, të lutem, janë shumë më të vogla, kur kemi parasysh se kemi mekanizma të rinj të krijuar qeveritarë, ministri të reja, kemi komuna të reja dhe këto shpenzime nuk janë shpenzime të një ministri dhe Kabinetit qeveritar, por ai e mbulon gjithë sferën e vet, linjën e vet të Ministrisë deri te niveli lokal atje. Prandaj, ky është buxhet i Republikës së Kosovës dhe jo buxhet thjesht i 12 a sa i kemi ministri atje. Është buxhet i Republikës së Kosovës, prandaj lexoni drejt dhe lexoni mirë. Dhe, krejt në fund është mirë të mësohemi të lexojmë dhe krejt në fund konsideroj që duhet të miratohet raporti i shpenzimeve buxhetore për këtë 6 mujor me rekomandimet që i ka dhënë Komisioni në të dy rastet e caktuara këtu.

Diskutim i dorëzuar me shkrim

MYRVETE PANTINA: Nga raporti gjashtemujor i Buxhetit 2009 shihet se në krahasim me vitin 2008 edhe të hyrat edhe të dalat kanë shënuar progres në realizimin e tyre, por, derisa realizimi i të hyrave në krahasim me buxhetin e planifikuar mund të themi se deri në një masë është i kënaqshëm (44%), me shpenzimet e realizuara në këtë periudhë, krahasuar me buxhetin e planifikuar nuk mund të jemi të kënaqur, sepse realizimi është vetëm 34%, pra mbetet që deri në fund të vitit të shpenzohen rreth 66% të mjeteve buxhetore. Grumbullimi i të hyrave ka shënuar trende pozitive sidomos në Administratën Tatimore të Kosovës, ku janë realizuar mbi 48% të të hyrave të planifikuara. Të dalat kanë shënuar realizim më të mirë në nivel të komunave (37,3%) se sa në nivelin qendror (32,7%). Pothuaj se të gjitha komunat kanë shënuar rritje të të hyrave vetanake, përveç në disa komuna, si, në Skenderaj ku ka pasur rënie në grumbullimin e të hyrave për 16%, në Deqan për 10%, në Rahovec për 8% dhe në Pejë për 5%.

Sa i përket të dalave, realizim më i dobët është shënuar në kategorinë e shpenzimeve kapitale si në nivelin qendror (17,2%) ashtu edhe në nivelin lokal (22%), derisa te rrogat dhe mëditjet realizimi është më i kënaqshëm (rreth 48%), ndërsa realizimi më i mirë është në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve (mbi 50%). Duke u nisur nga niveli i realizimit të shpenzimeve është një pikë pyetje e madhe se sa do të realizohen realizohen shpenzimet e planifikuara deri në fund të vitit dhe me çfarë kualiteti. Nëse realizimi i shpenzimeve në nivelin qendror është 33%, atëherë prej ministrive sa i përket realizimit të shpenzimeve, në pozitë më të mirë janë: Ministria e punës dhe mirëqenies sociale (50%), Ministria e shëndetësisë (36%), Ministria e Drejtësisë (36%), Ministria e ekonomisë dhe financave (32%) dhe Ministria për energjetikë (31%). Ndërsa realizimi më i dobët i shpenzimeve është në Ministrinë e punëve të jashtme (6,9%), Ministrinë e administratës së qerisjes lokale (10%), Ministrinë e tregtisë dhe industrisë (11,4%). Do të duhej të jepen sqarime se çka ka ndodhur në këto ministri, pse është realizimi aq i dobët i mjeteve që kanë pasur në disponim.

KRYETARI: Zoti ministër, a e doni fjalën përmbyllëse? Hajde, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Sigurisht që çdo raport mund të shkaktojë emocione të përziera, qofshin ato profesionale, qofshin partiake. Kjo foltore mund të përdoret edhe për marketing politik personal dhe ky është vendi mbase ku duhet të bëhen ato, por në qoftë se i kalon masat, le të jetë në vlerësim të secilit qytetar të Kosovës ta vlerësojë këtë. Konsideroj

një, që stafi im i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është përkushtuar maksimalisht, profesionalisht që të reflektojë në mënyrën më të besueshme të mundshme çdo ndryshim që është bërë në buxhetin e Republikës së Kosovës, konform përgjegjësi që kam si ministër i Ekonomisë dhe financave dhe konform përgjegjësi që i ka secili shërbyes civil.

E falënderoj Komisionin për Buxhet dhe Financa për vlerësim pozitiv të këtij raporti dhe për rekomandimet që i ka paraqitur, natyrisht ne do t'i marrim parasysh. E vlerësoj po ashtu dhe i falënderoj të gjithë deputetët që me qëllim të mirë për të përmirësuar raportimin mbase edhe menaxhimin e parasë publike, shumica prej tyre dhanë sugjerime valide, të cilat stafi im dhe unë dhe besoj të gjithë shpenzuesit, udhëheqësit e agjencive buxhetore do t'i kemi parasysh. Dhe, në bazë të diskutimeve që u dhanë, më lejoni që t'i jap disa nga përgjigjet, nga disa deformime mund të them nga deputetë të caktuar që mos të zgjoj debat, unë nuk do të përmend emra dhe do t'ju kisha lutur që mos ta shfrytëzojmë këtë element për të kërkuar debat ose replikë. Emrat nuk po i përmendi. Okej.

U tha në përgjithësi dhe më vjen keq që u tha mbase nga profesionistë ose njerëz që kanë qenë edhe në poste udhëheqëse të kësaj natyre, se është bërë shkelje në financimin e projekteve të cilat janë në kundërshtim me Ligjin e buxhetit. Nuk do të doja tani të marr rolin e auditorit dhe nuk do të ishte mirë ta marrë askush nga folësit paraprak rolin e auditorit. Një mund t'ju siguroj që asnjë financim, asnjë projekt nuk është financiar jashtë normave juridike dhe jashtë Ligjit të buxhetit dhe jashtë Ligjit të financave publike. Ata që mendojnë dhe që folën këtu, i lus t'i lexojnë nenet 12 dhe 13 të Ligjit për buxhetin dhe nenin 30 të Ligjit për financat publike. I thërras edhe një herë ata që folën, pra, le t'i lexojnë këto dy nene dhe neni 30 të Ligjit për financat publike dhe në qoftë se kanë vështirësi për t'i kuptuar, unë me stafin tim do të jem në gjendje t'ua lexoj edhe një herë.

Një çështje që u theksua se janë paguar dënime, janë paguar vendime gjyqësore, e vërtetë është, por ato vendime gjyqësore, më vjen keq t'ju referoj juve këto, janë paguar për shkak të gabimeve që paraardhësit e kësaj Qeverie e kanë bërë. Shumica prej tyre, me shumë keqardhje paguhen dhe kjo Qeveri pague borxhin nga gabimet ligjore që i kanë bërë disa nga udhëheqësit e Qeverisë paraprake, kështu që lë të njoftohen qytetarët e Kosovës për këtë çështje.

Një përmirësim nga shqetësimet që u paraqitën me të drejtë nga disa deputetë, se në fund të vitit do të ketë financime më të shumta ose shkarkime buxhetore në nivel më të lartë, mendoj që ju, të nderuar deputetë, me mbështetjen e juaj e kemi përmirësuar Ligjin e buxhetit të këtij viti gjatë rishikimit të buxhetit. Dhe, nga 1 nëntori i këtij viti nuk do të ketë mundësi të jepen avance më shumë se sa 10% nga projekti dhe nga 1 dhjetori jo më shumë se sa 5%. Kjo është një përmirësim i dukshëm në frikën e juaj dhe tonën që në vitin e kaluar ka pasur probleme në derdhje të mëdha buxhetore në muajt e fundit. Dhe, unë i thërras të gjithë udhëheqësit e agjencive buxhetore, pra udhëheqësit e komunave, të ministrive, le ta kenë këtë parasysh se me ligj që ju e keni adaptuar, të nderuar deputetë, nuk do të mundet askush të japë avance më shumë se 10%, përkatësisht 5% nga 1 dhjetori të këtij viti.

Një shqetësim tjetër që ishte edhe për neve dhe në raport me të drejtë u kritikua, është niveli jo i lartë i inkasimeve karshi planit, mbase u vërejt dhe është reflektuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia , t'i vazhdohet fjala ministrit!

MINISTRI AHMET SHALA:... u tha që në qershor, në përfundim të qershorit diku në mesatare plani nuk është arritur diku prej 3 deri në 7% as në Administratën Tatimore, as në Dogana, është e vërtetë, por në asnjë periudhë tani e 10 vjet në 6 muajt e parë ndonjëherë nuk është realizuar plani. Dhe, kjo është me qëllim një planifikim për të bërë presion në këto institucione inkasuese që mos të rrinë të qetë, por dua t'ju informojmë mbase nuk është pjesë e raportit, por do të jetë pjesë e raportit 9 mujor që do ta keni së shpejti, se Dogana e Kosovës sot ka përmbyllur 98% të planit, karshi planit, ka arritur pra planin, përkatësisht 72% datë, më datë, me ditën e sotme, ndërsa Administrata Tatimore më 30 shtator ka përmbyllur 100% planin. Më lejoni që në emrin timin dhe tuajin t'ju uroj për riangazhimin ose sforcimin e angazhimit të këtyre institucioneve për ta realizuar këtë plan dhe unë jam i sigurt që deri në fund të vitit do të jemi konform planit ose në tejkalim të planit, pa marrë parasysh që ka qenë kriza globale, pa marrë parasysh që taksat janë zvogëluar për 50%. Dhe, kjo vërtet duhet të jetë një falënderim institucioneve që janë angazhuar dhe nën dy, qytetarëve të Kosovës që kanë filluar të kuptojnë se pagimi i taksave është respekt për shtetin dhe jo vetëm obligim ligjor.

Unë kam marrë shënim për secilin prej jush dhe do t'i adresoj të gjitha me përpjekjen më të madhe dhe më të sinqertë dhe më profesionale të mundshme që në raportet e ardhshme, po me të njëjtin përkushtim t'i qasemi reflektimit të saktë të shpenzimeve. Nuk dua të jem auditor dhe nuk do të doja që askush nga ju të luaj rolin e auditorit, por për informimin e tuaj, më lejoni, e kam raportin aty, i cili sigurisht që do të debatohet shpejt edhe këtu i auditorit.

Në vitin 2007 kemi pasur vetëm 3 institucione që kanë pasur raport të pakualifikuar dhe kemi pasur 20 që kanë pasur raporte të kualifikuara të auditimit, përkatësisht shkallën më të lartë të shkeljes së problemeve dhe 4 të cilat nuk kanë mund të konkludohet auditimi. Në vitin 2008 kemi pasur këtë ndryshim karshi vitit 2007. Kemi pasur tri institucione me raport të pakualifikuar dhe 16 institucione me raport të pakualifikuar me theks, përkatësisht 19 institucione të Kosovës me raport të kualifikuar ose me shkallën më të lartë të vlerësimit pozitiv të rregullsisë financiare dhe vetëm disa, 4 ose 5 institucione tjera me raport të pakualifikuar.

KRYETARI: Ajo është temë e ardhshme ministër.

MINISTRI AHMET SHALA: ... Jo, desha të them se u diskutua dhe për hir të qytetarëve të dihet se ne si Ministri e Ekonomisë dhe e Financave nuk jemi ata që përcaktojmë shkallën e përputhshmërisë me nivelin e auditimit, por me besnikëri do të bëjmë çdo refleksion të të dhënave që secila agjenci bën dhe i falënderoj të gjithë ata që, me qëllim të mirë patën ndonjë kritikë, ndërsa të tjerët le të mbetet në besimin dhe ndërgjegjen e secilit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Regjia, le ta shfrytëzojë zilen pak.

Të nderuar deputetë, prezentë janë 69 deputetë, që do të thotë mund të hyjmë në procedurën e votimit.

Hedh në votim Raportin me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për shpenzimet e 6 mujorit të parë 2009.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tash.

Më 44 vota “për”, 19 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi raportin për gjashtëmujorin e parë për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe dy rekomandimet e para nga të dy raportet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, po e ceku edhe një herë, kështu që kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës dhe të fundit.

(Reagime nga salla)

Më mirë e kryejmë sonte, se nesër kemi agjenda tjera. A e vazhdojmë? Mendoj që agjendën është më mirë ta kryejmë me këtë raport.

Pika e radhës është:

- Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në pajtim me Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm i ka paraqitur Kuvendit Raportin vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit të Zyrës së auditorit dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Raporti vjetor i auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe rekomandimet e Komisionit u janë shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci, apo raportuesin e komisionit, ta japë fjalën e vet.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Në bazë të nenit 3.1, 3.15, 6.2 të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të Rregullës 51.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e vet të mbajtur më 16.9.2009, shqyrtoi raportin vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe Kuvendit i parqet këtë:

R E K O M A N D I M

I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare të miratojë Raportin vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, me përjashtim të pjesës ose të raportit të auditimit për raportin financiar të Radiotelevizioni të Kosovës për vitin 2008.

Arsyetimi është ky lidhur me këtë rekomandim.

Pas shqyrtimit vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, Komisioni ka konstatuar se raporti i plotëson standardet ligjore të kontabilitetit për raportim, me përjashtim të raportit të auditimit për raportin financiar të Radiotelevizionit të Kosovës.

Komisioni në mbledhjen e vet të mbajtur më 8 maj 2009, ka shqyrtuar raportin financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2008, dhe të njëjtin nuk e ka miratuar me arsyetimin se është në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike

dhe nuk i plotëson standardet e kontabilitetit dhe rregullat tjera të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës. Këtë rekomandim të atëhershëm të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Kuvendi e ka shndërruar në vendim dhe ka kërkuar prej Radiotelevizionit të Kosovës që raportin ta plotësojë dhe, meqë deri metani ende ai plotësim nuk është kryer nga Radiotelevizioni i Kosovës, kjo ka qenë arsyeja që për këtë pjesë financiare, që bën, fjalë në raportin e përgjithshëm të Auditorit të përgjithshëm të mos diskutohet dhe të mbetet që të diskutohet atëherë kur do ta diskutojmë edhe raportin e përgjithshëm të shpenzimeve financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, kur të bëhet plotësimi i atij raporti.

Me këtë edhe gjatë shqyrtimit në Komision me Auditorin e Përgjithshëm, jemi marrë vesh dhe kemi konstatuar, sepse i njëjti që ne e kemi refuzuar ka qenë si bazë për një vlerësim ta quaj kushtimisht pozitiv, gjë që sipas standardeve dhe sipas Ligjit të menaxhimit të financave publike nuk i ka plotësuar kushtet dhe ka qenë vetëm një kopje e raportimeve të mëhershme. Prandaj, konsiderojmë se Kuvendi do të duhej të miratonte këtë raport pa pjesën që ka të bëjë me raportin e auditimit për Radiotelevizionin e Kosovës.

KRYETARI: Ne do ta kemi parasysh. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit zoti Kryetar,

Zyra e Auditorit Gjeneral e gëzon pavarësinë kushtetuese. Ne si Kuvend, do të donim që vërtet ky institucion të jetë i pavarur dhe është obligim ynë që të angazhohemi që ky institucion në vazhdimësi ta ruajë pavarësinë e tij.

Përpjekjet e Komisionit për Buxhet dhe Financa si dhe të Kuvendit në përgjithësi për ta përkrahur këtë Zyrë, deri diku po japin rezultate pozitive. Ne, gjatë këtij viti kemi shqyrtuar raportin vjetor të performancës ku janë përfshirë performanca dhe përgjegjësia e auditorit dhe me kohë Kuvendit, nga Zyra e Auditorit Gjeneral i është dorëzuar raporti i dytë, pra raporti vjetor i auditimit ku përfshihen gjetjet dhe rekomandimet e auditimit për vitin vijues financiar.

Grupi ynë parlamentar e vlerëson pozitivisht dorëzimin me kohë në Kuvend të këtij raporti. Auditori Gjeneral për vite të tëra ka raportuar për shkelje të shumta, skandale financiare, skandale në punësim në ndërmarrjet publike dhe në institucione, por Kuvendi asnjëherë nuk i ka shqyrtuar raportet e tilla. Këto raporte kanë mund të lexohen përmes ueb faqes, ato që kanë qenë të publikuara në ueb faqe apo janë dorëzuar me 3 apo me shumë vite vonesë dhe si të tilla fare nuk janë shqyrtuar në Kuvend. Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e vlerëson shqyrtimin e raportit vjetor të auditimit në lidhje me implementimin e buxhetit dhe pasqyrat financiare për buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

Në raportin që e kemi sot në shqyrtim, auditori ka konstatuar se pasqyrat vjetore të buxhetit të Kosovës janë në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe me udhëzimet administrative. Pasqyrat financiare sipas auditorit, janë në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe paraqesin pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të buxhetit të Kosovës.

Auditori i përgjithshëm, siç vërehet nga raporti, ka audituar 23 organizata të cilat në tërësi përbëjnë 95% të hyrave dhe 80% të shpenzimeve. Rekomandimet e dhëna nga

auditori janë kryesisht administrative, procedurale dhe teknike. Sipas auditorit të përgjithshëm, auditimi i brendshëm nuk është sa duhet funksional në organizatat buxhetore dhe se pritjet e menaxhmentit janë ende të nivelit të pamjaftueshëm.

Të nderuar deputetë,

Një gjë të tillë e ka konstatuar edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa gjatë monitorimit të Ligjit për auditorit e brendshëm. Ndryshimi i Ligjit për auditimin e brendshëm, i cili është miratuar gjatë këtij viti, ka hequr shumë zbrazëtira dhe vështirësi në implementimin e Ligjit të mëparshëm që ka reflektuar në parregullsinë në funksionimin e kësaj njësie.

Auditori i jashtëm, po ashtu ka konstatuar se organizatat buxhetore mbajnë në disa raste evidenca jo të plota kontabël dhe pasqyrat vjetore financiare përgatiten duke përdorur evidencat e thesarit. Duhet bërë më shumë në këtë drejtim që të ketë sistem të evidencave kontabël, në mënyrë që të kemi prezantim unik të pasqyrave financiare.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah raportin e auditorit të jashtëm, duke sugjeruar që rekomandimet e dhëna nga auditori të adresohen në mënyrë të kënaqshme dhe të ndërmerren masa për mos implementimin e rekomandimeve që auditorëve t'ju sigurohet pavarësia, t'ju krijohen kushtet që të kenë qasje në dokumente, të krijohen kushte të mjaftueshme për punë, sepse vetëm kështu mund të konkretizohet suksesi i reformës në financat publike. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETATI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Është për t'u përshëndetur, sepse për herë të parë Auditori i Përgjithshëm raporton sipas ligjit dhe kjo e arsyeton edhe angazhimin tonë si Komision për Buxhet dhe Financa në përkrahjen e këtij agjencioni të pavarur dhe të rëndësishëm në menaxhimin edhe auditimin e parasë publike në institucionet dhe organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës.

Raporti vjetor i auditimit për vitin 2008 i plotëson standardet ligjore për raportim. Është përmbajtësor dhe paraqet përmbledhje gjithëpërfshirëse dhe analitike për gjetjet dhe rekomandimet për vitin financiar 2008.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrah dhe njëkohësisht i përkrah edhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Armend! Tani është radha e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor i auditimit, që po e diskutojmë sot, përmban implementimin e buxhetit nga ana e Qeverisë në vitin 2008, dhe pasqyrat financiare për vitin 2008, janë vetëm njëra pjesë e raportit të Zyrës së Auditorit Gjeneral për Kuvendin. Pjesa e parë, raporti

vjetor i performancës i dorëzuar në Kuvend në prill të këtij viti asnjëherë nuk doli këtu në diskutim, nuk e di pse?

Raporti vjetor i auditimit që sot po e diskutojmë, i është paraqitur zyrtarisht edhe Kryeministrit nga ana e Zyrës së Auditorit Gjeneral dhe me këtë rast Kryeministri me dashamirësi dhe kënaqësi e ka pranuar si raport të vërtetë dhe si raport të pranueshëm. Pra, e ka pranuar me të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e tij. Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e konsideron se raporti është dokument i përgatitur me kohë, në nivel profesional dhe pasqyron realisht procedurat buxhetore 2008. Edhe pse i ngjeshur, vetëm në rreth 40 faqe dhe i pa shoqëruar me raportet individuale të auditimit, nuk na mundëson të njihemi me të gjitha të gjeturat në organizatat qendrore buxhetore, konkluzionet dhe rekomandimet e përmbledhura, na bëjnë të ndihemi tepër të shqetësuar për gjendjen në implementimin e buxhetit 2008.

Vlerësimi pozitiv për pasqyrat financiare, vetëm për 3 organizata buxhetore që në pikën paraprake ministri u përpoq t'i shpjegojë dhe vërejtjet esenciale për 16 organizata buxhetore dhe për 4 të tjera, opinion negativ nuk mund të përgjithësohen në konkluzion, siç pretendoi edhe ministri që ta plasojë në opinion si vlerësim i përmirësimit të situatës në implementimin e buxhetit 2008. Kjo është vetëm vlerësim i saktësisë prezantimit të tabelave të pasqyrave financiare, por ju lutem, çka paraqesin këto pasqyra financiare, qoftë tek ato me vërejtje apo pa vërejtje? Këto pasqyra paraqesin vërtet realitetin e implementimit të buxhetit i cili, sipas auditorit gjeneral këtu reale siç janë, tregojnë se në procesin e implementimit të buxhetit 2008, nga ana e Qeverisë, organizatave buxhetore qendrore janë bërë shkelje dhe parregullsi të panumërta të cilat për pasojë kanë keqpërdorimin dhe keqmenaxhimin e parasë publike.

Një aspekt tjetër i çështjes, pra raporti i auditimit të performancës, i cili paraqet auditim të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të shfrytëzimit të parasë publike është edhe më i errët, por, shqyrtimit të tij i është bishtnuar me mjeshtëri. Megjithatë, pak a shumë është e ditur se sa njësi të parasë publike arrijnë deri te destinacioni dhe sa shpërdorohen dhe shmangen deri në realizimin e objektivave të caktuara.

Ky raport që sot po e diskutojmë, adreson edhe një segment të veçantë të mbikëqyrjes që duke filluar nga problemet e auditimit të brendshëm, u përmend edhe nga parafolësit, transparenca, prokurimet përfundon në konkluzionet që duhet shtuar shkalla e mbikëqyrjes nga ana e Kuvendit si shkalla më e lartë e mbikëqyrjes përmes dëgjimeve dhe seancave publike nga ana e një organi të veçantë të Kuvendit me organizatat buxhetore, organ i cili po vonohet të konstituohet.

Të ndalemi vetëm në disa nga gjetjet dhe konstatimet dhe konstatimet e auditorit gjeneral, sepse koha që e kam në dispozicion, nuk më lejon t'i numëroj të gjitha. Në pikën 4 të raportit, në faqen 12, pos tjerash thuhet, po citoj: "Organizatat buxhetore krijojnë të hyra vetjake dhe nuk i depozitojnë ato në llogarinë e thesarit, ato gjithashtu mund të shpenzojnë jashtë llogarive të thesarit". Kjo mjafton që të konstatojmë për shkeljen e rëndë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Shkelje të rënda konstatohen në pjesën: Analiza e të hyrave të parasë së gatshme, por sidomos te analiza e pagesave në faqen 14. Dallimi në evidenca, pra parregullsitë arrijnë në shuma 16.485.000 euro, nga të cilat në paga 617.000, tatimi në të ardhura personale 2.490.000, në kontribute 1.500.000, e tjera. Te kjo kategori e shpenzimeve, Auditori gjeneral

konstaton se në listën e pagave gjenden persona që u ka skaduar kontrata, që nuk kanë kontratë e që paguhen mbi vlerën e kontratës që disponojnë.

Në pikat 4, 3- 4 vërehen dallime në evidencë që kapin shumën 5 milionë e 80 mijë euro. Në konkluzionet e auditorit gjeneral, po ashtu del se shuma e diskutuar tashmë shumë herë e 266 milionë eurove të buxheti të dhënë si para, si letra me vlerë në vitin 2008, edhe pse i ka skaduar afati i maturimit më 31 dhjetor deri në korrik të këtij viti as nuk është regjistruar kthimi i atyre parave as nuk është evituar kamatë e realizuar nga dhënia e tyre në shfrytëzim që kap një shumë prej rreth 1.400.000 euro. Ne e kemi ngritur këtë problem në Komisionin për Buxhet dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Financave na ka thënë, e di guvernatori, na nuk e dimë ku janë këto para.

Te pagesa e të hyrave vetanake kemi mospërputhje për 12.650.000 euro, ky shënim është në faqen 17 të raportit. Shuma totale e parasë publike me probleme procedurale e materiale, siç e kemi thënë edhe në disa raste kap vlerën prej 35 milion 100 mijë euro. Konkluzioni i auditorit gjeneral, po citoj: “Ka probleme substanciale që duhet të adresohen nga Qeveria, në mënyrë të vendosur dhe urgjente me përgjegjësi të veçantë ndaj Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave”. Pasusi i fundit në faqen 17.

Për mungesë kohe më duhet të kaloj në kapitullin 5.8.1 Prokurimi në faqen 32, po citoj: “Auditori gjeneral ka identifikuar prokurimin si një nga fushat e organizatave buxhetore me rrezik domethënës për: mos efikasitet, korrupsion, mashtrime, humbje dhe shpërdorime”. Në dy faqe, në vazhdim të raportit janë përmbledhur vërejtjet të cilat përmendin ministri dhe organizata buxhetore të dalluara për keqpërdorim të kësaj natyre. Për të argumentuar këtë, janë identifikuar 11 projekte të financuara jashtë buxhetit në vlerë 6 milionë e 900 mijë. Është bërë ri destinimi i mjeteve buxhetore pa procedura ligjore në rreth 30 projekte. Vlera e shtuar është 8.439.000 euro. Janë shkelur procedurat e prokurimit, duke përdorur pa nevojë procedurën e negociuar 34% të tenderëve të madhej që kanë vlerën mbi 3.000.000 dhe është lidhur kontratë me ofertuesit më të shtrenjtë të përgjegjshëm në 5% të gjitha rasteve të lidhjes së kontratave për investime kapitale dhe për furnizime se, në qoftë se kuantifikohet me vlerë globale arrin në dëmtimin e buxhetit për 25 milionë euro. Nëse këtyre ju shtohen edhe kontratat ame operatorët e papërgjegjshëm dhe shkeljet tjera të ligjit, rezulton që keqpërdorimi në tërësi arrin mbi 100 milionë euro në vitin 2008, pra një shifër, një shumë tre shifrore e milionave. Së fundi ky është edhe konstatim i Raportit të progresit të Komisionit Evropian, që tash kohën e fundit është aktual.

Konstatimi i auditorit gjeneral se mungon disponimi për luftimin e kësaj dukurie është pjesa më brengosëse e raportit. Dhe, si përfundim, Grupi Parlamentar i Aleancës kërkon që Kuvendi i Kosovës ta miratojë këtë raport dhe rekomandimet e auditorit gjeneral t’ia adresojë Qeverisë për të marrë masa ndaj bartësve të këtyre dukurive dhe në një afat prej 1 muaji, ta informojë Kuvendin për masat e marra, në rast të kundërt përgjegjësia kalon te Qeveria. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit edhe prej teje, deputet i nderuar.

Vazhdojë, radha është e Grupit Parlamentar i AKR-së. Kush e do fjalën prej juve? Profesor Smaka, deputeti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,
Zotëri ministra,
Zonja ministre,

Deputetë të respektuar,

Grupi Kuvendor i AKR-së e mbështet Raportin njëvjetor të auditimit për vitin 2008, me aksent që të realizohen rekomandimet e konkludimet e konstatimet e auditorit. Ja vlen për t'u ndalur në disa mangësi e në disa defekte të cilat, por të mos thënë se janë alarmante, por janë tepër shqetësuese. Bije fjala, këtu faqja thotë (i) edhe ky dokument nuk është metodologjikisht i hartuar bash si duhet, por nuk po lëshohet në atë, thotë shumë organizata buxhetore nuk kanë dorëzuar kontributet e tyre në PVF-në me kohë ose fare. Kjo çështje është tepër serioze, ose organizata buxhetore kanë regjistra jo të plotë kontabël, që do të thotë i kanë me defekte regjistrat kontabël, do të thotë, të hyrat, si të them nxjerrën e hyjnë e manipulohen e spekulohen pa evidenca që e dëmtojnë parandë publike ose ekzistojnë prezantimet e mangëta të pasurive ose ekzistojnë disa komuna të cilat kanë mbetur mbrapa sa i përket trajtimit të kontabilitetit e tjera.

Ajo që është për mua më brengosëse është kjo, në faqe (ii) me të vërtet nuk di se si është ky numeracion. Mosrespektimi i ligjeve dhe i rregulloreve është i shpeshtë ose mungesa e njohurive themelore të kontabilitetit. Unë personalisht konsideroj se ky është një vlerësim voluntarist i auditorit se nuk mund të jetë kjo që nuk njihet kontabiliteti nga njerëzit tanë që e punojnë, por unë dyshoj se njihet, por nuk e përfillin, aty është puna, por nuk është puna që mungesë njohurive themelore të kontabilitetit, është vlerësim tepër arbitrar. Më pastaj, aktet nënligjore thotë nuk janë fare të harmonizuara me aktet ligjore. Kjo është tepër keq, kjo, domethënë paligjshmëri edhe kjo është cenim flagrant i rendit juridik, se në qoftë se aktet nënligjore nuk janë në harmoni me ligjin, atëherë do të thotë ne veprojmë në mënyrë arbitrar, ashtu si bie fjala më tekem mua në qoftë se do të isha titullari i një funksionit publik.

Është fakt që e kemi ngritur këtë çështje edhe në Kuvendin tonë, që mungon Ligji për pagat edhe për mëditjet edhe këtë duhet ta bëjmë sa më parë që është e mundur, sa më mirë që është e mundur dhe më pastaj të angazhohemi të përfillet se shumë konsekuenca këtu janë nga ky shkak se nuk e kemi aktin ligjor. Më pastaj, kontrolli i brendshëm, revizori i brendshëm pothuaj se nuk ekziston madje edhe ku ekziston, është nën tutorinë e menaxhmenteve me shantazhet më se të ndryshme. Edhe këtu ia vlen që statusi juridik i auditorit intern të rishikohet me një vlerësim kritik edhe të definohet qartë dhe të jepen autorizime që të jetë sa më shumë që është e mundur, i pavarur nga menaxhmenti.

Te faqja (v) Kontratat për pagat

Kontratat për paga konkludohet se ka shumë që janë fiktive, ka shumë që janë simulative. Kryhen pagesa në kundërshtim me kontratat. Kontratat pothuaj se gjithmonë janë në periudhë të caktuar madje edhe atëherë kur punët janë të përhershme, që është krejt kolizion me Ligjin e kështu. Edhe disa, mendoj se këto ishte dashur me shumë seriozitet t'i marrim. Unë e marr po e zëmë një nga, qe bie fjala Ministria e Shëndetësisë, e para, jo që është këtu profesioni Gashi, por e para këtu në faqen gjashtë, thotë: të hyrat nuk janë të besueshme në dokumentet burimore, më pastaj thotë mosharmonizimi me Ligjet për prokurimin, menaxhimi i dobët i pasurisë fikse, kontrolli i dobët i brendshëm, e këto janë pothuaj se të gjitha ministritë me intensitet oscilativ, diku me tepër, më ashpër, diku pak më butë.

Qe e marrim, bie fjala Ministria e Arsimit, shpallorje joadekuate e aseteve fikse, mosharmonizim me Ligjin për prokurimin, në qoftë se është në diskrepancë, atëherë duhet me thënë punohet pa ligjshëm edhe kur punohet me qëllimin më të mirë edhe me

dijen më të mirë për të punuar mirë, nuk mund të jetë në harmoni me ligjin. Menaxhimi i keq i pasurive fikse. Kontratat në vepër, në kundërshtim me Rregulloren të thesarit, do me thënë kjo i bie kësaj, nuk ka për mua Kushtetutë, nuk ka ligj, unë ta jap kontratën që po dua vetë edhe kësaj soji. Kjo nuk mund të ndodhë as në Bangladesh e as në Bregun e fildishtë. Ju lutem, Ministria e Bujqësisë, shpалosja joadekuate e aseteve, mungesë e evidencave kontabël për të hyrat dhe mangësinë në projektet e mëdha, kadastër, mungesë në menaxhimin e financave.

Zoti Kryetar,

Grupi kuvendor i AKR-së, konsideron se këto vërejtje, e miratojmë këtë raport në parim me kushtin që më me seriozitetin më të lartë, në radhë të parë ministritë tona t'i marrin këto, t'i identifikojnë, t'i operacionalizojnë edhe t'i përmirësojmë e t'i tejkalojnë, me kusht që edhe rastet të cilat janë flagrante që bien ndesh me Ligjin të ndëshkohen sipas ligjit, ndryshe do të ishte e kotë auditimi, konstatojmë edhe e miratojmë raportin dhe kurgjo kërkoj, po jo kurrëgjë kurrkujt por çdo kush le të përgjigjet për punën e vet dhe për mos punën e vet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Tani është radha e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra prezentë,

Deputetë të nderuar,

Për çudi deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës nuk dëshirojnë ose kanë punë më të mençur të ballafaqohen me realitetin, e ky realitet është i dëshmuar në këtë raport të auditimit të përgjithshëm. Ajo çka mund të filloj nga ajo çka parafolësit nuk e thanë, dhe një gjë është aq sa hipokrite, aq e papërgjegjshme por edhe e pamoralshme.

Para disa javëve, kemi pasur konferenca me gazetarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ministrive përkatëse ku dalin para opinionit dhe deklarojnë- e përkrahim auditorin, e përkrahim raportin, shprehet gatishmëria për të bashkëpunuar, ndërsa sa i përket vlerësimeve që i jep auditori, gjithçka përkthehet në kontestin pozitiv. Çka do të thotë kjo, ose po mashtrohet opinionin publik ose ne po krijojmë vetëkënaqësi nga ky realitet që po e përjetojmë dhe po e jetojmë çdo ditë.

Një gjë është shume sigurt. Ato çka i thanë parafolësit që qëndrojnë plotësisht, mirëpo ato çka janë evidentuar në këtë raport mund ta përkthejmë me një fjalë një mal me parregullsi, korrupsion, keqpërdorim, humbje të parasë publike dhe çdo fjalë mundshme që ka të bëjë dhe bie në kundërshtim me ligjin dhe me ligjshmërinë në përgjithësi.

Po filloj, sistemi i kontrollit të brendshëm u tha po nga parafolësit nuk funksionon. Të hyrat që realizohen nga institucionet e caktuara, nga organizatat buxhetore nuk derdhen në llogarinë e thesarit, dështim në mbylljen e avanseve, detyrime të pashlyera vazhdojnë të mbesin, mosbarazim në evidencën e thesarit me pasqyrën financiare. Ajo çka është shumë injorante, theksohet në këtë rast se auditori ka dhënë një vlerësim, një konstatim që shprehë brengosjen për atë se çka është duke ndodhur në Kosovë dhe një gjë, thotë kësaj soji: Injorimi i vazhdueshëm i të gjeturave dhe rekomandimeve që dalin nga zyra e auditorit të përgjithshëm nga ana e institucioneve të vendit. Nga 23 organizata buxhetore, vetëm një i ka adresuar, i ka përfillur rekomandimet e auditorit të

përgjithshëm ajo që ka ngjarë në vitin 2007. Çka do të thotë kjo? Ne po bëjmë auditim të kotë. Ky raport apo këto vlerësime që jepen sot këtu, këto përfundojnë diku tjetër, ndërsa në anën tjetër krejt porositi që jepen qoftë nga faktori ndërkombëtar, në qoftë nga ato vendore, nga organizatat e ndryshme janë të kota për arsye se këtu udhëhiqet me një kurs i cili është aq injorant, aq i pamoralshëm dhe aq primitiv. Kur flas kështu kam për bazë edhe argumentet shitesë që tash do t'i lexoj para jush dhe krejt i keni në faqen...

(Ndërhyrje e Kryetarit)

... Zoti kryetar, unë vetëm çka është në raport po e lexoj.

Zyra e prokurimit, ajo çka tek ne është e njohur me tenderomani. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në mënyrë të përsëritur ka identifikuar se prokurimi është një nga fushata e organizatave buxhetore me rrezik domethënës për: mos efikasitet, korrupsion, mashtrim, humbje, shpërdorim. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka vërejtur se kontraktuesit janë paguar pa dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e punëve. Nuk ka pasur raport teknik, Kjo është keqpërdorim klasik, korrupsion klasik, janë shembujt konkret në cilat ministri. Janë kryer pagesa pa u përfunduar punët, janë nënshkruar punët si të papërfunduara dhe për të njëjtën punë është krye pagesa pavarësisht prej faktit se e dinë, thotë që nuk është përfunduar puna. Ministria e Bujqësisë, rast konkret dhe Ministria e Arsimit.

Kontratat që ju kanë dhënë ofertuesve me çmimet më të larta thotë, përkundër faktit se kriter për dhënien e kontratës për të fituar tenderë, ka qenë çmimi më i ulët. Shembuj i marrë Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Administrimit Publik.

Tenderët iu kanë dhënë ofertuesve të papërgjegjshëm që nuk kanë ofruar dokumentacion, Ministria e Transportit dhe Poste- Telekomunikacionit dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Për komuna nuk ka shumë kohë të flitet për arsye se ajo çka evidentohet në komuna, tregon se ne po vazhdojmë po e marrim mësim, është e evidentuar këtu. Parat të cilat janë.... I nderuar deputet, nëse ju nuk pajtoheni me këtë çka shkruan në këtë raport, keni të drejtë ta thoni dhe ta shprehni këtu në foltore qëndrimin e juaj. Mirëpo, ky është korrupsion klasik dhe përmasat e këtij korrupsioni kanë përfshirë sistemin. Ajo çka evidentohet këtu, duhet të përshëndetet auditori i përgjithshëm derisa të kemi të bëjmë me një ndërkombëtar. Sikur të ishte një vendor, ndryshe do ta kishim një raport për arsye se këtu po vendoset monopol i skajshëm në të gjitha sektorët dhe po ngulfatet kritika, po ngulfatet fjala e lirë, ndërsa sot kur bëhet fjalë për këtë raport, shikoni sa kemi deputetë përpara, ndërsa ku i kemi këto resorët kryesor që kanë po them buxhet enorm karshi sektorëve tjerë, sot nuk janë prezent, ndërsa vazhdojnë t'i përkthejnë të gjitha këto kritika, të gjitha këto akuza në gjuhën e suksesit, në gjuhën e menaxhimit të drejtë dhe në gjuhën çfarë dinë këta vet. Pra edhe kjo mbetet me sloganin që e përdorin shumë deputetë "krenohemi me Kosovën" Ky është ai krenimi ynë që po ia bëjmë Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ministri është këtu, debati zhvillohet me ata që dëshirojnë të dëgjojnë, kështu që mos u bëni fort merak për atë punë.

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsjedice! Mislim da kada u jednom teškom danu u kojem se bavimo sa nizom vrlo značajnih debata, ako dodje iz analiza godišnjeg izveštaja revizije Generealnog revizora o finansijskoj godini 2008, pri kraju

radnog dana, onda smo svakako u situaciji da improvizujemo mnogo toga što je veoma bitno. Dobro, ja ću da odmaram dok predsednik odmara. Ne, odmaraćemo obojica. Vi ste završili predsedniče, onda i ja nastavljam...

KRYETARI: Vazhdo, vazhdo fjalën!

DŽEZAIR MURATI:... Ju faleminderit! Kažem, kada ovako značajna oblast koju moramo da analiziramo pri kraju radnog dana kada smo imali toliko mocija i debata, onda je svakako da ćemo morati nešto da improvizujemo. Svaka improvizacija ide na štetu onoga što kažemo detaljan uvid i analiza Izveštaja Generalnog revizora za godinu 2008. Ako pogledamo zakon koji reguliše ovlašćenja Generalnog revizora, čiji je sažetak pred nama i kada se uzme potom koja sve ovlašćenja ima, ne znam koliko imamo prostora iznetih i neka subjektivna ili objektivna mišljenja i krajnosti koje su se ovde čule, od onoga da je sve u najboljem redu, što provejava čak u nekim segmentima izveštaja Generalnog revizora, do osporavanja svega što smo već čuli u prethodni disiusijama.

Parlamentarna grupa „7+“ je analizirajući ovaj izveštaj prvo dala primedbu zašto ide ova mocija u ovako kasne sate, u danu kada smo toliko zamorni i sigurno da nećemo moći dati doprinos sa učešćem i drugih naših članova zato što je baš dato na izmaku radnog dana. Mi, prihvatajući određene primedbe kojih ih ima u izveštaju, prihvatajući sve to, mi u celini nadamo se da će nakon ove analize mnoge od primedaba biti ugrađene, ali mi ga svakako u celini prihvatamo, kako su to i neki šefovi parlamentarnih grupa pre nas izneli. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Po edhe unë po flas për opinionin. Realisht çdo kund në botë parlamentet punojnë edhe deri në orën 12,00 të natës, kështu që nuk është diçka e veçantë në Kuvendin tonë. Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk është lajmëruar kurrkush, atëherë fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, i nderuar Kryetar!

Janë disa dokumente, të cilat realisht në Kuvend mund të diskutohen dhe të debatohen formalisht, thjeshtë, por janë disa dokumente tjera të cilat nuk mundet veç me një votim shkel e shko të bëhen, me një debat shkel e shko të bëhen.

Ky dokument që po e shqyrtojmë sot, besoj është në radhën e të dytëve, është dokument i cili duhet më së paku pak të na kthjellojë edhe si Kuvend, edhe si Qeveri, të shohim ku është Qeveria dhe ku është Kuvendi në çështjen më thelbësore për një shtet, që është menaxhimi i financave publike? Frikësohem se këto ditë do të ketë edhe dokumente tjera që do të duhej ta bënin për t'u dridhur dhe për të parë se ku jemi si shtet, si shoqëri, si Qeveri, si Kuvend?

Ka plot tema që diskutohen në këtë raport, dhe po të isha unë ministër i Ekonomisë dhe i Financave, para se të mbaj fjalime të bujshme, do të kisha tentuar për të dhënë përgjigje në çdo rresht të këtij raporti të auditimit. Nëse lexohet me vëmendje çdo paragraf i këtij raporti, kërkon një përgjigje të ministrit dhe ministri do të duhej ta mblidhte Ministrinë e vet që t'i sillte Kuvendit dhe t'i sillte Qeverisë ku është vetë përgjegjëse për të metat që janë evidentuar në këtë raport.

Unë nuk do të flas për ato atë meta. Do të përmend vetëm dy çështje substanciale që nuk janë gabime të procedurës, por janë çështje substanciale që kanë të bëjnë me politikën e menaxhimit të financave publike. Nën një, është kontrolli i brendshëm, auditimi i brendshëm, besoj të gjithë e dimë çka do të thotë për çdo institucion dhe veçanërisht për Qeverinë e Kosovës auditimi i brendshëm? Auditimi i brendshëm është siguresa, siguresa kryesore për mirë menaxhimin e financave publike brenda organizatave buxhetore. Në faqen 26 mund të lexoni konkluzionet e auditorit për këtë mekanizëm. Unë vetëm po e argumentoj, po e citoj shkurtimisht.

“Auditimi i brendshëm është në fazën e hershme të zhvillimit të saj”. Do të thotë nuk ka bërë asnjë hap në zhvillim qysh është, qysh ka qenë auditimi para 5 vjetëve, aty ka mbetur, nuk është zhvilluar asnjë hap përpara.

Krijimi i komisioneve të auditimit duket se kanë ngelur prapa, do të thotë auditori gjen një kthim prapa në procesin e auditimit të brendshëm. Kjo është çështja e parë substanciale. Çështja e dytë, është pika e dytë nevralgjike në menaxhimin e financave publike, janë procedura e prokurimit. Procedura e prokurimit, i gjeni në faqen 32. Unë nuk do të lexoj, i përmendën disa prej kolegëve, por janë rreth 11 vërejtje përmbajtjesore për shkelje të rregullta të procedurave të prokurimit. Po rezymo. Kontrolli i brendshëm – auditimi nuk funksionon, bile është kthyer pak prapa dhe auditori konstaton se nuk mund të besojmë se në vlerësimet e auditorit të brendshëm, do të thotë, nuk janë vlerësime të sakta edhe ato që bëhen. Dhe, dy, procedurat e prokurimit nuk janë të ligjshme. Çka do të thotë kjo? Në dy pikat themelore kah kalojnë financat publike nuk jem të sigurt, nuk jem të sigurt si Kuvend, si Qeveri, si publik, si opinion publik, do të thotë, paraja publike kalon nëpër procedura të pasigurta dhe unë, tash po e ndërlihdh këtë raport, dëshiroj t’ju kthej pak prapa me disa veprime të Qeverisë në Administratën Publike. Nëse auditimi i brendshëm nuk funksionon, nëse procedurat e prokurimit nuk janë të sakta, atëherë kush i ka në dorë këto punë? Unë po dëshiroj t’ju kthej mbrapa para një viti lufta e madhe që është bërë në Qeverinë e Kosovës, që këshilltarët politikë të ministrave dhe të Kryeministrit të bëhen sekretarë të përhershëm nëpër Ministri. Është një koncentrim i të gjitha punëve të administratës, të gjitha kompetencave ku ju takojnë e ku nuk ju takojnë edhe auditimi i brendshëm edhe prokurimi në duar të sekretarëve. Ky është politizim i skajshëm i administratës publike dhe kjo është çështja themelore që do të duhej ta bënte ministrin edhe Qeverinë komplet të vijë këtu dhe të mundohet ta lusin Kuvendin që të gjejë një zgjidhje për këto probleme. Nuk janë paratë as të Kuvendit e as Qeverisë, janë paratë e taksapaguesve, janë paratë të gjithë neve. Do të thotë secili prej neve ka hise në ato taksa dhe secili prej neve jep përgjegjësi për menaxhimin e atyre taksave.

Unë tash po pyes, duke i pasur gjitha këto parasysh, këto të meta që janë evidentuar në Raportin e auditorit a janë gabime brenda sistemit apo është një tendencë për të krijuar një sistem të gabuar të menaxhimit të financave publike? Po të ishte e para, po të ishin disa gabime brenda sistemit, çdo qeveri ka gabime brenda sistemit, çdo administratë ka gabime, ato përmirësohen më lehtë, por unë besoj se problemi është më i madh, problemi është politik, është tendencë për të krijuar një sistem të gabuar të menaxhimit të financave publike për qëllime jopublike.

Një argument tjetër, pse po mendoj kështu, përveç këtij raporti, unë kam dëgjuar dje me vëmendje diskutimet e kolegëve deputetë në seancën e kaluar. Një pjesë e diskutimeve nuk kanë qenë teoretizime, kanë qenë shifra konkrete. Paratë që janë shndërruar në letra me vlerë, që janë edhe në këtë raport, nuk janë teoretizime, është një numër, një

shifër e caktuar e parave që është shndërruar në letra me vlerë dhe Qeveria nuk po tregon në Kuvend ku janë ato para dhe sa është fitimi prej atyre parave? Pra, që kanë hyrë vetëm 8 kilogram ari në Kosovë gjatë një viti, nuk është teoretizim. Qeveria do të duhej, Ministri ta mbledhë Qeverinë, Ministrinë e vet dhe ta hetojë këtë rast qysh është e mundur 8 kilogram ari kanë hyrë gjatë një viti në Kosovë? Në vitin kur po e citoj kolegun tim Maloku, në vitin kur është shtuar asfaltimi i rrugëve në Kosovë, është zvogëluar për qindra tonelata, mijëra tonelata importi i asfaltit në Kosovë i bitumit. Këto janë fakte që duhet ta tronditin Qeverinë, jo në kuptimin negativ, por që t'i marrë në përgjegjësi, pra t'i hetojë rastet, t'i hetojë dhe të vijë e të raportojë në Kuvend që qysh është problemi.

Përkundrazi, Qeveria nuk po reagon, e ka humbur ndjeshmërinë e reagimit në këto çështje dhe kjo po më bën të dyshoj se, do të thotë, është një vi politike për të krijuar një sistem të gabuar të menaxhimit të financave publike, që do ta paguajmë shtrenjtë të gjithë ne. Prandaj e ftoj Qeverinë, prej Kryeministrit që të përgjigjet, të kenë ndjeshmëri, të kenë ndjeshmëri ndaj vërejtjeve të auditorit. E citoj me të drejtë një koleg deputet këtu, shkruan në këtë raport: "sugjerimet që i ka dhënë auditori nuk i ka përfillur në asnjë rast Qeveria". Sot ministri, pak përpara tha se unë po i shënoj të gjitha çka po flisni ju dhe do t'i përfillim. Nuk është e saktë, nuk i kanë përfillur në vitin e kaluar, nuk do t'i përfillin as tash, por e ftoj Qeverinë që të vijë në kuptimin më pozitiv, që të jap përgjigje në vërejtjet e këtij dokumenti. Nuk duhet për të ikur, për t'u fshehur prej dokumenteve të tilla. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet. Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ku mbet Fridmani, ku mbet ky eksperti, nuk është këtu, a? Po të kishte qenë mbarë e mirë, të nderuar deputetë, këtu dikush do të futej në burg për shkak të këtij raporti. Po të kishte punuar mbarë e mirë EULEX-i, të cilin të paktën Qeveria me plotë gojë thotë se e kemi thirrur për të na ndihmuar në sundimin e ligjit dhe ashtu edhe është krijuar më 4 shkurt të vitit 2008, sot, shumë njerëz kishin qenë nën hetime, shumë njerëz do të ishin nën hetime dhe në seanca gjyqësore.

Këtu u përmendën disa faqe, dikush e përmendi faqen 22, lirisht përmendni krejt faqet për të zeza. Nuk ka faqe ku nuk ka nga një të zezë të madhe, ka edhe tjera që ka edhe më shumë, nga pesë a gjashtë, për shembull. Shikoni, gjenden shkeljet, unë veç i përmbledha kështu në procedurat e prokurimit, marrjen e pagave pas kryerjes së kontratës, emërimet pa konkurse publike, shkeljen e procedurave të shpenzimeve për reprezentacion nga Zyra e Kryeministrit. Janë blerë telefona Ajfon, por këta ministra nuk dinë t'i përdorin këta telefonat e thjeshtë, e paramendo po blejnë këta telefonat të sofistikuar Ajfon. Nuk ju shkon për personalitet, po me para të shtetit pse jo. Kjo ishte shumë e fortë. Janë blerë mobile në një ministri të cilat nuk gjenden te Ministria, por në shtëpinë ministrit janë gjetur.

(Dikush nga salla pyet- cilit ministër?)

...Ministrit të Kthimit. Këtë informatë e kam unë, le të dalë ai le ata demantojë këtë dhe tash shtrohet pyetja se çka bën EULEX-i këtu? Sinqerisht, sistemi ynë gjyqësor është

bërë mozomakeq dhe më nuk bën as të thirremi në atë sistem që nuk ka, është anarki totale.

Më ka pëlqyer një deklaratë e auditorit gjeneral, pra një deklaratë e tij, zoti Aufoson , thotë:” nëse gjetjet e zyrës sime nuk shprien në një ndryshim dhe nëse nuk kanë asnjë rezultat, atëherë buxheti që e shpenzoj unë do të jetë humbje e parave të qytetarëve”, njeri i sigurtë. Po kjo, unë mendoj se i shkon EULEX-it drejt kjo deklaratë dhe është bërë në gjuhën angleze, kështu që nuk kanë pasur nevojë për t’ua përkthyer dikush, sepse shpeshherë gjërat po humbin kuptimin në përkthim. Nuk ka ministri që nuk janë gjetur shkelje, ku të duash merreni, prej Ministrisë së Ambientit, të Shërbimeve Publike, e të tjera, e të tjera. Ishin shumë qesharakë këta ministrat kur të gjithë e pranonin raportin dhe jepnin atë farë sqarimin se ka pas shkelje teknike. Shih ti! A, ekspertët i kemi çua në ministri! Shkelje teknike! E çka është tash ajo shkelje teknike? Pastaj, e kishin edhe një arsyetim, po janë raporte më të mira se të vitit të kaluar, apo të qeverisë... Me fjalë të tjera, ne ma pak kemi vjedhur se që kanë vjedhur të tjerët. A bën more burra kurrkush mos të vjedhë? Po ju s’jeni ardhur në pushtet për të vjedhur më pak. Ju keni premtuar se s’keni për të vjedhur hiq. Kështu kjo shpjegohet. Raportet e sivjetshmit janë më të mira se të qeverisë së kaluar. Demek, ne më pak kemi vjedhur se ata përpara.

Sinqerisht, ky raport i auditorit u shkon për shtati të gjithë atyre kundërshtarëve të shtetit të Kosovës, të cilët po thonë se Kosovarët nuk di të bëjë shtet, nuk mund ta mbajnë shtetin, andaj edhe s’meritojnë ata të kenë shtet. Unë shpresoj se do të zgjohemi nga gjumi dhe do t’u kallëzojmë të gjithëve se dimë të bëjmë shtet, dimë t’i funksionalizojmë institucionet e shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputetja Rita Hajzeraj. Më falni, ministri, zoti Alush Gashi e ka fjalën, para deputetit Rugova. Më fal, zoti ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuari, zoti kryesues,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,
Në kohën e publikimit të këtij auditori gjeneral, unë dhe as Ministria e Shëndetësisë nuk kemi mbajtur konferencë për shtyp, ani se jemi të nderuar që jemi nga të gjitha njësitë buxhetore të shpallur si Ministria e cila ka bërë përpjekje që me kujdesin më të madh t’i shpenzojë paratë publike. Janë 3 të pakualifikuara, ne jemi të parët në mesin e tyre, atëherë vazhdon lista më tej.

Dola këtu jo për t’ju thënë këtë, sepse ju këtë të dhënë e keni të gjithë dhe besoj se gjithë e mirëpritni. Dola për të ju falënderuar për angazhimin tuaj gjatë tërë vitit që me debate, me dhënie të hapësirës që t’i debatojmë çështjet, më keni ndihmuar që në Ministri të Shëndetësisë t’i zbatoj me përpikëri dhe me shumë dashuri rekomandimet që i kam gjetur nga viti paraprak. Me këtë rast e falënderoj Kryeministrin dhe ministrin e Ekonomisë dhe të Financave për përkushtimin e tyre për një rigorozë fiskale sa herë që kemi pasur qasje dhe nevojë për mbështetje.

Ajo që është esenciale për ne, është se desha të jeni në dijeni si Kuvend se për Ministrinë e Shëndetësisë dhe për mua, në veçanti, puna me ekipin e Auditorit Gjeneral ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme. Auditorin Gjeneral për institucionet demokratike unë atë e përjetoj si në mjekësi një lëndë që e kemi ne preventive apo parandaluese të gabimeve. Mendoj se respektimi i udhëzimeve dhe i këtyre konstatimeve na mundëson që ne në punën tonë të përditshme mos të gabojmë, sepse për gabime, për përgjigje nuk bëhet vonë

kurrë. Auditimeve dhe këtyre konstatimeve drejtësia do t'i kthehet në kohën kur do të ketë një fuqizim apo një funksionalitet më të madh. Mësimi im nga ky auditim është që qeveria ka bërë mirë kur ka kërkuar që të bëhet një rishikim funksional i të gjitha ministrive. Në Ministrinë e Shëndetësisë ne kemi nevojë për një riorganizim që Ministria të jetë sa më funksionale, që mekanizmi i kontrollit së punës së përditshme të jetë sa më efikas. Dhe, para vitit të ri, ne si Ministri e Shëndetësisë do të dalim para Qeverisë dhe shpresoj edhe para Kuvendit për një organizim të tillë.

Ju siguroj se do ta vazhdojmë bashkëpunimin me Auditorin Gjeneral që këto ditë e ka filluar përsëri punën në Ministrinë tonë dhe shpresoj që në vitin e ardhshëm ne do të kemi mjaft arsye për gëzim për raportin që do të vjen.

Edhe një herë i falënderoj edhe të gjithë ata të cilët për arsye të ndryshme ngritin çështje edhe në momentet kur mungojnë argumentet, por atyre që i dinë argumentet ajo iu shërben si argument i mirë se ne jemi një demokraci në fillim dhe se demokracinë duhet kultivuar si lulen, duhet ujitur çdo ditë.

Unë ju falënderoj për mbështetje gjatë këtij viti. Me kritikën dhe mbështetjen tuaj shëndetësia gradualisht po arrin të bëhet prioritet nacional. Këto ditë do të vjen buxheti para këtij Kuvendi dhe kërkojmë mbështetjen tuaj që buxheti për vitin e ardhshëm, në kuadër të mundësive buxhetore, t'u përgjigjet kërkesave të vendit tonë. Unë ju garantoj se do t'i respektoj me shumë përkushtim rekomandimet e këtij institucioni parandalues për shkelje të rregullave. Faleminderit shumë!

Drejtimin e seancës e merr Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka kërkuar deputeti Naser Rugova, le të përgatitet Rita Hajzeraj.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse po diskutojmë për një dokument tejet të rëndësishëm që për herë të parë i vjen Parlamentit të Republikës së Kosovës, unë konsideroj se ky dokument dhe Raporti i shqyrtimit të buxhetit për gjashtëmuor do të duhej të bëheshin në seanca të veçanta për shkak të rëndësisë që e kanë për impakte direkte në jetën e qytetarit të Kosovës.

Unë e përkrah Raportin e Auditorit Gjeneral, është një raport shumë konciz, konkret, i mbështetur në fakte. Po citoj, te realizimi i buxhetit. Mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve është i shpeshtë. Arsyeja kryesore duket të jetë mungesa e të kuptuarit të përgjegjësisë themelore nga manaxhmenti. Për kë po bien kambanat, për organizatat buxhetore dhe për ata që i menaxhojnë ato. Mungesa e të kuptuarit më të thellë të dizajnit dhe qëllimit themelor të sistemeve të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësisë. Mungesa e njohurie themelore të kontabilitetit dhe harmonizimi i mangët i urdhëresave me ligje dhe rregullore. Pastaj, po citoj prapë, dëshiroj po ashtu të tërheq vëmendjen tuaj tek disa çështje të veçanta tejet shqetësuese:

1. Niveli i ulët i implementimit të buxhetit, i ndarjes përfundimtare 81%, tregon se organizatat buxhetore duhet të përmirësojnë planifikimin, ekzekutimin dhe përcjelljen pasuese të buxhetit, që nënkupton shumë vakuume, zbrazëtira dhe lë dilema për keqpërdorime të rreth 19% të buxhetit të vendit tonë.

2. Niveli i lartë i shpenzimeve kah fundi i vitit bëhet për të kompensuar këtë në mënyra të rastësishme dhe joefektive 21.4% prej totalit të mallrave dhe shërbimeve dhe 38.7% të shpenzimeve kapitale në muajin dhjetor. A ndodh në menaxhimin e buxhetit në qeveritë normale dhe të shteteve normale, unë nuk kam dëgjuar deri sot.

Edhe pas përmbylljes së datës së pagesave të parapara me udhëzim administrativ, janë kryer një numër i pagesave. Kjo do të thotë që ky raport duhet falënderuar auditorin gjeneral, duhet të miratohet në këtë Kuvend dhe të votohet që të shkojë në prokurori, sepse vetëm këto konstatime dhe këto shqetësime tregojnë mjaft për nivelin e papërgjegjshësisë së planifikimit, menaxhimit, sistemit të prokurimit me financat publike të vendit tonë.

Në faqën 35, te auditimi i performancës është bërë auditimi i programit pensional. Të gjeturat kyçe nga auditimi ynë janë këto: koha mesatare e cila nevojitet për të proceduar një aplikacion për pensionet për personat me aftësi të kufizuara është 149 ditë në krahasim me kërkesat ligjore që janë 90 ditë. Çka bëhet me këtë kohëzgjatje me mjete të njerëzve që janë me nevoja të veçanta, me aftësi të kufizuara dhe e marrin jo një pension, por një lëmoshë nga shteti. Kush guxo të manipulojë me paratë e destinuara për këtë kategori të veçantë të shoqërisë kosovare. Do të thotë, nëse dikush abuzon me mjetet për këtë kategori të veçantë të shoqërisë, atëherë a ka drejtësi, a ka gjyqësi dhe vërtet një kolegë këtu bëri pyetje, çka bë EULEX-i këtu. Unë po i bëj thirrje EULEX-it le të merret me punë për të cilat ka ardhur t merret në Kosovë, realisht, dhe le ta merr vetëm këtë raport të auditorit gjeneral se do të kishte punë mjaft dhe do të rregullohej edhe sistemi i drejtësisë, edhe drejtësia do të vinte në vend, do të vihej në binar sistemi i menaxhimit normal dhe të drejtë të parash publike në Kosovë.

Pastaj, zoti ministër i Shëndetësisë, e kemi auditimin e sistemit për shpërndarje të barnave nga lista esenciale. Auditori e ka zgjedhur si performansë, jo unë, as opozita dhe ma herët kur diskutuam për shqyrtimin e buxhetit, lexuam dokumente të qeverisë, jo personale as të opozitës. Të gjeturat kyçe nga auditimi kanë qenë dobësi në të gjitha aspektet e programit. Bëhet fjalë për furnizimin me barëra, me ilaçe që ndalin vdekjen, ruajnë shëndetin dhe kthejnë jetën. Në rishikim të buxhetit kap shifrën prej një 20 milionë eurove dhe këtu hapen dilema të mëdha pastaj. Ekzistojnë mospërputhje serioze, po citoj, “ndërmjet sasive të vlerësuara të barnave esenciale të nevojshme për çdo vit dhe sasive aktuale, të dhënave dhe sasive aktualisht të kërkuara nga institucionet shëndetësore”. Pse kjo mospërputhje, kush po blen barna me para të taksapaguesve të varfër të Kosovës, ku po i çon dhe pse s’po shkojnë në destinim të duhur. Dikush këtu duhet dhënë përgjegjësi – 20 milionë dhe si është gjendja e furnizimit me barna për pacientët e lodhur të Kosovës. Katastrofale!

Është e vërtetë, se po thotë Zyra e auditorit, o zotëri, nuk po them unë. Po hajde lexoje. Barnatoret dërgojnë kërkesat direkte te Korporata Farmaceutike e Kosovës – KFK në vend të operimit nëpërmjet Departamentit Farmaceutik dhe kjo rezulton në atë që Departamenti Farmaceutik nuk mund të menaxhojë dhe kontrollojë si duhet procesin e shpërndarjes, që nënkupton me gjuhën e popullit – avullim i barërave, i kontingjenteve të caktuara, i sasisë së këtyre barërave që po blihen me para publike prej një adrese në adresë tjetër. Barnatoret nuk i marrin sasi të kërkuara, po citoj, zoti ministër, të barnave esenciale me sa duket për shkak të mungesës së barërave në dispozicion në depon qendrore. E, atëherë, kush i menaxhon barërat e depos qendrore dhe çka po ndodhë me këto gjëra. Do të thotë, unë e citova raportin vjetor të auditimit, domethënë për vitin 2008

dhe nuk janë as hartime nga opozita apo nga deputetët në mënyrë individuale. Dhe jo rastësisht Auditori Gjeneral na e ka tërheq vërejtjen që ta zgjojë vetëdijen e këtij institucioni të nderuar, të njerëzve të zgjedhur dhe ka prekur në dy tema të ndjeshme, te mjetet e personave me aftësi të kufizuara dhe te barnat, te ilaçet që i dedikohen qytetarit të lodhur të Kosovës. Andaj, ky raport duhet të jetë një leksion për Qeverinë dhe për komunat që paraja publike vërtet të menaxhohet konform ligjeve dhe asgjë më tepër.

Dhe, edhe një herë po e potencoj. Kuvendi, lëre që duhet ta votojë këtë raport, por duhet ta votojë që menjëherë ta procedojë në organet e hetuesisë dhe të drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Deputetja Rita Hajzeraj, le të përgatitet Donika Kadaj-Bujupi.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Neve po pretendojmë si shtet që të jemi shtet demokratik dhe ashtu po themi se jemi. Mirëpo, sikur të kishte ndodhur një auditim i tillë në shtetet demokratike, jam e bindur se qeveria e Kosovës do të jepte dorëheqje dhe do të binte.

Ky auditim ka një nivel shumë profesional dhe gjithsesi Grupi ynë i Aleancës Kosova e Re e përkrah me qëllimin më të mirë se nëse ky auditim shkon në organet më të larta dhe merren masa ndaj këtyre auditimeve. Nuk është auditimi i parë i cili iu bëhet institucioneve tona, është auditim pas auditimi, mirëpo asnjë masë konkrete nuk është marrë në lidhje me këtë. Shkeljet të cilat janë bërë në institucionet tona, ky auditim i përshkruan shumë mirë.

Raporti i auditimit për vitin 2008, në bazë të hyrave të cilat i ka sqaruar kemi se në auditimet e të hyrave gjatë grumbullimit janë keqpërdorur nga Qeveria e Kosovës. Për këtë, raporti i auditorit rreth të hyrave thotë se të hyrat e grumbulluara dhe të regjistruara sipas Qeverisë janë 942.5 milionë euro, kurse sipas auditorit në llogaritë bankare të të hyrave janë 907.5 milionë. Nga kjo shihet se 35 milionë euro të të hyrave janë keqpërdorur nga dikush. Pra, sipas raportit të auditorit, llogaritë bankare të të hyrave janë keqpërdorur nga Qeveria për 35 milionë euro.

Auditimi i shpenzimeve të Auditorit Gjeneral. Për shpenzime ky raport i cek këto parregullsi:

- Mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve, sidomos sa i përket shpenzimeve, do të thotë që udhëzimet dhe rregulloret dalin pa konsultim me ligjet të cilat nxirren. Nuk respektohen ligjet dhe nxirren rregullore veç ashtu, siç na tekton neve.
- Mosrespektimi i procedurave të prokurimit, që ka qenë edhe vërejtje e Fondit Monetar Ndërkombëtar;
- Mosrespektimi i Ligjit të buxhetit të shpenzimit të parasë publike.

Te pagat auditori cek një mosbarazim të shpenzimeve në rroga në mes të Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe Ministrisë së Financave në vlerë prej 16 milionë euro dhe thotë se këto mjete mund të jenë të keqpërdorura.

Sidomos Auditori Gjeneral në raportin e tij thotë se shpenzimet e fundvitit 2008, ku në raport thuhet se ka pasur keqpërdorime të mëdha, auditori jo vetëm në dhjetor të vitit

2008, që janë shpenzuar më shumë se 235 milionë euro, pra në 4 muaj janë shpenzuar në dhjetor të 2008-tës. Në dhjetor, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 4 herë më shumë se në muajt tjerë. Pra, raporti i auditimit cek se këtu ka pasur keqpërdorime të mëdha, ku shumë pagesa janë bërë 3 ose 4 herë për një pagesë me intervenim të Qeverisë.

Qeveria duhet të japë të dhëna për të hyrat prej 35 milionë euro keqpërdorim, për pagat 16 milionë euro keqpërdorim dhe shpenzime marramendëse gjatë vitit, sidomos në fund të vitit, që janë rreth 150 milionë euro të pa proceduara në prokurim dhe pa kontrata.

Ministri i Shëndetësisë pak më herët tha se demokracia është një lule e cila duhet të ujitet. Zoti ministër, nëse neve ujisim kështu siç kemi filluar, siç ka filluar Qeveria e Kosovës, atëherë kjo demokraci nuk do të lulëzojë asnjëherë.

Shikoni, ka mjaft paqartësi, sidomos në pasqyrat e aseteve jo financiare, po ashtu auditori ka vërejtur një numër të rasteve ku shpenzimet janë pastruar gabimisht në kodet e departamenteve si dhe në kodet ekonomike. Dhe, si rezultat i kësaj është regjistrimi jo i saktë i shpenzimeve në të gjitha kategoritë kryesore, pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet.

Shikoni pastaj të hyrat në komuna, që janë totalisht të papranueshme. 10 komuna nuk regjistrojnë asnjë të hyrë nga lëshimi i certifikatave të lindjes dhe të martesës në raport me raportet e kodeve ekonomike të përcaktuara nga thesari. 5 komuna nuk kanë regjistruar asnjë të ardhur nga lëshimi i lejeve të ndërtimit dhe tarifave të ndërtimit. 18 komuna, pastaj, nuk kanë regjistruar asnjë të ardhur nga lëshimi i regjistrimit të lejeve të biznesit, e shumë e shumë lëshime tjera, për të cilat ky raport i jep edhe rekomandimet e qarta për këtë Qeveri.

Andaj, unë bëj thirrje që ky raport të shkojë në organet, dakordohem edhe me kolegët e mi paraprakë, që thanë, në organet ku do të merren masa ndaj këtyre keqpërdorimeve, sepse kështu ne nuk mund të jemi një shtet demokratik. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!

Do të doja para se gjithash të theksoj faktin që këtu sot nuk është askush, përveç një ministri – ministri i Shëndetësisë.... Kërkoj falje...po njerëzit të cilët kanë vënë nënshkrime në kontrata të paligjshme dhe pagesa të paligjshme dhe të cilët i ftoj që t'i përgjigjen këtij Kuvendi, sepse edhe dje i kam ftuar publikisht dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje, prapë ikën, ikën prej përgjegjësisë, por drejtësia i zë. Nëse ikin këtu prej Kuvendit, shumë shpejt do të duhej që të raportojnë para organeve kompetente. Dhe, nuk mjafton të pajtohem me raportin, qysh po na ndodh shpesh të dalin ministrat të krekosen para kamerave dhe të thonë se krejt është në rregull, po pajtohem me raportet, qysh na ndodhi së fundit – po pajtohem edhe me raportin e Komisionit Evropian, i cili thotë se në Kosovë ka pak përparim dhe shumë korrupsion. Ndërkaq, të gjeturat në Ministrinë e Bujqësisë e konfirmojnë këtë argument. Është një sektor që drejtpërsëdrejti dëmton jetën e qytetarëve të Kosovës, prandaj Aleanca për ardhmërinë e Kosovës do të diskutojë, në këtë rast do të përmendim shkeljet dhe keqpërdorimet me theks të veçantë që janë bërë në këtë ministri, duke i ngritur gjithmonë shqetësime për pikat në vijim.

Nëse e shihni raportin, në pikën 1 faqe 4, citoj: “Mangësitë e vërejtura në lidhje me kontrollin e brendshme të Ministrisë së Bujqësisë, për sa i takon prokurimeve janë

jashtëzakonisht serioze dhe në mënyrë të theksuar e rrisin rrezikun e prokurimeve të Ministrisë së Bujqësisë për mashtrim, humbje dhe keqpërdorim”. Ky është një citat dhe mund ta lexojnë raportin, ata që po reagojnë.

Nën 2, Administrata qendrore e Ministrisë së Bujqësisë dhe APK nuk kanë të dhëna burimore për të hyra vetjake.

Nën 3, Ministria e Bujqësisë ka dështuar të inkasojë të hyra nga qiradhënia e pronës së paluajtshme.

Nën 4, Agjencia e Veterinës, të nderuar kolegë, aplikon taksa në kufi që nuk parashihen me asnjë ligj apo rregullore në fuqi. Kompanitë me rastin e importimit të produkteve të ndryshme në Kosovë i nënshtrohen një takse në kufi, e cila nuk bazohet në asnjë ligj të Kosovës dhe këtu shihet se sa kjo Qeveri e mbron qytetarin, sepse në fund të fundit, përmes TVSH-së e paguan qytetari dhe konsumatori atë taksë që vihet e paligjshme në kufi. Ka raste, raste të shumta që nuk është risi, të emërimit të zyrtarëve në bazë të lidhjeve familjare, politike. Është një shqetësim jo i Aleancës, por i Auditorit Gjeneral që është vënë me theks të veçantë në këtë raport.

Nën pikën 6, unë do të ndalem këtu dhe do të ftoj ministrin Shala të paktën të ketë aq moral sa të vjen në këtë sallë dhe t’i përgjigjet pyetjes që i bëj. Kompanitë kanë dështuar t’i kryejnë shërbimet e komasacionit apo konsolidimit të tokave bujqësore sipas afatit, kushteve dhe kërkesave të kontraktuara, deri sa menaxhmenti nuk kishte marrë masa të duhura për implementimin e tyre. Ministria e Bujqësisë me nënshkrimin e Ahmet Shalës dhe Idriz Vehapit, për të cilin ka nënshkruar sekretari permanent, në natën e vitit të ri, pas mbylljes së thesarit, të nderuar kolegë, këtu i kemi dy shkelje dhe unë ftoj që të merren masa në këtë drejtim. Në vitin 2008 ka lëshuar pagesë prej 764.161 euro. Natën e vitit të ri, po e theksoj. Dhe, prej këtu, po e ftoj edhe prokurorinë dhe të gjitha organet kompetente dhe po kërkoj nga administrata që të kemi të evidentuar edhe në transkriptin e kësaj seance që të përcillen pistat e krimit ekonomik në bazë të cilave na drejton ky raport dhe të mos mbetet ky vetëm një debat i cili po mbahet pas orës 17, kur nuk ka transmetim të drejtpërdrejt dhe të mbetet këtu pa vazhduar tutje askush të japë llogari për gjithë këto shkelje që janë bërë.

E fundit, po ndalem në pikën 10 të raportit të Auditorit Gjeneral dhe po citoj: “Ministria e Bujqësisë, gjegjësisht komisionet për ndarjen e subvencioneve kanë dështuar të menaxhojnë si duhet dhënien e mjeteve pa kthim”. Ky është realiteti sa i përket subvencioneve për të cilat po krenohet Qeveria. Ky është një mashtrim i radhës që i është bërë fermerëve. Ka raste kur në listën e përfituesve të subvencioneve janë futur të afërmit e stafit politik dhe është bërë presion në komision të pranohet lista. I kemi emrat dhe shumë shpejt do të publikohen dhe do të dorëzohen edhe në prokurori. Se korrupsioni është shumë më i theksuar se në raportin e Auditorit për shkak të ndikimit të stafit politik dhe mos përfshirjes së të gjitha rasteve, po theksoj për fund edhe disa të dhëna të auditorit të brendshëm për menaxhim të tokave. APK-ja ka nënshkruar 138 kontrata për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore, që në fakt nuk është ndërrim, por është ndërrim i përhershëm, që është në kundërshtim të plotë me nenin 5.2 të Ligjit për pyjet e Kosovës.

Që kjo Qeveri ka krijuar sistem korruptiv dhe është duke vjedhur vetveten, tregon edhe fakti që ekziston lista e përfituesve apo të marrjes së tokës për ndërtimin e hoteleve, restoranteve dhe vikendicave, e që shumica e tyre janë përfaqësues të lartë të Qeverisë së

Kosovës. Në një kohë kur qytetarët e Kosovës dhe fermerët po vuajnë për gjëra elementare, ne kemi njerëz, zyrtarë të lartë në Qeverinë e Kosovës që po ndërtojnë vikendica në zona të mbrojtura.

Për përfundim, po theksoj se është utopi të mendohet se në Kosovë ka menaxhim të mirëfilltë me resurse humane, resurse materiale dhe resurse natyrore. Dhe është qesharake të flitet për menaxhime të qëndrueshme me resurse natyrore, kur kemi një raport të Auditorit Gjeneral sikurse ky.

Edhe një herë më duhet të them se e keqja tjetër është, që për shkak të këtij keqmenaxhimi, Kosova seriozisht rrezikon të humb mundësinë e shfrytëzimit të fondeve IPA, ku edhe përkundër premtimit me këtë menaxhim Komisioni Evropian s'do të lejojë që paratë e taksapaguesve të qytetarëve të Evropës të vidhen, të keqpërdoren dhe të përfundojnë në xhepa të pushtetarëve të Qeverisë së Kosovës.

Edhe një herë po theksoj dhe kërkoj që ministri Shala t'i japë përgjigje sa më parë këtij Kuvendi për pyetjen që e bëra – pse janë nënshkruar rreth 800.000, pse janë lëshuar në natën e vitit të ri pas mbylljes së thesarit dhe pse janë dhënë para pa u përfunduar këto projekte. Jemi në vitin 2009 dhe këto projekte figurojnë të papërfunduara. Kërkoj që në afat sa më të shkurtër të marrim një përgjigje nga Qeveria e Kosovës dhe gjithashtu kërkoj nga organet kompetente, nga prokuroria, EULEX-i apo kushdo qoftë që të merren masa dhe dikush të japë llogari për këtë gllabritje të taksapaguesve të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se shumë kolegë para meje kanë pasur paraqitje tepër të mira. I përgëzoj për paraqitjet. Kemi pasur diskutime ekzakte, që rrallë i dëgjojmë në Kuvendin e Kosovës dhe kjo definitivisht ka ndikuar që unë të detyrohem ta shkurtoj fjalën time, për të mos i përsëritur, në fund të fundit, edhe mos të zbeh paraqitjen shumë të mirë të kolegëve.

Sidoqoftë, disa çështje duhet thënë. E para është që dje kam pyetur – pse nuk e ka marrë parasysht Qeveria kur e ka sjellë Strategjinë antikorrupsion edhe raportin e Auditorit. Sipas raportit të Auditorit, nuk del që Kuvendi i Kosovës është institucioni i cili ka shkaktuar më së shumti shkelje. Del krejt përkundrazi. Do të thotë, pyetja ka qenë me vend vjet, nuk është marrë parasysht.

Çështje tjetër, e cila duhet të përmendet është fakti se u përmend më përpara, por po dua vetëm ta nënvizoj edhe një herë, është se është konstatuar se ka mungesë vullneti për ta përmirësuar gjendjen aktuale. Tani këtë po e ndërlidhi me një fakt tjetër. E di se ka njerëz këtu të cilët nuk po dëshirojnë të dëgjojnë deputetët që ta ftojnë EULEX-in që të merret me punë tona. Është e vërtetë dhe sinjerisht mund të them se edhe mua nuk më vjen mirë që të ftohet EULEX-i për gjithçka që ata t'i kryejnë punët të cilat demokracia duhet t'i kryejë vetë, esencialisht. Mirëpo, qysh mund t'i kryejmë ne vetë ne punët. Qysh mundemi t'i kryejmë ne vet punët dhe me çfarë sistemi mundemi t'i kryejmë punët ne vetë kur institucionet e gjyqësorit nuk po mund ta kryejnë punën dhe për të mos hapur kontekst, nuk po ju tregoj pse, por e kam njëfarë bindje se e dini pse nuk po mund ta kryejnë punën. Kur shoqërinë civile e kemi prekariote dhe shumë herë ka mungesë të fondeve, se kurrë ne nuk u japim fonde, por duhet t'ua japë dikush prej së jashtmi fondet, e mos të harrojmë, shoqëria civile është esenciale për një demokraci. Kur mediat

subvencionohen, shumica dërrmuese nga Qeveria... Çka po mendoj, subvencionohen? Merreni dhe numëroni faqet e reklamave, që sot përmendi dikush se është rritur 200% ose 120 e sa për qind shuma e mjeteve të cilat i jep Qeveria për sponzorim, për shpallje të cilat dalin nëpër gazeta pa asnjë nevojë, stërzgjeten, mirëpo gazetat subvencionohen në këtë mënyrë, është një formë e subvencionimit të gazetave të cilat aty krijojnë varësi prej të hollave të Qeverisë, të shtetit, të buxhetit të shtetit dhe fillojnë ta mbyllin gojën vetë. Do me thënë, as këtu nuk jemi... Dhe, e fundit, do të thotë, mediat nuk po bëjnë, gjyqësori nuk po bën, shoqëria nuk mundet pa këto të dyja, në fund të fundit, të funksionojë, ndërsa Kuvendi... nëse e keni parë se çka ka ndodhur dje, hiq më larg se dje, e shihni se Kuvendi, edhe Kuvendi po refuzon ta marrë atë rol. Dhe, atëherë, detyrimisht dikush duhet të thotë – aman bre EULEX, diçka duhet bërë, se ne vetë e kemi humbur totalisht rrugën. Dje ju kam lutur mos ta aprovojme Raportin e Bankës Qendrore. Me sinqeritet ju kam lutur, jo vetëm pse jam në opozitë. Është edhe ajo pjesë e opozitës, ama me sinqeritet kam kërkuar ekzakt për ta marrë atë rol dhe për të treguar se në Kosovë të paktën një institucion ka vullnet politik për të thënë një herë – a të fillojmë e të themi – boll. Mirëpo, as Kuvendi i Kosovës nuk e ka treguar këtë vullnet politik, kështu që disa deputetë detyrohen të thonë – EULEX bre, provo ndihmona pak, se pse ke ardhur këtu dhe kanë plotësisht të drejtë.

Çështje tjetër është se përpos kësaj, ne kemi filluar tash në Kuvend të Kosovës të dëgjojmë edhe shpikje të armikut të brendshëm dhe të jashtëm. Dje e kemi dëgjuar një deputet, thotë këtu se raportet e këqija që po vijnë prej institucioneve ndërkombëtare, janë pasojë e diskutimeve të deputetëve këtu, edhe ata po bëjnë keq për shkak se armiku i brendshëm po i furnizon me informata. Ju kujtohet juve, ju kujtohet juve se prej nga e ka prejardhjen sistemi i armikut të brendshëm dhe të jashtëm. Mund ta merrni transkriptin dhe ta shihni se çka ka folur dje zoti Gani Buçinca. Dhe, ju kujtohet menjëherë armiku i brendshëm dhe i jashtëm. Domethënë, ne që flasim dhe që e kritikojmë Qeverinë, ne jemi armiku i brendshëm, e ata që i shkruajnë raportet, janë armiku i jashtëm.

Një çështje tjetër, para se të dal dhe t'i citoj disa pika të auditorit, është... Po, vërtet duhet ta përsërisht auditorin, që kam harruar, me të vërtetë duhet të përsëritet. E ka krye punën e vet, në fund të fundit, po është mirë se po i përsëritet krejt institucionet që po na bien raporte këtu dhe po themi sa të mirë e kanë prurë, duhet ta përsëritet edhe Auditorin e Përgjithshëm.

Ka filluar me performancë këtu. Ka filluar me performancë dhe është mirë që të auditohet performanca. Mirëpo, ne duhet ta auditojmë performancën vetë. Kjo është esenca e fjalës sime sonte. Ne duhet të fillojmë si institucion ta auditojmë performancën vetë. Nuk ka lidhje që nuk ka transmetim, po hajde ta bëjmë vetë. Vetë, si deputetë. Ta shohim pak përgjegjësinë edhe vetë, pa pasur transmetim të drejtpërdrejtë. Shembull ta marrim, pse për 8.600 metra rrugë, 4 operatorë vonohen më shumë se 1 vit për ta kryer punën. A është kjo performancë që na çon ne diku. 8.6 kilometra rrugë të cilat janë paraparë të kryehen për 180 ditë, nuk janë kryer për 420 ditë që janë sot dhe gjysma po do të lëshohet tash, do me thënë, nuk kryhen diku për 2 vjet. Kanë filluar më 15 gusht të vitit 2008, s'janë kurrkund. Kjo performancë, për shembull, dhe pse nuk merr masa, shembull ta marrim, Ministria e Transportit t'u thotë kompanive – jeni futur në listën e zezë, se nuk e keni kryer punën me kohë. Po nuk ka qysh t'iu thotë se ua ka marrë tallin. Qysh t'iu thotë. A është, shembull ta marrim, që një dokument tjetër ku e keni.... Po, janë paratë e mia, të popullit janë, mbajeni mend! Një performancë tjetër. Me datën 2 shtator të vitit 2008, është nënshkruar kontrata me Kompaninë Mabetex për renovimin e pallatit "Rilindja". Është dokument origjinal i Qeverisë. Rishikimi i buxhetit është bërë më 29 korrik. Në më

pak se 40 ditë është nënshkruar kontrata për kryerjen e punëve. Ka deputetë këtu që i dinë ligjet ndoshta edhe më mirë se unë dhe e dinë çka do të thotë kjo. Edhe kjo është performancë. Edhe, ai objekt, për të cilin janë dhënë 15 milionë euro – 14 milion e 900 e diçka, a e dini saktë, nuk është kryer as pas një viti. Tash jemi me datën 13 tetor, e me datën 2 shtator të vitit të kaluar është nënshkruar kontrata për renovim. Edhe kjo është performancë.

Tani po dal vetëm në disa pika, po i citoj. Po kthehem, dje te ajo farë fjala ime, për të cilën nuk më mbështetët, për 266 milionë euro. Në raport të auditimit e keni të shkruar në faqe 16 – letrat me vlerë dhe konkluzionet. Pa e cituar po ju tregoj edhe një herë. Kanë dalë prej buxhetit të Kosovës të holla të qytetarëve të Kosovës – 266 milionë euro prej Kosovës për gati 2 vite. Nuk e kemi marrë as interesin, nuk e kemi marrë as kamatën dhe nuk i kemi të hollat. Do me thënë, është tejkaluar edhe afati i kthimit për këto të holla. E tashti, a duhet të pyesin ne, si Kuvend i Kosovës, pa transmetim, a është në rregull kjo punë, apo duhet prapë t'i ngrehim duart dhe të themi – këqyre ti punën tënde e lëre ti ta këqyri unë punën time. Unë nuk besoj se dikush prej deputetëve, nuk dua të besoj që deputetët e Kosovës janë të ulur në këto karrige për të bërë kështu. Unë, të paktën nuk jam ulur për ta mbyllur gojën, unë nuk jam ulur për të bërë kështu. Kushdo që është ulur, le ta çojë dorën, po i ftoj për ta çuar dorën.

Ka edhe çështje tjera për të cilat ne mund të flasim dhe është ndoshta koha për t'u përgjigjur. Ministri tha, nuk është e vërtetë se janë dhënë, që janë kryer punë pa qenë në buxhet. Auditori e konkludon një gjë të tillë. Merreni e lexojeni. Pikërisht auditori thotë, nëse dikush di ta gjejë se çka thuhet. Për të mos folur, për shembull, për pesë raste që e kanë tejkaluar shumën e kontratës, do të thotë Qeveria ka paguar më shumë të holla për operatorët se sa që ka kontraktuar vetë. Për shembull, ose punë të papërfunduara në Ministri të Arsimit. Po, e di që po ju doket gjatë, se duhet ta mbyll më herët. Punët e papërfunduara janë paguar. Prapë ka deputetë këtu që e dinë më mirë se unë ligjin se çka do të thotë të paguhet punët e pakryera.

Po, prapë se prapë, unë e di që kjo po ju pengon dhe tragjedia nuk është se çka po ndodh, po tragjedia është që po ju pengon që unë po flas. Po ju pengon se ka deputetë që flasin dhe esencialisht kur fillon t'ju pengojë fakti se ka njerëz që flasin për këto tema, atëherë me të vërtetë duhet dikush në Kosovë të bërtasë – EULEX, për shkak se nëse nuk bërtasim – EULEX, atëherë ne nuk kemi zgjidhje hiq në këtë vend, duhet ta lëshojmë Kuvendin ose duhet të themi – po heqim dorë dhe po zgjedhim një parti komuniste, le të qeverisë deri sa të bëhet ndonjë revolucion për nja 30 vjet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë si deputetë, do t'i them 3-4 fjalë.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

Edhe unë po u bashkëngjitëm të gjithë deputetëve që po e vlerësojnë punën e Auditorit të Përgjithshëm dhe unë vërtet e vlerësoj, është një mekanizëm që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, është një mekanizëm që ka për obligim të jetë në mbrojtje të buxhetit të Kosovës, të parasë publike të Kosovës. Dhe, vërtet ajo që unë dua ta them, ky auditim nxjerr në shesh edhe disa çështje tjera. Në rend të parë, nxjerr në shesh se Ligji mbi prokurimin publik duhet të ndryshohet dhe këtë mendoj se duhet ta bëjë Qeveria, ndoshta edhe me mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Një çështje tjetër që e nxjerr në shesh Raporti i Auditorit të Përgjithshëm është fakti se institucionet e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, po edhe institucionet tjera që i përgjigjen

dhe janë pjesë e auditimit, nuk janë krijuar as para 1ë viti, as para 6 muajve, as para 2 viteve. Janë institucione që kanë filluar të funksionojnë para 10 vjetëve dhe për mua është shqetësuese se si gjatë këtyre 10 vjetëve institucionet e Kosovës nuk kanë arritur të ngrehin kapacitete administrative për të funksionuar administrata e Republikës së Kosovës në nivelin e dëshiruar dhe kjo, po them, është shqetësuese. Dhe, nuk duhet të jetë shqetësuese vetëm për opozitën, por duhet të jetë shqetësuese edhe për pozitën, duhet të jetë shqetësuese për Kuvendin, duhet të jetë shqetësuese për qytetarët e Kosovës. Dhe, a ka mund që këto kapacitete administrative të jenë në këtë nivel vetëm për 1 vit a 2 vite të kësaj qeverisjeje, përgjigja është: jo. Këto kapacitete nuk janë ndërtuar, se janë ndërtuar keq qe 10 vjet në Kosovë. Një herë janë ndërtuar keq, kur janë ndërtuar nga përkthyesit që kanë mësuar disa gjuhë të huaja për të komunikuar, janë ndërtuar nga ata. Pastaj, janë ndërtuar edhe nga vetë ne, ndoshta, me njerëz që kemi vrapuar jo punës t'ia gjejmë njeriun, por njeriut t'i gjejmë punë, pse e kam të afërt, e kam mik apo e kam shok, apo dashamirë dhe i kemi mbushur institucionet me njerëz të paafët, me njerëz që nuk e dinë përgjegjësinë e tyre as para ligjit, as përgjegjësinë ligjore, as përgjegjësinë morale dhe për këtë mendoj se nuk është fajtor vetëm pozita e sotme. Nëse dikush... nëse dikë mund ta abstenojmë nga ky Kuvend, janë vetëm deputetët e Aleancës së Re të Kosovës, të tjerët, edhe të LDD-së, edhe të AAK-së kanë përgjegjësi.

Këtu u përmend ndërtesa “Rilindja”. Kjo ndërtesë është përmendur edhe në mandatin e kaluar dhe unë nuk dua ta përsëris. Por, diku rreth 5 milionë mjete të buxhetit të Kosovës nga qytetarët e Kosovës kanë dalë për shkak të anulimit të paligjshëm të një kontrate.

Zonja e zotërinj, këto çështje i kemi ngritur me kohë dhe kemi pas apeluar që të mos gaboni se po e dëmtoni buxhetin e Kosovës.

Kosova, zonja e zotërinj deputetë, është diku jo tamam 11.000 kilometra katror. Është shumë e vogël dhe është shumë vështirë qoftë të pozitës, qoftë të opozitës t'i mbulojnë krejt gjurmët e paligjshmërisë që kanë mbetur gjatë këtyre 10 vjetëve në Kosovë.

Mendoj se ne si Kuvend duhet ta përshëndesim Raportin e Auditorit të Përgjithshëm, të kërkojmë ndërtimin e kapaciteteve administrative profesionale në administratën e Kosovës, ta ndërpresim praktikën e instalimit në kapuçin, të them, të administratës dhe të përgjegjësisë në Kosovë të sekretarëve të shtetit pa konkurse dhe të pameritueshëm. Dhe, kjo faktikisht ka vazhduar edhe në këtë mandat, por nuk është praktikë e këtij mandati të qeverisjes. Është praktikë e mandatit të kaluar të qeverisjes.

Unë e di që dikujt nuk i vjen mirë, por edhe një herë po them, realisht në Kosovë..., këtu nga dikush, nga opozita u kërkua EULEX-i. Edhe unë po e thërras EULEX-in dhe Gjyqësinë e Kosovës që vërtet të merren me gjithë keqpërdoruesit, me gjithë shkelësit e ligjeve që kanë ndodhur gjatë këtyre 10 vjetëve. Unë e kam ngritur zërin kundër marrjes së Gjyqësisë në Kosovë për periudhën e para qershorit të vitit 1999.

(Ndërhyrje)

Unë, po e përmendi edhe LDK-në, edhe PDK-në, edhe AAK-në e LDD-në se goxha gjatë kanë qeverisur në Kosovë dhe nuk kanë dhënë shumë shembuj të mirë. Prandaj, ne po e shqyrtojmë një raport, ne po e shqyrtojmë se a është Raporti i Auditorit të Përgjithshëm mbi bazën e ligjit apo jo. Dhe, mendoj se të gjithë jemi të pajtimit se Raporti i Auditorit të Përgjithshëm është mbi bazën e ligjit dhe ky duhet mbështetur. Duhet ta mbështesim të gjithë që vërtet Qeveria, Parlamenti dhe çdo institucion tjetër të nxjerrë detyrat e veta dhe

obligimet e veta që i ka në raport me institucionet, që i ka në raport me qytetarët por, në fund të fundit, edhe në raport me ardhmërinë tonë.

U tha se çdo vend demokratik..., ju lutem, Kosova është vend demokratik. Vetë mënyra se si nganjëherë po flasim, tregon se ka nivel të demokracisë. Po a është ai niveli i demokracisë që i duhet Kosovës, që na duhet neve, a është niveli i demokracisë që i duhet fëmijëve tanë, lë shumë për të dëshiruar. Ndoshta edhe vetë komunikimi ynë në këtë sallë, tregon se lë shumë për të dëshiruar. Prandaj, nga ky raport, mendoj, të gjithë duhet t'i nxjerrim detyrat dhe obligimet tona. Sigurisht se ekzekutivi ka më shumë, por edhe ne si deputetë, edhe ne si Kuvend kemi detyra dhe obligime që vërtet t'i nxjerrim detyrat dhe përgjegjësitë tona dhe të punojmë, jo çka është interesi i të tjerëve ose çka na thotë dikush nga jashtë, çka na thotë në raport. Unë nuk dua të punoj për raportin, as të Këshillit të Evropës, as të ndonjë raport tjetër. Unë dua të punoj për raportin që i duhet këtij vendi, i duhet qytetarëve të Kosovës, i duhet fëmijëve tanë. Ne për këtë raport duhet të punojmë. Ne duhet të punojmë për fëmijët tanë, se të tjerët sigurisht nuk do të punojnë për neve. Ne duhet të punojmë më së shumti. Prandaj, ju lutem, t'i kuptojmë mangësitë që janë prodhuar në kontinuitet dhe unë mendoj se ky Parlament, edhe Qeveria, po edhe institucionet tjera të pavarura që i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, duhet t'i nxjerrin detyrat e veta dhe t'i ndërtojnë kapacitetet që i duhen administratës dhe i duhen funksionimit të institucioneve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar! Vazhdojmë me diskutimet. Zylfije Hundozi e ka fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zotërinj ministra, prezentë,
Kolegë deputetë,

Testimi i realitetit të ministrit të Shëndetësisë më frymëzoi që unë të flas vetëm për Raportin e Auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe, nën dy, pse në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm Ministria e Shëndetësisë paraqitet si rasti më negativ për keqpërdorime të parasë publike, ndërsa më detajisht ky keqpërdorim i parasë publike, mungesa e kontrollit të brendshëm financiar, mosmenaxhimi i implementimit të kontratave me operatorë ekonomikë, moszbatimi i ligjeve dhe i rregulloreve në fuqi – paraqiten në Raportin e Auditimit të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2008 dhe në raportin e auditimit të performancës në shpërndarjen e barnave esenciale nga Departamenti Farmaceutik.

Ky kaos që po mbretëron në institucionin kryesor të shëndetësisë reflektohet një kohë të gjatë në punën e përditshme të mjekëve dhe të institucioneve publike dhe ajo çka është më kryesorja – në rritjen e sëmundshmërisë së popullatës, gjegjësisht në situatën e përgjithshme të shëndetësisë kosovare, e gjendja nuk ka qenë kurrë më e keqe.

Ajo çka është realitet i hidhur me të cilin ballafaqohen mjekët në punën e tyre të përditshme dhe pacientët tanë, është mungesa e barërave nga lista esenciale për të cilën janë ndarë nga buxheti 15 milionë euro në vitin 2008, e kjo situatë vazhdon edhe më tutje edhe pse në rishikimet e buxhetit të vitit 2009 edhe dy herë jenë dhënë të hollat për listën e esenciale të barnave.

Në raportin e performancës në shpërndarjen e barnave esenciale nga Departamenti Farmaceutik detajisht shpjegohet keqmenaxhimi i këtij sektori. Auditimi ka gjetur dobësi

në funksionimin e barnatoreve në spitale dhe mbajtjen e furnizimeve jo të mjaftueshme me barna nga lista esenciale.

Mungesa e kontrollit të pranimit, të magazinimit dhe të distribuimit të barnave dhe i tërë ky mosfunksionim bën që barnat mos t'u jepen pacientëve atëherë kur atyre iu nevojiten dhe situata e vërtetë është që pacientët edhe më tutje blejnë barna nga lista esenciale duke varfëruar buxhetin e tyre familjar. Auditimi i pasqyrave financiare, të transaksioneve financiare dhe të menaxhimit financiar ka identifikuar dobësi në fushat kryesore të cilat duhet të adresohen urgjentisht nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i organizatës. Këto fusha janë: administrata qendrore, Agjencia Kosovare për Produkte Medicinave dhe Qendra Klinike Universitare. Janë regjistruar vonesa të tepërta në implementimin e kontratave dhe në zbatimin e tyre të pjesshëm, shembull është Klinika Neurologjike në Prishtinë, në Qendrën Klinike Universitare. Kontrollat e brendshme financiare nuk janë të vendosura dhe nuk funksionojnë për parandalimin, zbulimin apo korrigjimin e gabimeve dhe të parregullsive. Nuk mbahen të dhëna të plota financiare dhe operative në pajtim me rregulloret dhe ligjet në fuqi. Në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinave janë lidhur dy kontrata me dy operatorë të ndryshëm për të njëjtën punë në vlerë prej 21.000 euro, pa e ndërprerë kontratën paraprake. Në Qendrën Klinike Universitare është blerë tomografia e kompjuterizuar e trurit, popullorçe – CT, në vlerë prej 600.895 euro dhe nuk është përdorur kurrë edhe pse teknikisht ka qenë në rregull, kurse pacientët edhe më tutje shkojnë në ordianca private duke paguar nga 100 euro për një incizim.

Të gjeturat e Auditorit Gjeneral, të cilat qartë e pasqyrojnë menaxhimin e keq dhe keqpërdorimin e parasë publike, nuk janë asgjë e re për shumicën prej neve, por deri kur do të tolerohen në kurriz të pacientëve kosovarë, në këtë raport nuk përmendet.

Në Raportin e Auditorit jepen rekomandimet për ta përmirësuar gjendjen e tashme, por kush na garanton se këto rekomandime do të përfillen kur te ne gjer më sot nuk ekziston institucion i përgjegjës, por çështjet jetike për qytetarët tanë janë lënë në ndërgjegje e atyre që i drejtojnë institucionet tona, e ndërgjegjja është kategori psikike relative, e cila është e ndryshueshme.

Unë, personalisht, si edhe Grupi ynë Parlamentar e përkrahim këtë raport dhe besoj se këto rekomandime tash e tutje do të miratohen dhe faji nuk do t'u lihet udhëheqësve të institucioneve të mëparshme, duke mohuar fajin e sotëm se e dimë që faji është kategori ose popullorçe – faji është jetim, nuk ka adresë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri, Alush Gashi, e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që ekziston një vullnet i theksuar në të gjitha nivelet për përmirësim të vazhdueshëm të punëve të qeverisjes. Në punën tonë të përditshme si në diskutime, është mirë të matet pesha e fjalës publike dhe është mirë që të orientohet energjinë që nganjëherë ndoshta me qëllimin më të mirë ofrohet një e dhënë e cila nuk është e saktë dhe kjo pasaktësi mund të përshkruhet në mënyra të ndryshme, në kultura të ndryshme, në tradita të ndryshme.

Unë nuk do ta bëj asnjë nga to. Bukuria e Kuvendit është se ka nivele të ndryshme të dije dhe mu për atë shpesh dëgjojmë fjalë të mira, fjalë të urta, por dëgjojmë edhe tjera, të cilat shpesh nuk na ndihmojnë në punën tonë të përditshme. Mosnjohja e vlerësimit të

raportit i mundëson njeriut ta mësojë, ta njeh, por nuk është mirë të përdoret vreri ku nuk ka nevojë. Nuk është sekret dhe nuk është për inat të askujt që Auditori Gjeneral për vitin 2008 Ministrinë e Shëndetësisë e ka vlerësuar se i ka menaxhuar paratë publike më së miri dhe me këtë rast ka kërkuar prej ne që t'i analizojmë dobësitë që i ka gjetur Auditori Gjeneral dhe kemi shumë dobësi. Na ka dhënë rekomandime se si duhet evituar ato dobësi dhe nga dita e parë kemi filluar... Për të mos marrë emra për gojë, për çështje të cilat u ngritën, janë dhënë dy vërejtje për atë të udhëheqësve është çuar në nivelin më të lartë të komisionit disiplinor, për tjetrin, e tjetrin, e tjetrin. Ju ftoj që të vini në Ministrinë e Shëndetësisë, t'i shihni të dhënat. Dikush e përmendi se është dashur këtu të sillen përgjigjet për Auditorin Gjeneral. Unë jam i gatshëm t'ua jap përgjigjet të cilat ai i ka kërkuar, t'ua jap dinamikën javore të implementimit të këtyre vërejtjeve, se jam i bindur se kjo është parandalim për gabim. Auditimi i jashtëm, Auditimi Gjeneral, ju thashë edhe një herë, për mua është si në mjekësi një lëndë preventive, prandaj nuk ka nevojë të përdoren fjalë të rënda, shpesh të pavërteta... me gjithë do raste. Nuk po e përmendi fushatën, nuk është mirë, nuk i bën mirë as individit, por nuk i bën nder as institucionit. Në një vizitë para disa viteve, së bashku me shefat tjerë të grupit parlamentar, kur shkuam për t'i lutur për njohje, thanë po ju tmerrësisht vrer po qitni për vendin tuaj. Ejani të punojmë brenda institucioneve. Kjo që ndodh sonte, ky është Kuvend, ky është bukuria, por është mirë që të theksohet gjatë debatit e vërteta, të përdoren më shumë fakte dhe nuk ka nevojë të përdoret një gjuhë joparlamentare. Ky është vendi i debatit, nuk është vend i mirë për shpifje, nuk është vend i mirë për ushtrim të një aktiviteti që nuk i bën mirë kurrkujt. Unë jam shumë i hapët, ju ftoj që të vini në Ministri të Shëndetësisë. Ju garantoj se sa herë që në kontinuitet kërkonit të dhëna, do t'ua ofrojmë. Faleminderit shumë dhe roli im është që t'u ndihmoj atyre që kanë nevojë për të dhëna nga lëmi i shëndetësisë dhe Ministria e Shëndetësisë. Ju faleminderit shumë!

KRYTARI: Faleminderit! Ibrahim Gashi e ka fjalën.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Sigurisht që unë nuk mund të flas për detaje, do të flas më shumë për fenomenin, sepse detajet shumë mirë dhe me shumë profesionalizëm, një pjesë e kolegëve deputetë i kanë evidentuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe kujtoj në mënyrë objektive dhe jo për fushatë. Aq më tepër, e them jo për fushatë, sepse debati kryesor u bë pas përfundimit të transmetimit të drejtpërdrejtë. Dhe, sigurisht që nuk dua ta vlerësoj atë çka thanë, por po dua me rikujtoj se dy seanca që i kemi një vijimësi dy ditë, dje the sot deri në këtë kohë, kemi debatuar për 3 dokumente tepër të rëndësishme – për Projekt-strategjinë lidhur me luftën kundër korrupsionit, për Raportin e buxhetit për gjashtëmujorin e kaluar dhe, tash, për Raportin e auditimit. Dhe, mundem pa shmangshëm, nuk po flas si opozitë, por mundem prej këtu të falënderoj se opozita ka kontribuar më shumë dhe nuk them me marrjen e fjalës dhe me përmbajtjen që është folur, por them me prezencën në sallë dhe me respektimin e rëndësisë së pikave që janë diskutuar. Pse po e potencoj këtë? Po e potencoj për faktin se bëhet fjalë për 3 dokumente që e shpërfaqin në mënyrën më të drejtpërdrejtë performancën e institucionit të Kuvendit të Kosovës, së paku për gjashtëmujorin e kaluar të këtij viti dhe, natyrisht, jo i pa rëndësishëm për Kosovën në procesin nëpër të cilin po kalon. Dhe, dua të them se reflektimi i përgjegjshëm si sonte ishalla vazhdon edhe konstruktiviteti e racionalizmi dhe për këtë unë e falënderoj edhe Kryetarin e Kuvendit për fjalën e tij, që ishte shumë, të them, kritik dhe vetëkritik, por mbi të gjitha objektiv dhe racional, që të vazhdojmë kështu sepse reflektimi si sonte dhe nëse pasohet me veprime konkrete e me masa konkrete konform asaj që është evidentuar

në një dokument bazik tepër të rëndësishëm, qysh është ky i auditimit, na i hap disa rrugë që ne po pretendojmë se i kemi shumë të hapura, zyrtarët e lartë të institucioneve po na thonë se i kemi shumë të hapura por e vërteta fatkeqësisht është ndryshe dhe nuk i kemi shumë të hapura. Dhe, raportet si ky, të cilin po e debatojmë deri në këto orë të vona, nëse do të kemi përsëritje të raporteve të tilla, atëherë nuk po dua të moralizoj ose t'i mbaj leksion kurrkujt, por ta dini dhe ta dimë ne të gjithë, si popull dhe si shoqëri, që kanë për të bartur konsekuenca të drejtpërdrejta për procesin e liberalizimit të vizave, për afrimin me proceset integruese. E kemi tash raportin e Komisionit dhe menjëherë e kemi procesin e studimit të fizibilitetit, i cili kërkon parametra të prekshëm, progres real, nëse ka, nëse s'ka ai ka për t'u thënë emrin e vërtetë. Me këso raportesh dekurajojmë investitorët e huaj, të cilët presin çka po ndodhë në Kosovë sepse është vend atraktiv, megjithatë është shtet i ri, me resurset që i ka, po me industri dhe me mundësi të përpunimit dhe të shfrytëzimit të atyre resurseve ende të pa instaluar dhe, natyrisht, është vend atraktiv për investitorët deri diku.

Dhe, krejt në fund, prapë po flas, besoj se kem të drejtë se pasojat, konsekuencat kanë për t'u ndier edhe në procesin e njohjeve, të mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës, procesi i cili ka ngecje. Që katër muaj s'kemi po thuaj asnjë njohje. Dhe, natyrisht, jo krejt me fajin se shtetet kanë rezerva, kanë hezitime, kanë interesa, po edhe me performancën jo të mirë të institucioneve dhe të shoqërisë kosovare në procesin e shtetndërtimit. Prandaj, ishalla na mban kjo frymë kritike dhe konstruktive e reflektimit tonë si Parlament që së paku në pjesën e raportit të progresit, ku flitet për Parlamentin, vitin tjetër ta kemi një performancë tjetër shumë më pozitive. Natyrisht, institucionet tjera e kanë përgjegjësinë e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar nga deputetët në vijim të diskutimet mos të jenë më të gjata se 5 minuta. A jeni dakord? Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po kjo kërkesë kishte për të qenë shumë e mirë edhe me vend në fillim të debatit të ishte bërë, por kah fundi s'është mirë. Unë mund të pajtohem, por nuk është mirë.

Vërtet u tha shumëçka këtu dhe është për t'u mirëpritur gjithë ajo që u diskutua. Ne për herë të parë kemi një raport të tillë të Auditorit Gjeneral në Kuvend të kompletuar dhe kjo na lë të shpresojmë se vërtet auditimet e ardhshme ose do të jenë më të mira në kuptimin edhe të opinionëve, edhe të konkluzioneve, sepse atyre që u drejtohet kanë mjaft çka të mësojnë dhe çka të marrin prej kësaj dhe jo çka të mësojnë, por duhet detyrimisht t'i marrin dhe t'i zbatojnë të gjitha rekomandimet e dhëna këtu. Për hir të asaj, po thuhet shpesh, të lexohet, por është mirë të lexohet drejt dhe të lexohet qartë, sepse disa shifra që përmenden këtu nganjëherë, nuk di me çfarë matematike janë nxjerrë, por duhet të kemi parasysh se ky auditim ka pasur të bëjë vetëm me 23 organizata buxhetore dhe jo me të gjitha organizatat buxhetore, që do të thotë që bëjnë 80% të hyrave dhe 95% të shpenzimeve. Do të thotë, në qoftë se e marrim 100%-shin e të hyrave dhe 100%-shin e shpenzimeve, vërtet mund të na dalin ato shifra, por keni parasysh se janë vetëm 23 organizata buxhetore dhe auditimi nuk është bërë në 20%-shin e të hyrave dhe në 5%-shin e shpenzimeve. Prandaj, mos të ngatërrohemi këtu me shifra.

Fillimisht, e keni në faqen e parë, thotë, opinionimi im, e ka këtë të drejtë ligjore, për pasqyrat vjetore financiare të Qeverisë, për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për 2008, është se në aspektin material ato janë në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe udhëzimet administrative të zbatueshme, në pajtim me

standardet ndërkombëtare të raportimeve financiare, paraqesin pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Dhe, më lejoni që unë vetëm konkluzionet Auditorit t'i lexoj për çështjet që u shtruan këtu dhe që bëjnë për të dyshuar vërtet në atë që nuk do të dëshironim. Kur është fjala për të hyrat vetjake, konkluzioni është ky: në politikat e thesarit thuhet se të hyrat vetjake të bartura nga viti i kaluar konsiderohen vetëm ato të alokuara, prandaj shuma prej 35 milionë e... 35 milionë e 600 e... kjo është një shifër kështu, s'po mund tash as ta konceptoj shumë qartë dhe drejtë, është shumë e të hyrave vetjake të alokuara dhe është paraqitur saktë në pasqyrë.

Kur është fjala për shpenzimet, mallrat dhe shërbimet, konkluzioni është ky: pasqyrat e pranimit të parave të gatshme dhe pagesave japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë në të gjitha aspektet materiale. Sidoqoftë, problemet e cekura që u thanë më herët, që aty duhet të mësojnë agjencitë buxhetore, duhet të adresohen në atë mënyrë që të hapen rrugë për një pasqyrë më të mirë financiare vjetore për vitin e ardhshëm.

Pastaj e kemi te pasqyra e të hyrave. Janë bërë përmirësime për gjendjen, por gjendjen nuk e shohim të kënaqshme, ashtu siç nuk e shohim as ne të kënaqshme. Sistemi i kontrollit është i dobët për të siguruar plotësinë e të hyrave të mbledhura dhe korrektësinë pasuese të regjistrimit të hyrave të raportuara, është ende e dobët dhe rrisin e rrezikun e gabimeve dhe të parregullsive.

Nga të gjitha këto konkluzione, janë opinionet në fillim edhe të parat dhe përfundimtare se janë 3 opinione të pakualifikuara. E keni një faqe atje, e shpjegon çka është opinionin i pa kualifikuar... 16 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes. Edhe atje është shpjegimi kush në terminologji mund të çalojë, dhe 4 opinione të kualifikuara. Prandaj, ne do të duhej që të kërkonim sot këtu të gjithë që edhe këto 4 opinione të kualifikuara ta marrë për detyrë Qeveria, respektivisht Kryeministri dhe të gjejë ku janë këto, të dihen saktë në cilat organizata buxhetore janë dhe në të ardhmen vërtet të mos na dalin të tilla çfarë na janë paraqitur në këtë raport të Auditorit Gjeneral.

Dhe, mendoj se nga e gjithë ajo që është thënë këtu dhe është thënë në shumë raste dhe në shumë vende me të drejtë, do të duhej, sikur që e tha edhe Kryetari i Kuvendit, të mësojmë dhe jo vetëm të mësojmë, por të mbikëqyrim edhe zbatimin e të gjitha rekomandimeve në të gjitha organizatat buxhetore që kanë dalë nga ky dokument ose nga ky raport i Auditorit të Përgjithshëm.

Manipulimet me shifra, në këto raste, mund të na qesin në terrene të këqija dhe besoj se ne kemi pasur, kush ka pasur rast edhe në ueb-faqe të shohë për secilën agjenci veç e veç, për këto 3 organizata buxhetore janë raportet e veçanta, janë më të detajizuara dhe aty mund të nxirren pastaj të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që i kanë këto organizata buxhetore dhe që duhet t'i përmirësojmë dhe të mos na përsëriten në vitet tjera.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar ministër Gashi,

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor i auditimit 2008 është profesional, sipas standardeve të auditimit dhe në pajtim me ligjin. Prandaj, unë e përkrah.

Mirëpo, për të diskutuar për të, patjetër se aktori kryesor për mangësitë që janë, është ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe ai duhet të jetë këtu, sepse llogaridhënia është pjesë e përgjegjësisë së tij. Fund e krye raporti tregon se të gjitha shifrat që vijnë nga Ministria e Financave në Kuvend, nuk janë të sakta dhe tregojnë dallime të mëdha. Realizimi i buxhetit është i dobët. Shkelja e ligjit dhe e rregulloreve është e shpeshtë, planifikimi, ekzekutimi dhe përcjellja pasuese e buxhetit janë të dobëta. Ekzekutimi i buxhetit është joefikas, sepse të gjeturat e auditorit tregojnë se shpenzimet janë më të larta në fund të vitit dhe të gjeturat janë se në muajin dhjetor janë shpenzuar 23.4% prej totalit të mallrave dhe të shërbimeve dhe 38.7% prej shpenzimeve kapitale, që flet për dobësinë e ekzekutimit të buxhetit.

Kontrolli i brendshëm është i dobët. Mekanizmat e kontrollit të brendshëm, auditimet e brendshme janë të parregullta, jo funksionale dhe, po ashtu, Njësia Qendrore Harmonizuese për kontroll dhe menaxhim financiar në MEF është jo funksionale.

Ka mungesa serioze në fushat financiare të organizatave buxhetore. Unë po e përmbledh në 3 pika atë që është e përbashkët për të gjitha ato.

1. Shkelja e Ligjit të prokurimit;
2. Menaxhimi i dobët;
3. Kontrolli i dobët i brendshëm, pra auditimi i dobët i brendshëm.

Të gjitha këto janë shenja të keqpërdorimit. Dëshiroj t'i veçoj disa të gjetura. Ministria e Administratës Publike, shkelje e Udhëzimit administrativ 2008/13, sistemi i dobët i kontrollit të brendshëm, pagat dhe mëditjet, mosharmonizimi me Ligjin për prokurim, menaxhimi i dobët i pasurive.

Po thuaj se të njëjtat i ka Ministria e Transportit dhe Posttelekomunikacionit, por e ka të shtuar edhe një – niveli i ulët i të hyrave për lidhje me rrugën kryesore.

Ministria e Arsimit, gjithashtu, thuaja se të njëjtat, por e ka të shtuar edhe një – kontratat në vepër në kundërshtim me rregulloret e Thesarit.

Te analiza e pagesave auditori ka konstatuar se një numër i pagesave është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, jashtë sistemit të listës së pagave, shenjë e keqpërdorimeve.

Kështu, te analiza e pagesave, pagat dhe mëditjet, diferenca në mes Librit të përgjithshëm dhe Listës së pagave është 16.485.000. Kjo është shkelje serioze dhe kërkon përgjegjësi.

Shqetësim janë edhe pagesat në kontratat në vlerën prej 1.345.000 euro, masat stimuluese prej 8.1 milionë euro.

Kjo gjithsesi hap dyshimin për keqpërdorime. Nuk e dimë se me leje të kujt janë bërë këto. Sigurisht jo me leje të Kuvendit.

Një numër i pagesave është kryer pas datës së lejuar me ligj. Kush e ka lejuar këtë. Është thyer ligji. Nëse nuk janë marrë masa, atëherë është bërë me miratimin e MEF-it, gjegjësisht të Qeverisë.

Shqetësimi im tjetër është në pikën 4.3.4. Pasqyrat e konsoliduara të fondit të pasurisë dhe bilanci i fondit. Krahësimi i gjendjes sipas librave dhe atyre në Bankën Qendrore të Kosovës, është shqetësim edhe më i madh. Paraja në qarkullim është 5.812.000 kurse paraja në dorë 613.000, që jep diferencën prej 5 milionëve. Pra, nuk barazohet gjendja e parave me të llogarisë, nuk barazohet keshi. Kjo është ndër sinjalet kryesore të keqmenaxhimit të parasë së gatshme.

Të hyrat vetjake në pasqyrat financiare nuk barazohen me të hyrat në Librin e përgjithshëm. Kjo shkakton ndryshimin në shumën prej më se 12.000.000. Ku qëndron ky mosbarazim, pse ka ardhur deri te ky mosbarazim?

Analizat e të hyrave të komunave tregojnë se ka komuna të cilat nuk regjistrojnë asnjë të hyrë nga lëshimi i certifikatave të lindjes dhe të martesës, nga lëshimi i certifikatave të vdekjes, pastaj nga lëshimi i lejeve të ndërtimit dhe tarifave të ndërtimit, nga lëshimi i lejeve të regjistrimit të biznesit dhe nga qiradhënia e pronave publike. Ku mbesin këto para, për çka shfrytëzohen.

Te pika 5.3. MAP sistemi i pagave. Auditori ka gjetur se mungojnë kontratat për të punësuarit, edhe pse ata janë paguar prej listës së pagave dhe, po ashtu, janë paguar edhe ata të cilëve iu ka skaduar kontrata, përmes sistemit të pagave janë paguar.

Auditimet mbi prokurimet janë sidomos alarmuese. Dëshiroj ta citoj auditorin. Prokurimi është identifikuar si një nga fushat e organizatave buxhetore me rrezik domethënës për mosefikasitet, korrupsion, mashtrime, humbje dhe shpërdorime. Organizatat buxhetore kanë dështuar në caktimin e menaxhmentit të përgjegjshëm për përmirësimin e prokurimit. Të dhënat lidhur me prokurimin flasin se janë nënshkruar kontratat jashtë planit të prokurimit, se kontraktuesit janë paguar pa e mbaruar punën, iu janë dhënë kontratat ofertuesve ekonomikisht të papërgjegjshëm, janë paguar shuma më të mëdha se sa vlera e kontratës. Po ashtu, kanë përfutur ata të cilët kanë pasur çmimin më të lartë, edhe pse kriteri ka qenë çmimi më i ulët.

Nga kjo, konkludimi i auditorit është se mungesa e përgjegjësisë, ngurrimi për të hulumtuar menaxhmentin, menaxhimin e dobët të resurseve, mashtrimeve dhe të keqpërdorimit ka arritur rrezikun për praktikë korruptuese në prokurimet publike.

Zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të gjitha konkluzionet, por sidomos rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm duhet të zbatohen. Kuvendi duhet të krijojë programin për futjen e mbikëqyrjes, ashtu që Ministria e Ekonomisë dhe Financave t'i raportojë Kuvendit për nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Pra, Kuvendi duhet të krijojë, ashtu siç propozon auditori, direktivat për të vendosur standarde të raporteve të auditimit të performancës, të cilat do t'i zbatojë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe për këto performanca t'i raportojë Kuvendit. Komisioni për Buxhet të mbajë seancë dëgjimore me menaxherë përgjegjës dhe Auditorin e Përgjithshëm. Deri në fund të këtij viti ose pas vitit të ardhshëm MEF-i duhet t'i zbatojë rekomandimet.

Po e përfundoj me një porosi të Auditorit që para se deputetët të marrin vendimin për buxhetin e vitit të ardhshëm, të shkarkojnë nga përgjegjësia zyrtarët përgjegjës prej përgjegjësisë të tyre. Për mua, përgjegjësia i bie në radhë të parë ministrit të Ekonomisë

dhe Financave dhe në bazë të përgjegjësisë që ka, meqenëse nuk i ka përmbush, po të ishte si duhet, do të jepte sot dorëheqje. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Naim Rustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Edhe pse pas shumë diskutimeve, shumë prej fjalëve të mia u shfaqën në diskutimet e të tjerëve, unë megjithatë do t'i ngreh disa çështje që me të vërtetë janë shqetësuese.

Raportin e mbështes, por edhe shpresoj se raporti do të hasë në mirëkuptim ndaj të tjerët dhe të marrin masa adekuate apo edhe të shërbejë si një burim i informacionit se ku mund të keqpërdoret pozicioni zyrtar edhe para publike.

Për një gjë, më duhet ta citoj edhe kolegun tim, deputetin Driton Tali, kur thotë se me të vërtetë na kanë lodhur me krahasime se kush ka bërë shkelje më pak. Logjika se kush ka bërë shkelje më pak nuk është logjikë progresive. Logjika se kush ka vjedhur më pak a ma shumë s'është progresive. Asnjë nuk kanë të drejtë të keqpërdorin pozitën zyrtare. Kjo fjalë deri diku i dedikohet edhe ministrit të Shëndetësisë, ku me një fjalor pedagogjik, edukativ për deputetët e Kuvendit të Kosovës tentoi të arsyetojë sistemin e prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë.

Në këtë raport të auditorit, në shumicën prej subjekteve të audituara ekziston mungesa menaxheriale e mosharmonizimit me ligjet e prokurimit. Ky është edhe sugjerim prej auditorëve. Është një ligj i prokurimit. Nuk kemi të bëjmë me harmonizim me Ligjin e prokurimit. Ligji i prokurimit është detyrim. Ligji i prokurimit i rregullon çështjet e blerjeve, si të shërbimeve ashtu edhe të mallrave të tjera, çfarëdo natyre qofshin ato. Dhe, ju lutem, nëse ka mangësi menaxheriale në sistemin e prokurimit të organizatave buxhetore të Kosovës po edhe të organizatave tjera jashtë, atëherë Ligji i prokurimit gjithashtu i parasheh edhe detyrimet dhe dënimet që parashihen me rastin e shkeljes së Ligjit të prokurimit. Për këtë arsye, them se kisha për ta mbështetur këtë raport në rast se kjo shërben si bazë për të iniciuar procedura. Dhe, të nderuar kolegë, të gjithë duhet ta kemi një gjë të qartë. Lëndët edhe paraprakisht që kanë ndodhur, nuk janë të harruara, nuk vjetrohen lëndët dhe kishte për të qenë kjo një mësim i mirë për ata që kanë qenë, ata që janë dhe mësim shumë i mirë për ata që do të vijnë, sepse nuk bën të manipulohet me pozicionin udhëheqës, me pozicionin zyrtar. Nuk bën të manipulohet me paranë publike.

Kjo ishte, si të them, në përgjithësi, kurse unë do të ndalem pak në pika më të veçanta, posaçërisht në mospërputhjen, atë që e ngriti edhe Kryetari i Kuvendit në mospërputhjen në mes të sistemit të pagesave të Ministrisë së Administratës Publike dhe të Thesarit. Me Ligjin për financa publike ne i dimë detyrimet që i ka Departamenti i Thesarit. Nëse ka mospërputhje, pse të ketë mospërputhje. Si është e mundshme të futet njeriu në listën e pagesave. Në kohën kur ju, Kryetar i Kuvendit, keni qenë ministër, ju kujtohet se ju i keni nënshkruar disa procedura të rekrutimit. Nuk mund të futesh në Shërbim Civil pa i respektuar procedurat e rekrutimit. Kjo është shkelje. Për këtë shkelje dikush duhet të paguaj. Nuk ka mundësi ne ta biem një shoqëri ku ne dhe të tjerët bëjnë shkelje dhe kërkon – më fal që e kam shkelur ligjin. Nuk ka, më fal se e ke shkel ligjin. Kur e shkel ligjin, pason dënimi, dënimi – masat adekuate, masat që mund të jenë edhe masa edukative, varësisht prej shkeljes që e bën.

Gjithashtu, do t'i referohem edhe punës së Komisionit të Administratës Publike. Gjatë shfletimit të procesverbalit të tyre, e shoh se ngrihen çështje, për shembull, a ka shërbyes

civilë që janë të punësuar pa kontratë. Në rast se ka, ke parasysh se është shkelje shumë, shumë e rëndë. Nuk mund të futet askush në listën e pagesave të shërbimit civil pa iu nënshtruar procedurave të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit saktë i përcaktojnë kushtet se si mund të futesh në listë të pagesave. Kjo është tentuar shumë herë edhe në foltoret e këtij Kuvendi, edhe përmes pyetjeve parlamentare të transmetohet si kontratë mbi vepër. Të nderuar, nuk ekziston ky koncept. Nuk ka, sepse edhe shërbimi blihet sipas Ligjit të prokurimit, s'ka kontratë mbi vepër. Kjo është një shpikje ose një mbeturinë nga sistemet e kaluara – kontrata mbi vepër. Nuk ka në asnjë ligj që rregullon kontratën mbi vepër për t'u paguar. Njeriu kur ta blejë shërbimin individual të tjetërkujt, atëherë ato limitet e prokurimit i përcakton Ligji i prokurimit. Kjo më sjell dhe më përkujton edhe një peticion, që unë e kam nënshkruar, që e ka iniciuar kolegu i LDK-së, Arsim Rexhepi, ku njëra prej kërkesave që të hetohet në RTK ka qenë që të hetohet edhe kontrata mbi vepër në RTK, kurse në raportin e auditimit ceket se pasqyrat financiare janë në rregull... Unë përkujtoj se këtu nuk ka mundësi të jetë në rregull. Po, mirë, se e ka futur fjalën sipas opinionit tonë. Mund të jetë opinion i auditorit, por në rregull nuk është.

Gjithashtu, në Raportin e auditorit, në komentet e Qeverisë përcaktohet se ka pranuar lloje tjera të pagesave për individët dhe Ministria e Administratës Publike synon t'i përfshijë në listën e pagesave të Ministrisë apo të gjitha pagesat për individët e tjerë. Kush mund të jenë individët e tjerë? Nuk ka mundësi të bëhet pagesë nga pagat dhe mëditjet për individët e tjerë. Secila blerje e shërbimit duhet t'i nënshtrohet Ligjit të prokurimit.

Ky diskutim deri tani ishte në pika përshkruese, kurse unë e kam një sugjerim për të gjithë ata që ngrehin zërin kundër dukurive negative, që s'kanë nevojë të jenë subjektiv ndaj askujt. Kushdo që e the ligjin, e the për veti. Nuk ka mundësi të krijohet shoqëri demokratike pa sundimin e ligjit. Jo sundimin e ligjit në koncept verbal apo veç të qitet në letër. Nuk mjafton vetëm vota e popullit apo vetëm përfaqësimi popullor, apo veç na çka po flasim këtu në Kuvend. Që të plotësohet jeta demokratike, sundimi i ligjit duhet të jetë në vepër. Dhe, ky është rast shumë i mirë, ky raport i auditorit, që të merren nga njerëz kompetentë dhe aty ku u thye ligji, le të veprojë ligji. Nëse nuk e gjen veten të implementuar në raportin e auditorit, atëherë ka mbetur një pjesë e letrës që mund të përfundojë në ndonjë prej fiokave të zyrtarëve publikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha për t'ju lutur, edhe pse kanë mbetur pak deputetë për diskutim, mos të zgjasin diskutimet më shumë se 5 minuta. Mendoj që për 5 minuta njeriu thotë boll ose e thotë atë që duhet thënë. Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Do të përmbahem dhe për 5 minuta ta kryej këtë çka dua ta them.

Unë do të ndalem më tepër te auditimi i brendshëm, ku edhe Qeveria, edhe Kuvendi dhe të gjithë ne duhet t'i kushtojmë një rëndësi shumë të madhe për arsye se auditimi i brendshëm është që të mos përsëriten gabimet. Gjatë monitorimit të Ligjit mbi auditimin e brendshëm kemi parë mjaft mungesa, ndër ta kam qenë edhe unë anëtar nga Komisioni për Buxhet dhe kur kemi bërë monitorimin e këtij ligji, në pikën 5, më duket në neni 5, thuhet se rekomandimet që duhet t'i japë auditori, ato duhen të jenë obligative, ndërsa për agjencitë buxhetore, rekomandimet të cilat janë duke iu dhënë agjencive buxhetore, nuk janë duke u marrë për bazë. Dhe, do ta them këtu një fakt ilustrativ. Gjatë vizitës në një prej komunave, në zyrën e auditorit të brendshëm në një komunë ka qenë një person, i cili ka qëndruar në një zyre një metër me një metër dhe besoni që unë dhe zoti Zemaj për të marrë informacione nga ai zotëri duhej njëri të hynte në hyrje dhe tjetri të dilte nga zyra.

Do të thotë, shihet rëndësia që i kanë dhënë auditorit të brendshëm dhe në pyetjen time se sa ka qasje në dokumente të shpenzimeve dhe të hyrave e të dalave, tha nuk kam qasje dhe konsiderohem si të jem unë polic. Do të thotë, ne auditimin duhet ta konsiderojmë që njerëzit duhet të mos i përsërisin gabimet. Dhe, të gabosh me qëllim e mos ta përmirësosh atë gabim, atëherë gabon me qëllim dhe duhet të jesh shumë përgjegjës. Këto janë duke ndodhur me agjencitë e buxhetit për arsye se nuk janë duke u marrë rekomandimet e auditimit të brendshëm. Në auditim thuhet edhe rreth shpenzimeve dhe të hyrave jo të besueshme. Unë këtë dua ta shpjegoj me një shembull ilustrativ. Shpenzime jo të besueshme janë ato shpenzime të cilat nuk besohen se me të vërtetë janë harxhuar për arsye se, jo se dua ta fajësoj ministrin e Financave ose ndonjë ministër, por mund të mbulohet dikush me letra dhe ja një shembull konkret: Ministria për Mirëqenie Sociale paska marrë një hotel “Prishtina” që për të kthyerit nga diaspora të komunitetit egjiptian po u dashka t’i vendosin në hotel në Prishtinë dhe ai person, i cili gjoja ka banuar atë natë në hotel, s’ka banuar fare dhe e ka afruar një organizatë në Pejë dhe e kanë pru te unë dhe unë është dashtë ta çoj te miku i tij, ndërsa në gazetën “Koha Ditore” të së dielës shkruhet se personi me emër e mbiemër figuron se ka fjetur në hotel dhe njeriu s’ka fjetur, por ka paguar Ministria për Mirëqenie Sociale. Këto janë shpenzime jo të besueshme dhe këto duhet të ndalen. Më mirë është ne deputetët që jemi të lodhur sonte, të banojmë në hotel dhe të paguajmë, të paguan Qeveria, se sa unë të udhëtoj 3-4 orë ose të lypi konak te Kryetari i Kuvendit. Prandaj, mos të keqkuptohet se auditimi i brendshëm është diçka e keqe. Auditimi i brendshëm është një proces që duhet agjencitë buxhetore të vetëdijesohen dhe të punojnë në bazë të Ligjit të menaxhimit publik të financave. Unë u ndala në këtë dhe besoj se nuk i kam kaluar 5 minuta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Po, edhe ne po shkojmë në hotel “Prishtina”. Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me të vërtetë ndoshta ndër raportet që meriton më së shumti lëvdata është Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, sepse vërtet e ka përmbushur atë vakumin institucional apo edhe i ka mbyllur të gjitha ato lëvdatat e mëhershme për dy ditë që i kemi dëgjuar nga qeveritarët rreth menaxhimit dhe shfrytëzimit të buxhetit të Qeverisë së Kosovës. Mirë, të gjithë po pajtohemi se ky raport është i mirë, është i drejtë, është korrekt dhe është i besueshëm, mirëpo sa vërtet e kemi kapur konceptin dhe thelbin e këtij raporti. Ky raport nuk është vetëm për ta lavdëruar. Mirëpo, ky raport, njëkohësisht edhe obligon, obligon edhe të gjitha këto institucione që e qeverisin vendin tonë. Unë e shoh për të madhe pse nuk janë këtu prezent Kryeministri dhe të gjithë ministrat. Ky raport nuk i dedikohet vetëm dy ministrive, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë e Financave, mirëpo njëkohësisht u dedikohet të gjitha institucioneve publike në Kosovë. Sido që të jetë, po shihet se thjeshtë ne jemi më të arsyeshëm kur flasim se sa kur i dëgjojmë faktet, e faktet e arsyetuara nuk dëshirojmë t’i dëshirojmë, sepse vërtet në këtë dokument, e gjithë ajo që shkruhet, është e mbuluar me fakte dhe me të vërteta. Unë do të mundohem të paraqes..., e kam bërë një analizë shumë të shkurtër, vetëm katër faqe. Kam filluar nga faqja 6 deri në faqen 9 të Raportit të Auditimit. Këtu janë paraqitur 23 subjekte të audituara në Kosovë dhe ka filluar me Ministrinë e Shëndetësisë, ka përfunduar me Zyrën e koordinatorit të TMK-së dhe gati në të gjitha institucionet që vërtet ka bërë kontroll auditori, gjendet një e metë apo një dobësi, e ajo është mosharmonizimi me Ligjin e prokurimit.

KRYETARI: Regjia, bjeri ziles që të kthehen deputetët në sallë, për votim!

SYNAVERE RYSHA: Të nderuar deputetë, a e kuptojmë cila është dhe çka në të vërtetë çka ka trajtuar në këtë çështje Auditori i Përgjithshëm. Kjo thotë se tenderët vërtet nuk po menaxhohen mirë dhe nuk po menaxhohen drejt apo shpenzimet e buxhetit të Kosovës po shkojnë në mënyrën më të keqe të mundshme. Mandej është rekomandimi tjetër apo të gjeturat tjera janë, të hyrat nuk janë të besueshme në dokumentet burimore. Edhe kjo është një e gjetur që vërtet është shqetësuese për Qeverinë e Kosovës, po edhe për të gjithë qytetarët e Kosovës. Është mangësia tjetër, do me thënë është vërejtur një mangësi në kontrollin e brendshëm nëpër të gjitha institucionet e Kosovës. Janë edhe dobësitë tjera, si menaxhimi i dobët i pasurive, detyrimet e pashlyera e shumë e shumë dobësi të tjera.

Sido që të jetë, unë nuk do ta analizoj krejt atë që e ka thënë auditori, sepse ai i ka thënë më mirë se sa ne që mund t'i lexojmë, sepse neve na mbetet vetëm t'i lexojmë dhe t'i përfillim, por do të shkoj te pjesa e fundit, te rekomandimi që vërtet i dedikohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, por njëkohësisht edhe gjithë Qeverisë.

Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet të marrë masa ndaj kësaj çështjeje. Kuvendi duhet të kërkojë një analizë nga MEF-i mbi arsyet e nivelit të ulët të adresimit dhe për një program gjithëpërfshirës për adresimin e çështjeve nga ky raport. Sido që të jetë, ishte edhe në fillim të debatit një kërkesë e Komisionit për Buxhet dhe Financa që i gjithë raporti të pranohet me përjashtim të raportit të Auditimit në Radiotelevizionin e Kosovës, nga Auditori Gjeneral. Unë vërtet nuk po pajtohem me këtë, sepse edhe në atë raport Auditori Gjeneral ka dhënë një shpjegim të qartë të qasjes dhe vërtet ai raport ka përfunduar me 8 rekomandime, ndoshta ka qenë vështirë të kuptohet nga deputetët apo edhe nga anëtarët e Komisionit, por sido që të jetë ka përfunduar me 8 rekomandime që ka pasur bazë të mjaftueshme për të hetuar dhe për të konstatuar keqpërdorimet.

Unë do ta përmend vetëm një nga të gjeturat e auditorit në raportin e RTK-ës. Thotë se RTK-ja i ka pasur 2 llogari dhe 5 nën-llogari dhe, të nderuar deputetë, a është kjo e mjaftueshme për t'i hyrë një kontrolli apo për të bërë një komision hetimor. Mendoj se është më se e mjaftueshme dhe e domosdoshme. Po, sido që të jetë, atëherë është kaluar me një formë shumë të shpejtuar, që mendoj se kësaj radhe duhet t'i bashkëngjitet këtij raporti dhe duhet të votohet njëkohësisht. Por, ta kemi parasysh se nga ky raport duhet të marrim edhe obligime edhe ne si Kuvend, jo vetëm ta përfundojmë me një miratim, sepse nuk ka ndryshe, ky raport gjithsesi duhet të miratohet, po çka në fakt kanë sugjeruar të gjitha ato rekomandimet që na obligojnë neve si Kuvend dhe t'i zbatojmë neve në praktikë. Faleminderit!

KRYETARI: Regjia, edhe një herë bjeri ziles! I kemi 55 deputetë, na duhen edhe nja 6. Po presim edhe pak, e nëse nuk vijnë, atëherë votimin e lëmë për seancën e radhës. Po, nuk ka nevojë, kanë përfunduar dhe s'ka diskutime më. Deputetë, diskutimet kanë përfunduar, votimin e bëjmë në seancën e radhës. Mirë u pafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale